

PËRMBAJTJA E REVISTËS:

Numri XXIII, viti 2005 / 23st issue, year 2005

Faqe / Page

Reforma ligjore dhe Integrimi Europian:

Parandalimi i konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike - parametër për mirëqeverisje	Petro KOÇI	4
Shkaktimi i dëmit të ardhur nga shkelja e së drejtës së autorit.		
Ligji për të drejtën e autorit	Mariana TUTULANI	15
Kuadri i ri ligjor i rregullimit të së drejtës së autorit	Juliana LATIFI	28
Shqipëria dhe kushtëzimi demokratik i Bashkimit Europian:		
Zgjedhja i përket Tiranës	Dasara DIZDARI	42

E Drejta Kushtetuese:

Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese	Sokol SADUSHI	58
---	---------------	----

Nga punimet e Kuvendit:

Raport nga monitorimi i veprimtarisë së komisioneve parlamentare, shkurt 2005	70	
Seancat degjimore të zhvilluara në Kuvendin e Shqipërisë për periudhen janar - shkurt 2005		74
Nga punimet e Kuvendit të Shqipërisë për periudhen janar – mars 2005	Alma KONDAKÇIU	86
Ligjvënësit Shqiptar 1920 - 2005	101	
Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend	Filip LAKO	104

Përmbledhje në anglisht:

Extract from the article “Albania and the EU’s Democratic conditionality: “The choice is Tirana’s”	Dasara DIZDARI	120
Report of parliamentary committee’s monitoring process for month of February 2005		122
Information on laws passed by Assembly		126

TABLE OF CONTENTS:

23st issue, year 2005

	Page
Legal reform and the process of Integration:	
Prevention of the conflict of interest in exercising the public functions - standard for good governance	
Petro KOÇI	4
Causing a harm as for the infringement of the copyright law	
Marjana TUTULANI	15
New legal framework on copyright law	
Juliana LATIFI	28
Albania and the EU's Democratic conditionality: "The choice is Tirana's"	
Dasara DIZDARI	42
<hr/>	
Parliamentary Law:	
Rules of Procedure of the Parliament of Albania and the jurisprudence of the Constitutional Court	
Sokol SADUSHI	58
<hr/>	
From the proceedings of the Assembly:	
Report of parliamentary committee's monitoring process for month of February 2005	70
Hearing sessions conducted in the Parliament of Albania for the period January – February 2005.	74
From the proceedings of the Assembly of Albania for the period January – March 2005.	
Alma KONDAKÇIU	86
Albanian lawmakers 1920 - 2005	101
Information on the legislation approved by Assembly	
Filip LAKO	104
<hr/>	
Summary in English:	
Extract from the article "Albania and the EU's Democratic conditionality: "The choice is Tirana's"	
Dasara DIZDARI	120
Report of parliamentary committee's monitoring process for month of February 2005	122
Information on laws passed by Assembly	126

Rubrikat në vijim synojnë prezantimin e politikave ligjore dhe trajtimeve teorike për organizimin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve të studiuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.

Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.

Parandalimi i konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike - parametër për mirëqeverisje

*Petro Koçi
Deputet*

Dinamikat sociale, ekonomike e politike që shteti shqiptar ka kaluar, duke nisur nga procesi i përqasjes rajonale, që Europa aplikoi ndaj vendeve të Ballkanit, në Paktin e Stabilitetit dhe për të arritur së fundi në hapjen e negociatave të marrëveshjes së stabilizim-asociimit, është e natyrshme të kërkojnë që veprimtaria e institucioneve shtetërore të fokusohet në krijimin dhe ruajtjen e standardeve të larta të mirëqeverisjes dhe miradministrimit të punëve të shtetit.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, kuadri ligjor që rrjedh prej saj, përshtatshmëria e tyre me konventat dhe aktet ndërkombëtare, do të thotë që procesi i përafrimit me BE-në të shfaqet natyrshëm në një impakt disiplanësh që ndikon jo vetëm në përqasjen e legjislationit kombëtar me atë ndërkombëtar, por edhe në angazhimin praktik të institucioneve shtetërore për ta zbatuar atë me korrektësi.

Statusi i vendeve anëtare, në të cilat shteti shqiptar synon të aderojë, kërkon që institucionet shtetërore të krijojnë dhe respektojnë ato standarde të mirëqeverisjes që do të justifikonin përshtatjen e tyre me sistemin ligjor të BE-së në kushtet e anëtarësimit të plotë.

Respektimi i lirisë, demokracisë, shtetit juridik dikton të drejtën e shtetasve

për t'u mirëqeverisur dhe kërkuar nga funksionarët shtetërorë, respektimin e parimeve dhe të normave të sjelljes, të cilat rrisin ndjeshëm cilësinë e administrimit dhe të shërbimit ndaj tyre.

Duke i bërë të besueshme, të paanshme dhe transparente institucionet shtetërore, në shërbim të publikut, shtetasit do të gëzojnë të drejtat që burojnë nga “kontrata sociale”, të nënshkruar me shtetin e tyre.

Në realitetin shqiptar vërehet se ekziston mirëkuptimi dhe angazhimi konkret i Qeverisë dhe i politikës progresiste, për të mbështetur krijimin e një klime të përshtatshme në luftën kundër çdo dukurie që cenon integritetin e institucioneve shtetërore dhe krijon premiset e mundshme për korrupsion.

Vihet re që prirja e sotme e vendeve që kaluan nga regjimi dikatorial komunist në atë demokratik, ku korrupsionin e favorizojnë kushte objektive dhe subjektive, është përpjekja që ai të kthehet në një “normë morale”.

Ky rrezik krijon te qytetarët e një shteti një opinion shkatërues për mosbesim ndaj institucioneve shtetërore me devizën “që shteti nuk është i aftë t'i përgjigjet nevojave të individit”, sepse zyrtarët shtetërore në veprimtarinë e tyre, udhëhiqen nga motoja “interesi vetjak mbi interesin e përgjithshëm”.

Është e natyrshme që një problematikë e tillë gjeneron vetvetiu një shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të individit, duke krijuar një reaksion zinxhir, i cili ndikon negativisht në progresin e një vendi.

Angazhimi i të gjithë spektrit politik dhe i Qeverisë në luftë kundër korrupsionit, do të thotë krijim i një shteti juridik, bazuar mbi vlera dhe parime demokratike, si determinant i mirëfunksionimit të zhvillimit ekonomik, i sistemit të lirive dhe të drejtave politike, i ecurisë së shoqërisë civile, i besimit të publikut ndaj institucioneve shtetërore.

Sfida që del përpara në këtë mijëvjeçar të ri është: “*Një qeverisje efektive, stabilizim institucionesh dhe një udhëheqje e ndershme*”.

Me vizionin se tashmë në demokraci shteti duhet të sigurojë një mbrojtje të të drejtave dhe lirive të individit, miratimi i ligjit “Për parandalimin e konfliktit

të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” paraqet një nga përparësitë e Qeverisë dhe të politikës së sotme shqiptare, për të shmangur rreziqet që vijnë nga “konflikti i interesave” në ushtrimin e funksioneve shtetërore, duke synuar marrjen e masave sa më të frytshme për parandalimin e tyre.

Me vizionin se tashmë në demokraci, rëndesa e kahjes së mbrojtjes së të drejtave të njeriut ka ndryshuar nga shteti te qytetari, sanksionimi i këtij ligji synon të krijojë te qytetari bindjen se funksionarët shtetërorë duhet t’i shërbejnë atij.

Në këtë këndvështrim, sa politik dhe juridik, pozicioni social dhe mendësia e shtetasit shqiptar, dimensionohet dhe qaset me atë të shtetasit evropian.

Sanksionimi i këtij ligji nuk mund të jetë i mjaftueshëm pa aftësinë për ta zbatuar mirë këtë ligj, si një element thelbësor i garantimit të demokracisë dhe mirëqeverisjes, duke siguruar transparencë, paanësi, çiltërsi dhe llogaridhënie të institucioneve shtetërore.

Si një rrezikshmëri potenciale, konflikti i interesave kërcënon integritetin e funksionarit shtetëror në kryerjen e detyrave të tij publike dhe krijon premisat e një korrupsioni të mundshëm.

Në realitetin e sotëm shqiptar është i diskutueshëm problemi, të cilit i referohet veprimtaria e funksionarëve shtetërorë dhe e zyrtarëve publikë. Me të drejtë shtrohen pyetjet:

➤ A realizohet një vendimmarrje e paanshme dhe transparente për interesat e publikut?

➤ A ekziston një besueshmëri e publikut kundrejt institucioneve shtetërore ?

Pa dyshim këto janë çështje të diskutueshme. Një qeverisje e mirë mund të them i minimizon dukuritë negative, të cilat e bëjnë opinionin publik dyshues dhe mosbesues kundrejt veprimtarisë së qeverisë, duke i parandaluar ato hap pas hapi.

Këtij qëllimi i shërben edhe miratimi i ligjit “Për parandalimin e konfliktit

të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, duke siguruar një menaxhim të konfliktit të interesit, të parë në këto këndvështrime¹:

Së pari: Një shërbim ndaj interesit publik, çka nënkupton një vendimmarrje dhe kryerje detyre pa marrë parasysh intersin vetjak.

Së dyti: Garantim të transparencës dhe llogaridhënies përpara publikut.

Së treti: Promovim të përgjegjshmërisë vetjake dhe asaj që me të drejtë quhet “shembull i pastër”.

Së katërti: Gjenerim të një kulture të përbashkët, që do të jetë “intolerancë” ndaj konfliktit të interesit.

Ligji, duke iu referuar standardeve kushtetuese dhe atyre ndërkombëtare të gjithëpranuara (Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut), jep një zgjidhje në harmoni të plotë me to, duke ruajtur një raport të drejtë të interesave themelorë të individit me interesat publikë. Çdo kufizim i interesave privatë, është bërë duke patur parasysh përfitimet dhe kostot, rreziqet dhe nevojat e përshtatjes së këtyre kufizimeve.

Ligji duke synuar të parandalojë konfliktin e interesave, paraqet opsione të ndryshme në rregullimin e tyre:

1. Zhveshje ose neutralizim të interesit nga zyrtari;
2. moslejim të përfshirjes së zyrtarit në një proces të ndikuar vendimmarrjeje;
3. respektim të informacionit ndaj veprimeve që afektohen nga intersi i mundshëm;
4. transferim i zyrtarit nga funksioni në konflikt interesi;
5. zbatim të metodës “blind trust”²;

¹ Managing Conflict of Interest in the Public Service. OECD-Guidelines and Overview, 2003

² “Blind trust, sipas përkufizimit të dhënë në ligj (neni 3, pika 6), është zotërimi pasiv i aksioneve ose i pjesëve në kapital, ku pronari ruan të drejtën e përfitimit të fryteve civile të pronësisë, por nuk mund të ushtrojë vetë asnjë veprim tjetër civil mbi këtë pronë. Të gjitha veprimet e tjera (administrim, zotërim, tjetërsim etj) kryhen nga një person i besuar i pronarit,

6. dorëheqje ose shkarkim të zyrtarit, kur ai bie në konflikt interesi.

Ligji, në harmoni me ligjet e tjera të cilët demonstrojnë një frymë antikorrupsion, ofron parimin “që masa e kufizimeve të interesave private të sanksionuara në këtë ligj, është në harmoni me të njëjtat përcaktime të ligjeve të tjera.”

Duke sanksionuar në dispozitat e tij:

- kufizimet sasiore të interesave private të zyrtarëve;
- rregullim të marrëdhënieve brenda një institucioni dhe ndërmjet disa institucioneve, në rast të konfliktit të interesave;
- procedurat e deklarimit të konfliktit të interesave;

ligji udhëhiqet nga parimi: “Zyrtari duhet të kryejë vetëm në mënyrë të drejtë detyrat dhe përgjegjësitë e veta”, çka kushtëzon zyrtarin, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë duhet të shmangë vetë rënien në konflikt interesi.

Kjo e bën ligjin të karakterizohet nga një forcë argumentuese, jo “formalisht detyrues”, por në thelb “bindës për t’u pranuar dhe zbatuar”.

Shtrohet pyetja: Ç’është “konflikti i interesave”?

Në një koncept filozofik, konflikti i interesit është mungesë e ndershmërisë dhe e drejtësisë.

Në konceptin juridik, konflikti i interesit është një rrethanë ose veprimtari, funksion në të cilin interesi privat përplaset me interesin publik.

Duke pasur për bazë rekomandimet e OECD-së, ligji sanksionon saktësisht dhe qartë, kuptueshëm për të gjithë, se ç’është konflikti i interesave.

Sipas përcaktimit të dhënë në ligj: “Konflikt interesi do të thotë gjendje e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike³.

bazuar në një marrëveshje të lidhur midis tyre, që përcakton kriteret e përfitimit të fryteve të pasurisë, si dhe të drejta dhe detyrime të tjera të domosdoshme.

³ Shih, neni 3, pika 1.

Nga ana tjetër, në një këndvështrim diamentralisht të kundërt, ligji sanksionon parimin se çdo të thotë të kryesh në mënyrë të drejtë, detyrat dhe përgjegjësitë.

Të kryesh në mënyrë të drejtë detyrat dhe përgjegjësitë, të materializuara në një vendimmarrje, në të cilën zyrtari vepron në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanësi, përgjegjësi, përkushtim, në afat, në mbrojtje, në çdo rast, të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme të personave privatë, si dhe për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë e të dinjitetit të institucionit ku punon, të shtetit në përgjithësi dhe të figurës së zyrtarit⁴.

Kryerja në mënyrë të drejtë e detyrës dhe e përgjegjësisë, padyshim nënkupton se zyrtari në ushtrimin e funksionit të tij duhet të udhëhiqet nga disa standarde të gjithëpranuara, të cilat e bëjnë atë të aftë në ushtrimin e funksionit të zgjedhur ose të emëruar dhe në të njëjtën kohë sigurojnë edhe një mirëqeverisje të punëve të shtetit.

Këto standarde ndërkombëtare të gjithëpranuara janë: altruizmi, integriteti, llogaridhënia, transparencia, ndershmëria dhe aftësia drejtuese.

Në një demokraci të brishtë, siç është ajo shqiptare, padyshim ligjvënësit i takon përgjegjësia që të bëjë dhe një përcaktim të saktë të atyre interesave privatë, të cilat mund të çojnë zyrtarin të bjerë në konflikt interesi, duke mos lënë vend për keqinterpretime, të cilat mund të bëhen shkak i abuzimeve të mundshme.

Sipas ligjit⁵, do të konsiderohen interesa privatë të zyrtarit, ato interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga:

- a. të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre;
- b. çdo marrëdhënie tjetër juridike-civile;
- c. dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;
- ç. negociimet e mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit,

⁴ Po aty, neni 3, pika 2.

⁵ Po aty, neni 5.

gjatë ushtrimit të funksionit ose negocimi për çdo lloj forme tjetër marrëdhënesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryhet nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;

d. angazhimet në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, si dhe nga angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;

dh. marrëdhënie familjare ose të bashkëjetesës, të bashkësisë, etnike, fetare, të njohura të miqësisë ose të armiqësisë;

e. angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesat e cituar më sipër.

Ligji, duke qenë në një koherencë edhe me ligjet e tjera, të cilat në mënyrë të shprehur rregullojnë konfliktin e interesave, përcakton edhe llojin e konfliktit të interesave.

Sipas ligjit, konflikti i interesave⁶ është “faktik”, “në dukje” ose “i mundshëm”. Këto tipe të konfliktit dallohen në raport me efektet e interesave në vendimmarrje.

Përsa i përket dinamikës së efekteve, konflikti i interesave do të jetë “rast pas rasti” ose i “vazhdueshëm”⁷.

➤ Konflikti do të jetë *faktik* atëherë kur interesat private e ndikojnë te zyrtari ose kanë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësiave.

➤ Konflikti do të jetë *në dukje*, atëherë kur interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave ose përgjegjësiave të tij zyrtare, por në fakt ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë.

⁶ Po aty, neni 3, pika 4/a,b,c.

⁷ Po aty, neni 3, pika 4/c, d.

➤ Konflikti do të jetë *i mundshëm*, kur interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihet në detyra ose përgjegjësi të caktuara.

Secili nga tri rastet e mësipërme do të mund të na çojnë në një konflikt *rast pas rasti*, të lidhur ngushtë me një vendimmarrje të veçantë.

Nga ana tjetër, kur konflikti i mundshëm i interesit do të shfaqet në mënyrë të përsëritur ose të shpeshtë në të ardhmen, atëherë gjendja që do të krijohet i korrespondon “konfliktit të vazhdueshme të interesit”.

Duke bërë një trajtim në mënyrë eksplicite të konfliktit të interesave, ligji nuk lë shteg për një vakum ligjor, duke siguruar në të njëjtën kohë një koherencë dhe unitet në çdo fushë dhe për çdo fuksion.

Me interes paraqiten ato dispozita ligjore që u referohen subjekteve përkatëse, të cilat preken nga ky ligj dhe, në këndvështrimin tim, në trajtimin e saktë që ligji i bën pozitës së ministrave dhe, në të njëjtën kohë, të deputetëve, ai është në pajtim të plotë me nenet 70 dhe 103 të Kushtetutës, si dhe me aktet ndërkombëtare dhe veçanërisht me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Në opinionin publik, për shkak të pozitës së tyre, emrat e ministrave dhe të deputetëve, si dhe të të afërmëve të tyre janë shpesh të lakueshëm e të diskutueshëm.

Nga ana tjetër, çdo forcë politike, për të fituar zgjedhësit e saj (sidomos tashmë në prag të kësaj fushate zgjedhore), do të përdorë emrat e funksionarëve të lartë shtetërore, sidomos të ministrave dhe deputetëve, çka e tregoi më së miri edhe seanca plenare e diskutimit të këtij ligji, ku debati për miratimin e tij u personalizua me emra konkretë ministrash e deputetësh.

Ligji, synon midis të tjerave të normojë dhe të parandalojë rënien në konflikt interesi të ministrave dhe deputetëve.

Është mëse e natyrshme që në një shoqëri kapitaliste, “nga kapitalist të gdhihesh politikan,, por jo nga politikan, në kapitalist”.

Duke dashur që t'i pritet rruga kësaj dukurie, në mënyrë që individi dhe shoqëria të besojë te qeverisja e tyre, te njerëzit që ata i drejtojnë, në ligj jepen përcaktime adekuate, me qëllim parandalimin e rënies në konflikt intersi.

Sipas përcaktimeve të dhëna në ligj⁸, Kryeministri, zëvendëskryeministri, ministri:

➤ nuk mund të jenë drejtues ose anëtarë të organeve drejtuese në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale dhe çdo organizatë tjetër, përjashtuar organizatat politike dhe shtetërore, si dhe rastet kur një pozicion i tillë diktohet për shkak të funksionit;

➤ nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, si dhe profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të këshilltarit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave të sipërcituara dhe nuk mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër;

➤ nuk mund të zotërojnë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj.

Po ashtu edhe deputeti⁹:

➤ nuk mund të jetë drejtues i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse;

➤ nuk mund të ushtrojë veprimtari private që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të këshilltarit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave të sipërcituara dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër;

➤ nuk mund të zotërojë, në mënyrë aktive asnjë aksion ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, nëse ajo rezulton me pozitë dominuese në treg.

⁸ Po aty, neni 27.

⁹ Po aty, neni 28.

Sanksionimi i këtij ligji do të sigurojë një përmirësim të praktikave të qeverisjes. Ai do të garantojë një mbikëqyrje të sjelljes administrative të funksionarëve shtetërorë, sa dhe si këta do t' i shërbejnë individit dhe shoqërisë.

Praktikat e qeverisjes së mirë dhe ndërveprimi i binomit *autoriteti publik-individ* sigurohen nga funksionimi i pavarur dhe i paanshëm i funksionarëve shtetërorë.

Sistemi i kontrollit dhe balancës sot pranohet si parimi bazë “i një qeverisje moderne dhe bashkëkohore”, çka synohet të realizohet edhe nëpërmjet këtij ligji, si një nga treguesit e standardeve që bashkësia ndërkombëtare ka përcaktuar dhe kërkon në praktikë për mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore dhe për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Në këndvështrimin e institucioneve ndërkombëtare ky ligj përbën një element të rëndësishëm të infrastrukturës së të drejtave të njeriut në një shoqëri demokratike.

Në perspektivën e integritit të vendit tonë në BE, ky ligj realizon një domosdoshmëri dhe pikërisht atë të “transparancës së administratës publike”.

Ligji synon në të njëjtën kohë të realizojë edhe atë që quhet “kulturë e qeverisjes së mirë” nëpërmjet një administrimi të mirë të pronës dhe financave publike, çiltërsisë, transparencës dhe llogaridhënies. Funksionarët shtetërorë duhet të kuptojnë rolin e tyre kundrejt qytetarëve dhe të kuptojnë se arsyeja e vërtetë e ekzistencës së tyre duhet të jetë në shërbim të interesave të shoqërisë, komunitetit, individit.

Në kushtet tona, kur institucionet ende rezultojnë jo të mësura dhe të konsoliduara me ndërjegjen e shtetit të së drejtës, sanksionimi i këtij ligji do të sjellë një kufizim të pushtetit, duke krijuar hapësira të nevojshme, që interesi publik të jetë primar mbi interesat privatë, që zyrtari të mos udhëhiqet nga motaja “po s' bëra për vete nuk mund të bëj për të tjerët”, që deputeti pavarësisht se “gdhihet deputet, të mos ngryset me të afërmit e tij, gruan, vëllezërit dhe motrat, drejtor”.

Nëpërmjet sanksionimit edhe të këtij ligji, qeverisja socialiste garanton

një nga objektivat e saj për ta bërë administratën shqiptare më të përgjegjshme në cilësinë e vendimmarrjes, duke realizuar një nga sfidat kryesore të procesit të integritit në familjen e madhe europiane, pavarësisht nga çdo ekip qeverisës që do të vijë në pushtet përmes rotacionit.

Të mendojmë se tashmë në realitetin shqiptar do të krijohet një terren i përshtatshëm për një “çlirim nga konflikti i interesave”, si pjesë e pastrimit të shoqërisë dhe institucioneve të saj, nga sëmundjet gërryese të karakterit korruptiv.

Shkaktimi i dëmit të ardhur nga shkelja e së drejtës së autorit.

Ligji për të drejtën e autorit

Prof. Asoc. Dr Mariana TUTULANI

1.1 HYRJE

Historikisht e drejta e autorit fillon si një e drejtë ekskluzive për të bërë kopje dhe për të riprodhuar veprën e një autori. Kjo anë e sipërmarrjes tregtare të së drejtës së autorit, lidhet ngushtë me shpikjen e shtypit të shkruar, zbulim i cili bëri më të lehtë kopjimin e një vepre letrare dhe lejoi për herë të parë sipërmarrësit të kryenin shumëfishimin e kopjeve identike. Ana tjetër e kësaj monedhe është se u bë një domosdoshmëri vitale mbrojtja e autorit, tani që puna e tij ose e saj mund të kopjohej shumë më lehtësisht dhe në tirazh shumë më të madh. U ndje se autori duhet të ndante përfitimet e këtij shfrytëzimi të ri të veprës, ndonëse kjo tendencë ishte shumë më e fortë në Europën Kontinentale. Aktualisht, legjislacioni dhe praktika juridike ndërkombëtare ka ecur drejt përsosjes së rregullave dhe mënyrave për të mbrojtur të drejtat e autorëve nga shkeljet dhe cënimet e mundshme si rezultat i kopjimit apo i riprodhimit pa leje të veprave.

1.2 KUPTIMI I SHKELJES SË TË DREJTËS SË AUTORIT

Shkelja e së drejtës së autorit ndodh në ato raste kur dikush ushtron pa autorizim të drejtat e rezervuara në mënyrë ekskluzive për pronarin e së drejtës së autorit, duke i paraqitur ato si të vetat.

Shkelja e së drejtës së autorit për t'u konsideruar e konsumuar nuk ka nevojë të ketë si kriter realizimin e vetëdijshëm dhe kryerjen me qëllim të shkeljes. Edhe shkelja e shkaktuar jo në mënyrë të qëllimshme, pa faj apo në mënyrë spontane sjell përgjegjësi për personin i cili ka shkaktuar shkeljen.

Për sa më sipër shkeljet mund t'i grupojmë në parësore dhe dytësore. Shkeljet kanë të bëjnë me kopjimin, qoftë përmes riprodhimit ose përmes shfaqjes së veprës. Kopjimi mund të jetë:

- **The intention of the infringer and subconscious copying/Kopjimi i pandërgjegjshëm.** Këtu i padituri nuk e kupton se ai po shkel të drejtën e autorit. Të gjithë kemi kontakte me vepra të të drejtës së autorit. Disa prej tyre lënë përshtypje të veçanta në memorien tonë. Në mënyrë jo të ndërgjegjshme ne mund të kopjojmë këto vepra ose pjesë të tyre kur krijojmë punën tonë. Kjo është një shkelje. Shembulli i dukshëm është ai i kompozitorit që dëgjon qindra melodi dhe kur kompozon muzikën e tij, në mënyrë jo të ndërgjegjshme kopjon fragmente të melodive që ka dëgjuar.

- **Indirect copying/Kopjimi indirekt.** Një kopje e një kopjeje indirekt kopjon veprën origjinale dhe përbën një shkelje. Kjo mund të ndodhë tek pikturat, por edhe në rastin e veprave të shkruara.

- **Substantial copying/Kopjimi thelbësor.** Jo çdo akt kopjimi është shkelje. I padituri duhet të ketë kopjuar ose të gjithë veprën ose një pjesë thelbësore të saj. Rastet ku është kopjuar e gjithë vepra nuk janë problematike, por çfarë është një pjesë thelbësore e veprës?¹ Kjo nuk përcaktohet mbi baza sasiore. **Raporti proporcional** midis asaj që është marrë apo kopjuar nga një vepër ekzistuese, me atë që është krijuar rishtaz në një vepër të re është një kriter shumë i rëndësishëm për të përcaktuar nëse jemi para një

¹ Për hollësira lidhur me këtë problem shih, pikën 1.3 të këtij artikulli.

përdorimi të drejtë e të ligjshëm apo para një shkelje të së drejtës së autorit për shkak të kopjimit. Lidhur me këtë problem duhet patur parasysh parimi se: *sa më shumë të kesh marrë apo kopjuar nga një veprë ekzistuese, aq më e madhe është shkelja e së drejtës së autori*". Një element i rëndësishëm për të përcaktuar këtë raport propocional midis asaj që është kopjuar dhe asaj që është krijuar rishtazi është impakti ekonomik i veprës dhe impakti ekonomik i pjesës së kopjuar. **Impakti ekonomik** i “marrjes” së një veprë ekzistuese për t’u përdorur tek një tjetër mbi tregun e shitjes është një moment i rëndësishëm. Nëse natyra e përdorimit të një veprë tek një tjetër është e tillë, që udhëhiqet nga nxjerrja e fitimeve ekonomike, atëherë jemi pa diskutim para një shkelje të së drejtës së autorit dhe para një përdorimi të paligjshëm dhe të padrejtë. Duhet patur mirë parasysh nga gjykata, se shpeshherë mundet që një pjesë e vogël e një veprë të madhe të jetë “zemra” ekonomike e saj. Megjithatë nuk është e mundur të nxjerrim nga kjo ndonjë rregull se të kopjuarit e caq përqindjeje të veprës nuk do të konsiderohet si thelbësore, ndërsa të kopjuarit e caq përqind të veprës do të konsiderohet si të kopjuar thelbësor. Është praktika gjyqësore ajo që do ta përcaktojë këtë gjë rast pas rasti.

- **Issuing copies to the public/Nxjerrja e kopjeve në publik.** E drejta e autorit shkelet edhe kur kopjet e një veprë nxirren. Kjo lloj shkelje del, për shembull, kur muzika në sfond luhet në një dyqan ose restorant. Si e përcaktojmë shprehjen “në publik”? Për të shmangur shkeljen, audiencia duhet të ketë karakter shtëpiak apo intim.

- **Broadcasting and including in a cable program service/ Transmetimi televiziv dhe transmetimi i programit me kabëll.** E drejta e autorit në veprat letrare, dramatike, muzikore dhe artistike, si edhe regjistrimi i zërit, filmat, transmetimi televiziv dhe transmetimi i programeve me kabëll konsiderohen të shkelura në rastin kur këto vepra janë transmetuar në

televizion ose gjatë një shërbimi për transmetim me kabëll.

· **Making an adaptation. Përshtatja** e një vepre letrare, dramatike ose muzikore është gjithashtu një akt i kufizuar. Përshtatjet e veprave artistike përjashtohen. Shembuj janë përkthimet të një vepre letrare në një gjuhë të huaj, përshtatjet e një romani për një dramë ose rregullimet të një vepre muzikore. Që përshtatja të përbëjë një vepër të re në vetvete ajo duhet të kryhet me autorizimin e autorit të veprës origjinale.

Qëllimi i përdorimit të apo karakteri i përdorimit do të shihet i lidhur ngushtë me dy kritere të rëndësishme:

1. Kriteri i komercializmit — domethënë koncepti i realizimit me anë të veprës të një qëllimi tregtar përballë një qëllimi jotregtar;

2. Kriteri i interesit publik – koncepti i realizimit të një interesi publik përballë një interesi privat.

Që përdorimi i veprës së një tjetri të jetë brenda kuadrit të lejuar nga ligji, duhet që të mos bjerë ndesh me dy kriteret e parashikuara më sipër. E thënë ndryshe vepra e një personi tjetër mund të përdoret, nëse nuk bëhet për qëllime tregtare fitimi dhe nëse është në interes të publikut.

1.3 KUPTIMI I ORIGJINALITETIT.

Thelbi i së drejtës së autorit është origjinaliteti, që nënkupton që zotëruesi i së drejtës së autorit është autori i veprës. **Originaliteti i një vepre** qëndron në prezantimin e përpjekjeve artistike dhe krijuese të autorit për të na paraqitur një krijim të ri që nuk është realizuar më parë në kohë, por edhe për të ndryshuar apo përshtatur një vepër që ka ekzistuar, por në kufijtë e një pune serioze, të një përpjekje individuale dhe të një rezultati që sjell një frymë apo një dicka të re në krijim duke ruajtur idenë kryesore të veprës.

Lind pyetja: *Cili është raporti i origjinalitetit me riprodhimin?* Në

thelb një riprodhim i një vepre është nje kopje e asaj vepre. Në literaturën perëndimore sot propagandohet e ashtuquajtura teori e “**djersës së të drejtës së autorit**”². Mbështetur në këtë teori, gjykatat kanë zbatuar një standard origjinaliteti për ato çështje që kërkojnë që autori të demonstrojë investimin e njëfarë pune në prodhimin përfundimtar.

2.1 RREGËT E MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË AUTORIT TË SHKELURA

Aktualisht të drejtat e autorit si ato me karakter pasuror, ashtu edhe ato me karakter jopasuror mund të mbrohen në rast shkelje në dy mënyra:

1- me anë të padive civile me objekt:

- shpërblimin e dëmit pasuror ose jopasuror;
- përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata + shpërblim dëmi dhe
- zgjidhje e kontratës + shpërblim dëmi.

2- me anë të rrugës penale bazuar në nenet 148 dhe 149 të Kodit Penal për:

- botimin e veprës së tjetrit me emrin e vet dhe,
- riprodhimin e veprës së tjetrit pa leje.

2.2 TE REJAT QE SJELL LIGJI PËR TË DREJTËN E AUTORIT LIDHUR ME SHKELJEN E SË DREJTËS SË AUTORIT DHE SHPËRBLIMIN E DËMIT

Ligji për të drejtën e autorit ka shtuar edhe **një rrugë të re mbrojtje për të drejtat e autorit që është rruga administrative**. Më konkretisht,

² Lidhur me këtë teori shih: Arthur R. Miller, Michael H. Davis “Intellectual Propert, Patents, Trademarks and Copyright”, 1991, faqe 290-304.

rastet e kundravajtjeve administrative të parashikuara nga ligji janë kur një person:

a) riprodhon, dhe paraqet ne publik për qëllime tregtare veprën e një personi tjetër, ose shfaq përmbajtjen e një vepre të tillë përpara se se ajo të bëhet publike;

b) riprodhon ose jep shfaqje në tejkalim të numrit për të cilat gëzonte të drejtën e riprodhimit ose të shfaqjes;

c) ritransmeton veprat muzikore ose audiovizuale nëpërmjet radios ose televizionit;

ç) shumfshon dhe shpërndan³ programe kompjuteri për qëllime përfitimi;

d) shumëfshon ose riprodhon vepra të krijuara për shpërndarje kinematografike ose televizive, regjistron në shirit ose në çdo lloj mbajtësi tjetër të aftë për mbajtjen e fonogrameve ose videogrameve të veprave kinematografike, audiovizuale, ose sekuenca të pamjeve të lëvizshme, për qëllime përfitimi dhe me çdo lloj mjeti;

dh) shet, jep hua ose me qira videokaseta, audiokaseta ose çdo lloj mbajtësi tjetër, i cili përmban fonograme ose videograme të veprave kinematografike ose audiovizuale, ose sekuenca të pamjeve të lëvizshme, të cilat nuk janë të pajisura me pullën artistike të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, sipas dispozitave të këtij ligji, në bazë të një leje për ushtrimin e veprimtarisë tregtare;

e) nuk deklaron në Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit, shitjet e veprave⁴

ë) kryen veprime si ndërmjetës, ose si agjenci për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit ose të artistëve të tjerë.

³ Termi “shpërndan” nënkupton cdo veprim shitje, qiraje, huaje, importimi, e te tjera.

⁴ Shitjen e një vizatimi ose shtypjeje në një mbajtës të sheshtë me një çmim mbi 2.000 lekë, të një pikturë me një çmim mbi 3.000 lekë ose të një skulpturë me një çmim mbi 5.000 leke;

2.3 MASAT QË MERREN NË RAST SHKELJE TË TË DREJTAVE TE AUTORIT JANË:

- Për kundravajtjet administrative me **gjobë** 10.000 lekë në 850.000 lekë;
- Për një kundravajtte penale **gjobë ose burgim deri në një vit** si dhe, **sekuestrimit e mjeteve** apo të pajisjeve te prodhimit;

· **asnjanësimin ose shkatërrimin e kopjes** ose prodhimit të kësaj vepre të deformuar, të copëtuar ose në çdo rast të ndryshuar. Veprimet në mbrojtje të të drejtave vetjake jopasurore që lidhen me autorësinë në një vepër, kanë si qëllim asnjësnimim ose shkatërrimin e kopjes ose prodhimit të kësaj vepre, vetëm nëse dëmi nuk mund të riparohet me anë të shtesës, të shënimit në vepër ose të reklamës për sa i përket autorësisë.

· Shkatërrimi ose asnjësnimi nuk mund të kërkohet në vitin e fundit të afatit të së drejtës së shfrytëzimit. Në një rast të tillë, mund të vendoset **sekuestrimi i veprës** ose i prodhimit në çdo kohë, deri në mbarim të këtij afati.

- **Konfiskimi i veprës**, me vendim përfundimtar.

Të drejtat e personit të dëmtuar janë:

- të kërkojë shkatërrimin e veprës, apo të materialeve dhe pajisjeve që kanë ndihmuar në realizimin e shkëljes, shkatërrimi i kopjes së riprodhuar në kundërshtim me ligjin, asnjësnimi i specimenit;

- zotërimin kundrejt vlerës të kopjes, pajisjeve, apo të specimenit, që i zbritet vlerës së dëmit të shkaktuar;

- sekuestrimit e veprës apo të kopjeve të saj, mbështetur në inventarizimin, raportimin dhe ekspertimin lidhur me veprën sdhe shkëljen;

- konfiskimin e veprës apo të materialeve dhe pajisjeve të nevojshme për kryerjen e shkëljes, si dhe konfiskimin e të gjitha përfitimeve të arritura nga tregëtimi dhe shitja e kopjeve apo riprodhimeve të veprës origjinale.

2.4 INSTITUCIONET KOMPETENTE ADMINISTRATIVE

Një e re tjetër që sjell ligji për të drejtën e autorit është se janë parashikuar

të ngrihen disa **struktura të reja administrative** të rëndësishme, të cilat janë:

- *Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit* është institucion qendror, person juridik publik, në varësi të Kryeministrit, e cila krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

- *Inspektorati pranë Zyrës Shqiptare për të drejtat e Autorit*, që vendos për masën e gjobës, e cila ekzekutohet nga organet tatimore. Ajo mund të ankimohet në strukturën më të lartë administrative brenda 10 ditëve nga marrja dijani e gjobës. Nëse nuk është dakort me vendimin, personi i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës.

- Përveç tyre, Prefekti ose Nënprefekti i zonës, ka të drejtë që të ndalojë çdo shfaqje publike për të cilën nuk ekzistojnë prova shkresore të miratimit të saj, të regjistrimit dhe të çertifikimit nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit.

3.1 SHPËRBLIMI I DËMIT DHE LIGJI PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Format e dëmit që parashikon ligji për të drejtën e autorit dhe masat konkrete për mbrojtjen e të drejtave të autorit nga shkelja janë të grupuara në nenet 118 deri 129 të tij. Megjithatë kjo nuk do të thotë se shkelja e dispozitave të tjera të ligjit i përjashton subjektet dhunuese nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit.

Më konkretisht janë shkaqe juridike për të pretenduar shpërblimin e dëmit veprimet e mëposhtme:

- Pengimi i autorit apo përdoruesit me titull nga e drejta e shfrytëzimit të veprës;

- Cënimi i ushtrimit të së drejtës për shfaqjen e veprës audiovizuale, kinematografike, teatrale, kompozimet muzikore në publik, të parashikuara shprehimisht nga nenet 118, 119 dhe 121. Por padia për shpërblimin e dëmit mund të ngrihet në cdo rast kur shkelen të drejta morale dhe ekonomike të parashikuara nga ligji.

Për të qenë të saktë, grupimi i disa dispozitave të ligjit në Kreun III nën titullin Shpërblimi i dëmit, në fakt nuk na liston të gjitha rastet kur shkelja e së drejtës së autorit sjell më pas përgjegjësinë për shkaktimin e dëmit, por ndalon më tepër tek legjitimiteti i personit të dëmtuar dhe tek masat dhe të drejtat e tij për të mbrojtur veten nga shkelja.

3.2GJYKATA SHQIPTARE DHE E DREJTA E AUTORIT

Gjykata shqiptare vjen duke u përballur gjithmonë e më shumë me raste kur kërkohet pushimi i cënimit të së drejtës së autorit dhe shpërblimi i dëmit të ardhur nga shkeljet e së drejtës së autorit. Duke analizuar këtë praktikë shohim se shkeljet mund t'i grupojmë si më poshtë:

A- Shkelje e të drejtave morale të autorit dhe shpërblimi i dëmit që vjen prej tyre. Kjo ndodh atëherë kur në veprën e autorit nuk vihet emri i tij fare ose, kur vihet emri i një personi apo institucioni. Kështu mund të përmendim rastin A.R kundër Ministrisë së Arsimit, ShBLSH, M.Gj dhe Sh.Rr,⁵ ku A.R-ja ka kërkuar njohjen e bashkëautorësisë mbi veprën “Shkronjë pas shkronje”, vendosjen e emrit të autorit dhe mbrojtjen e të drejtave të tij morale. Padiësi pretendon se është autori grafik i abetares “Shkronjë pas shkronje” dhe kërkon vendosjen e emrit të tij në kopertinën e saj. Ai ka pasur paraprakisht një kontratë botimi me dy bashkëautorët e tjerë të paditur me SHB “Mësonjtorja e parë”, por kjo nuk u realizua sepse Ministria e Arsimit, me urdhërin nr. 123, dt. 15.5.01, urdhëroi SHBLSH të fillonte botimin e abetares. Kjo e fundit kishte grafistin e saj. Të paditurit pretenduan se krijimi nuk ishte origjinal, por kopjim i figurave të gatshme të marra në Clip Art nga kompjuteri dhe nga libra të tjerë. Vendimi i gjykatës mbështetur në mendimin e ekspertit grafist G.B se punimet e grafistëve nuk paraqesin vepra

⁵ Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë Nr. 4151, datë 25.10.02 ka vendosur rrezimin e padisë

originale, konkludoi se nuk jemi para veprave që gëzojnë mbrojtjen e të drejtës së autorit.

Në një rast tjetër MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES kundër Fondacionit “CRS” ALBANIA⁶ rezultoi se A-ja ka përgatitur dhe dorëzuar tre vepra origjinale të shkruara me nismën e saj personale: “Vezhguesi Ditor”, “Dite pas Dite” dhe “Ditari Shkollor” në Institutin e Studimeve Pedagogjike dhe këto vepra vendosen të përdoren nga ky Institut për nxënësit e shkollave të mesme. Ministria e Arsimit vendos botimin dhe shumëfishimin e tyre, dhe në cdo kopje nuk e vendos emrin e autores, por vetëm Institutin e Studimeve Pedagogjike. E paditura kërkon njohjen e së drejtës së pronësisë mbi veprat, sepse ajo është autore e këtyre veprave, si dhe shpërblimin e dëmit material dhe moral të shkaktuar.

B- Shkeljen e të drejtave ekonomike të autorit. Zakonisht ky lloj konflikti vjen si rezultat i kopjimit të veprës së një autori nga një tjetër, ose në formën e riprodhimit të veprës së një personi pa lejen e këtij të fundit. Lidhur me riprodhimin e veprës dhe përshtatjen e veprës pa leje mund të përmendim rastin R kundër revistës “Albanian Observer”⁷ dhe objekt pushimin e cënimit të së drejtës së autorit dhe detyrimi për mospërsëritjen e tij, si dhe detyrimi për të dëmshpërblyer dëmin e shkaktuar për shkak të riprodhimit dhe të ndryshimit të veprës së tjetrit, pa autorizimin e autorit. Autorja ka bërë një pikturë e cila është vendosur në kopertinën e një reviste që boton i padituri, e dubluar sipas imazhit të pasqyrës dhe pretendon se nuk është vendosur emri i saj në pikturë dhe është botuar pa i marrë leje, duke u ndryshuar edhe pamja e saj. Gjykata ka konstatuar shkeljen e së drejtës së autorit për riprodhim

⁶ Shih Vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë Nr. 555, date 3.5.2002

⁷ Shih Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Nr. 1478, datë 08.04.2003

dhe botim pa leje, ka vendosur që revista të botojë pikturën me emrin e autores dhe të shpërblejë një dëm në masën 500 USD. Lidhur me dëmin moral të kërkuar nga paditësi, gjykata çmon se nuk jemi para ndonjë dëmi material apo moral shkaktuar autores, sepse nuk ka ndonjë shtrembërim të origjinalit, të tillë që të shkaktojë ndonjë qëndrim përçmues dhe fyes ndaj autores, apo që të sjellë uljen e personalitetit dhe figurës së saj morale.

C- Një formë tjetër e konfliktit civil që gjen hapësirë në çështjet gjyqësore është ajo për shkak të **Veprës së krijuar gjatë kohës së punës**. Në rastin R.SH kundër “BOTIMET ENCIKLOPEDIKE” SH.A⁸ rezulton se R.Sh-ja ka përkthyer dy vepra në gjuhën shqipe. Në periudhën që janë përkthyer librat R.Sh-ja ka qenë i punësuar tek i padituri në bazë të kontratës së punës të lidhur në datën 01.03.1997. Kontrata parashikonte se: ...”përkthimet e bëra për punëdhënësin dhe nën iniciativën e tij janë në pronësi të punëdhënësit”. Në rastin konkret, këto përkthime nuk janë kryer me urdhër apo nën udhëzimet e punëmarrësit, por janë bërë si punë personale e R.Sh-së. Meqenëse shtëpia botuese “BOTIMET ENCIKLOPEDIKE” SH.A ka riprodhuar veprat, duke vendosur në to emrin e përkthyesit, i padituri R.Sh ka kërkuar me padi: Njohjen e së drejtës së pronësisë mbi përkthimin në gjuhën shqipe të veprave “100 vjet vetëm” të G.G.Markes dhe “Obelisku i zi” i E.M Remark, Përmbushjen e detyrimit të të paditurit për të tërhequr të gjitha kopjet e pashitura të librit dhe për të vendosur në cdo kopje shënimin se e drejta e autorit mbi përkthimin i takon paditësit dhe përmbushjen e detyrimit të të paditurit për lidhjen e kontratës paditësin për botimin e librave.

D. Zgjidhje e kontratës së ekskluzivitetit të botimit është një formë tjetër

⁸ Shih Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë Nr. 1030, date 23.3.2001.

konflikti gjyqësor. Në rastin M.G dhe K.G kundër SHB “Onufri”⁹ kanë kërkuar zgjidhjen e tre kontratave për ekskluzivitetin 10-vjeçar të botimit dhe ribotimit të veprës së plotë të poetit Lasgush Poradeci deri në vitin 2008. Më 1.12.1998 palët kanë lidhur kontratën në fjalë për botimin e vëllimit “Poezia” në 5000 kopje dhe të volumit të dytë të “Publicistika” në 2000 kopje, ndërsa në datën 12.11.1999 është lidhur një kontratë për botimin e volumit të tretë (ditar-korrespondencë) në 1000 kopje. Shpërblimi i paditëseve u përcaktua 14% mbi çmimin e shitjes. Kontrata nuk ka caktuar afate për përmbushjen e detyrimeve të palëve. Lidhur me dy volumet e para shlyerja e honorarit ishte caktuar $\frac{1}{2}$ pas botimit të librit dhe $\frac{1}{2}$ tre muaj pas hedhjes së tij në treg. Ndërsa për të tretin nuk ka asnjë përcaktim.

I padituri ka botuar pa leje edhe librin “Dora jote ledhatare” në 500 kopje, por pëlqimi është marrë më vonë dhe pagesa është bërë. Pala paditëse ka rezerva për cilësinë e botimit, por pagesat i ka pranuar. Paditësi ka kërkuar marrjen e masës së sigurimit të padisë për të bllokuar dhe ricikluar e vulosur me vulën Fondacioni “L.Poradeci” gjithë kopjet e pashitura që ndodheshin në depo e magazina, por gjykata e ka rrëzuar këtë kërkesë. Gjykata e ka rrëzuar padinë meqenëse i ka rezultuar se detyrimet e SHB janë përmbushur.

E. Shpërblimi i dëmit nga shkelja e së drejtës së autorit. Në rastin shoqata A kundër televizionit privat “Media VIZION” rezulton se paditësi lidh një kontratë me televizionin privat “MEDIA VIZION”¹⁰ në datën 18.7.2000, lidhur me të drejtën për të transmetuar vepra muzikore të autorëve të drejtat e të cilëve mbrohen nga kjo shoqatë.”MEDIA VIZION” bie dakort që të paguajë për transmetimin një shpërblim të barabartë me një milion

⁹ Shih Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Nr. 12, datë 10.1.2002

¹⁰ Shih Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë Nr. 4378, date 21.12.2001. ose Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë Nr. 1423, date 9.4.2002 ku shoqata Albautor ka ngritur padi kundër Televizioni Arberia Sh.A.

lekë. Në rast vonese “MEDIA VIZION” detyrohet t’i paguajë shoqatës Albautor një kusht penal në vlerën 0.5% për cdo ditë vonesë. Për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kontraktore, shoqata Albautor ngre padi në gjykatë dhe kërkon shpërblimin e dëmit të ardhur.

Kuadri i ri ligjore i rregullimit të së drejtës së autorit

Dr. Juliana Latifi

Në një shoqëri të bazuar në vlera dhe parime demokratike, mbrojtja e së drejtës të autorit përbën një nga drejtimet parësore të integritetit të saj, si dhe vazhdimësi të trashëgimisë kulturore, shkencore, teknologjike në breza.

Integrimi i Shqipërisë në BE kërkon përmbushjen e disa standardeve të gjithëpranuara, ku përqsaja e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, do të jetë parakushti i parë dhe i domosdoshëm, që familja e madhe europiane të hapë dyer edhe për Shqipërinë.

Nevoja e rregullave të reja në fushën e mbrojtjes së të drejtës së autorit, sot paraqitet si një domosdoshmëri, e cila rrjedh nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë¹ dhe nga një sërë aktesh ndërkombëtare në të cilat shteti shqiptar ka aderuar².

Proceset demokratike, të cilat ndodhën në Shqipërinë e pas viteve '90, diktuan nevojën edhe të miratimit të një ligji të ri për mbrojtjen e së drejtës të autorit.

Ligji nr.7564, datë 19.5.1992 “Për të drejtën e autorit” sanksiononte një regjim të ri juridik, në fushën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale, pjesë e së cilës është edhe e drejta e autorit.

¹ Kushtetuta e RSH-së, neni 58 sanksionon parimin: “E drejta autorit mbrohet me ligj”.

² Ligji nr 8838, datë 22.11.2001 “Për aderimin e RSH-së në Traktatin e OBIP-së “Për të drejtën e autorit””, ligji nr.8740, datë 15.2.2001 “Për aderimin e RSH-së në Traktatin e OBIP-së “Për interpretimet, ekzekutimet dhe fonogramet””.

Në një kontekst krahasimor me legjislacionin që i përkiste periudhës së regjimit komunist, ligji e shikonte të drejtën e autorit në një këndvështrim të ri, larg çdo ndikimi politik dhe ideologjik.

Në rast se i referohemi dispozitave të Kodit Civil të vitit 1982³, pjesë përbërëse e së cilës ishte dhe e drejta e autorit, mbrojtja që i bëhej asaj ishte tepër e mangët. Në të sanksionohej: “Objekt i së drejtës së autorit janë të gjithë veprat e krijimtarisë në fushën e prodhimit dhe të shkencës, veprat letrare ose artistike, që i shërbejnë ndërtimit të socializimit dhe edukimit komunist të masave, cilado qoftë mënyra dhe forma e paraqitjes dhe destinimi i tyre.

Janë gjithashtu objekt i së drejtës së autorit përshtatjet, inskenimet, ekranizimet, orkestrimet dhe çdo transformim i veprave letrare, muzikore ose shkencore, si dhe përkthimet e veprave letrare ose shkencore në një gjuhë tjetër”.

Në jurisprudencën e asaj kohe e drejta e autorit, pavarësisht se shikohej si një unitet i së drejtës morale dhe ekonomike, Kodi Civil i trajtonte ato tepër përciptë⁴. Paradoksi shkonte edhe më tej. Në një nen të tij sanksionohej : “Kur e kërkon interesi i përgjithshëm... , lejohet botimi, shfaqja, ekzekutimi ose përdorimi në ndonjë mënyrë tjetër i veprave letrare dhe i ditareve vetjake të pabotuar edhe pa pëlqimin e autorit” .

Sistemi i ri që u vendos diktoi nevojën e abrogimit të legjislacionit që kishte rregulluar marrëdhëniet ekonomike-shoqërore të një shoqërie socialiste, dhe lindi nevoja e miratimit të ligjeve të reja, të cilat duhet t’i përgjigjeshin kushteve të një shoqërie paskomuniste, ku prona private do të ishte determinante në përcaktimin e marrëdhënieve të reja.

Në kuadrin e ligjeve që u miratuan një vend të rëndësishëm zuri edhe mbrojtja e të drejtave vetjake dhe pikërisht me ligjin nr.7564, datë 19.05.1992

³ Kodi Civil/ 1982, kreu VII, nenet 315-328.

⁴ Kodi Civil/1982, nenet 323-328

u sanksionua një regjim i ri juridik për mbrojtjen e të drejtës së autorit.

Ligji nr.7564, datë 19.4.1992 “Për të drejtën e autorit” shënoi një çast tepër progresiv në fushën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale, si dhe solli një element të ri; e drejta e autorit nuk do të inkorporohejë brenda Kodit Civil, por ajo do të rregullohejë me një ligj të veçantë, çka u bë edhe më i qartë me miratimin në nëntor të vitit 1994 të Kodit Civil aktual.

Ligji nr.7564, datë 19.5.1992 “Për të drejtën e autorit” solli një pamje të re në rregullimin e marrëdhënieve në këtë fushë.

Në një këndvështrim krahasues me rregullimin që bënte Kodi Civil i vitit 1982, mbrojtja e së drejtës të autorit përfshinte: veprat letrare, artistike e publicistike dhe veprat e tjera (që këtu do të quhen thjesht “vepra” ku futet çdo krijim origjinal intelektual i kësaj natyre, pavarësisht nga forma e shprehjes si:

- a) vepra të shkruara, duke përfshirë edhe programe kompjuter;
- b) leksione, fjalime, predikime dhe vepra të tjera të shprehura gojarisht;
- c) vepra muzikore me ose pa tekst shoqërues;
- ç) vepra teatrore ose teatrore-muzikore;
- d) vepra koreografike dhe pantomima;
- dh) vepra audiovizuale;
- e) vepra të arteve të bukura: vizatime, piktura, skulptura, gdhendje e litografi;
- ë) vepra arkitektonike;
- f) vepra fotografike;
- g) vepra të artit të aplikuar;
- gj) ilustrime, harta, plane, skica dhe vepra trepërmasore në fushën e gjeografisë, të topografisë, arkitekturës dhe shkencës (neni 1, ligji nr.7564, date 19.5.1992).

Nga ana tjetër ligji, bënte edhe përjashtimet përkatëse, duke mos futur në kategorinë e veprave letrare dhe artistike:

- a) përmbledhëset e gazetave zyrtare të karakterit legjislativ e administrativ

dhe përkthimet zyrtare të tyre;

- b) shprehjet popullore;
- c) lajmet e ditës;
- ç) thjesht faktet e të dhënat.

Për herë të parë në ligj, në mënyrë të shprehur, e drejta e autorit njohej si e drejtë morale dhe ekonomike.

E drejta morale i referohej të drejtës që ka çdo autor, për të kërkuar autorësinë e veprës së tij, veçanërisht të drejtën që emri i tij të shkruhet në kopjet e veprës.

Gjithashtu, autori i veprës kishte të drejtë, që në kuadër të të drejtave morale që i takonin, të kërkonte që vepra e tij të mbetej edhe anonime ose të përdorte një pseudonim.

Sfera e të drejtave morale nënkuptonte edhe të drejtën që kishte çdo autor për të mbrojtur veprën e tij kundrejt çdo shtermbërimit, heqje ose ndryshim, si dhe çdo veprim përçmues që do të cenonte nderin dhe dinjitetin e tij.

E drejta morale, e lidhur ngushtë me autorin, ruhej përgjithmonë, pra në përcaktimin që jepte vetë ligji, ajo do t'u takojë edhe trashëgimtarëve brez pas brezi.

Në lidhje me të drejtat ekonomike, ligji i cilësonte ato si të drejta “ekskluzive” (neni 5, ligji nr.7564, datë 19.5.1992), në sferën e të cilave futeshin:

- a) riprodhimi i veprës;
- b) importimi i veprës në vend, me qëllim shpërndarjeje (shitjeje, marrjeje me qira, dhënieje me qira, dhënieje hua) për publikun;
- c) përkthimi i veprës;
- ç) përgatitja e përshtatjeve, e sistemimeve a transformimeve të veprës;
- d) shfaqja e deklamimi i veprës para publikut;
- dh) komunikimi i veprës për publikun me anë të transmetimit ose ritransmetimit;
- e) transmetimi i veprës për publikun me kabllo a mjet tjetër.

Nga ana tjetër, e drejta e gëzimit të të drejtave ekonomike nga autori i veprës njihete edhe disa kufizime. Në dispozitat përkatëse të ligjit nr.7564, datë 19.5.1992 sanksionohen rregullat për kufizimin e të drejtave ekonomike.

Në një këndvështrim të gjerë këto kufizime ishin ndalime të cilat siguronin një mbrojtje të autenticitetit të së drejtës së autorit. Kështu, nuk lejohej riprodhimi i veprave me vlera arkitekturore në formën e ndërtesave; riprodhimi reprografik i veprave të arteve të bukura të botuara në sasi të kufizuara, ku përfshihet paraqitja grafike e veprave muzikore (fletë muzike) dhe e fletoreve me shënime ose e botimeve të tjera të paracaktuara për një qëllim të vetëm përdorimi; riprodhimi i programeve të kompjuterëve; çdo riprodhim tjetër që do të binte në kundërshtim me procesin e shfrytëzimit të veprës dhe do të dëmtonte interesat legjitimë të autorit.

Të drejtat ekonomike, si të drejta pasurore, gëzonin një mbrojtje të posaçme ligjore, gjatë gjithë jetës së autorit të tyre dhe 50 vjet pas vdekjes⁵.

Në kuadër të karakterit ekonomik, që shfaqte e drejta e autorit, ligji sanksiononte në të njëjtën kohë edhe të drejtën që kjo e drejtë mund t'u kalonte të tjerëve, si dhe të licencohej, çka i përgjigjej më së miri kushteve të reja të zhvillimit ekonomiko-shoqëror, që po ofronte tashmë realiteti i ri.

Për herë të parë me anë të një ligji në Shqipëri sanksionohej ngritja e një "agjencie të specializuar për mbrojtjen e të drejtave të autorit". Kjo agjenci, do të njihet si i vetmi, person juridik në Shqipëri për administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve.

Ajo do të ishte një person juridik publik, e cila do të zhvillonte veprimtarinë e saj në bazë të këtij ligji, si dhe të një Rregulloreje përkatëse, të miratuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Pas gati 13 vjetësh veprim, ligji do të linte mjaft për të dëshiruar, çka do

⁵ Me amendimet që iu bënë ligjit nr.7564, datë 19.5.1992, me ligjin nr. 7932, datë 19.04.1995 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7564, date 19.5.1992 "Për të drejtën e autorit"", mbrojtja e të drejtave ekonomike u shtri në një afat kohor 70-vjeçar.

të shtronte domosdoshmërinë e një rregullimi me adekuat dhe të plotë të të drejtës së autorit.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar në nëntor të vitit 1998, si dhe aderimi në një sërë konventash dhe aktesh ndërkombëtare në fushën e së drejtës së autorit, kërkonin një paraqitje sa më dinjitoze në mbrojtjen e kësaj të drejte.

Garancitë e parashikuara në Kushtetutë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në këtë kuadër edhe të së drejtës së autorit dhe sidomos njohja e statusit të marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara në raport me ligjin e brendshëm, do të ishte një masë shumë e rëndësishme për “*bindjen*” ndaj parimeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në këtë kontekst, miratimi i një ligji të ri në fushën e së drejtës së autorit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, siguron një rregullim dhe një garantim të të drejtave të autorit, duke njohur nevojën të paraqesë rregulla të reja, në mënyrë që të mundësojë zgjidhje të përshtatshme ndaj çështjeve të ngritura nga zhvillimi ekonomik, social, kulturor dhe teknologjik.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë shënon një çast tepër progresiv, në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të individit; ajo udhëhiqet nga parimi: *Të drejtat dhe liritë* e sanksionuara në të nuk janë deklarative, ato nuk janë thjesht aspirata për të ardhmen dhe kjo do të thotë së çdo dispozitë përmban në vetvete detyrimin e shprehur të shtetit dhe mundësinë efektive të individit ose të grupimit social përkatës, për të vënë në vend të drejtat. Atje ku parashikohet një e drejtë ekziston edhe mundësia efektive e realizimit të saj.

Në nenin 58 të Kushtetutës sanksionohet: “Liria e krijimit artistik dhe e kërkimit shkencor, vënia në përdorim, si dhe përfitimi prej arritjeve të tyre janë të garantuara për të gjithë. E drejta e autorit mbrohet me ligj.”

Shteti dhe shoqëria marrin përsipër aq detyrime ndaj individit sa janë në gjendje t’i përballojnë efektivisht në një stad të caktuar të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të vendit. Mbi një bazë kushtetuese sociale, shteti, duke ndjekur

ecurinë e procesit shkencor e teknologjik dhe të arritjeve ekonomike, ka mundësi që me ligj të zgjerojë gradualisht gamën e detyrimeve të veta ndaj individit.

Duke njohur nevojën, për të vendosur një ekuilibër midis të drejtës së autorit me interesat e përgjithshëm publikë, ligji i ri paraqit një kuadër të ri ligjor në përcaktimin e mekanizmave ligjorë dhe administrativë, që duhen për të siguruar respektimin e të drejtave të autorit.

Në një kontekst krahasimor, ligji i ri titullohet: “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të”. Qëllimi i tij është që të “Garantojë mbrojtjen e së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të .”⁶

Të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhur me të (të drejtat e artistëve interpretues dhe ekzekutues; të drejtat e prodhuesve të regjistrimeve fonografike; të drejtat e prodhuesve të veprave kinematografike ose të veprave të tjera audiovizuale; programet e kompjuterit; veprat e arteve të bukura, të arkitekturës dhe fotografisë; baza e të dhënave etj), përfshijnë veprimtarinë krijuese, tregtare, prodhuese ose çdo veprimtari tjetër vlerësimi, shfrytëzimi, përdorimi a tjetërsimi të veprave letrare, artistike, shkencore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Duke u fokusur në disa drejtime, shikohet se ligji sjell futjen elementeve të reja.

Për herë të parë në ligj gjen zbatim nocioni i “kontratës”, në kuptimin “e kontratës së botimit” dhe “të kontratës për shfaqjet muzikore dhe teatrore”.

Në kontratën e botimit⁷, autori me anë të saj i kalon botuesit, kundrejt një shpërblimi, të drejtën e prodhimit, të riprodhimit dhe të shpërndarjes së veprës.

Në kontratën për shfaqjet muzikore dhe teatrore⁸, autori, titullari i së drejtës së autorit, një person tjetër, organizuesi i shfaqjes, realizon kalimin e

⁶ Ligji “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të”, neni 1.

⁷ Po aty, neni 38

⁸ Po aty, neni 49

të drejtës së shfaqjes në publik të veprës letrare, dramatike, dramatiko-muzikore, koreografike ose të një pantomime.

Që kontratat të realizojnë efektet e tyre, ato janë të nevojshme të regjistroheshin pranë një organi përkatës, i cili në ligjin e ri do të quhet “Zyra shqiptare për të drejtën e autorit”⁹. Vetëm pas regjistrimit dhe certifikimit pranë kësaj Zyre, kontratat fillojnë efektet e tyre.

Kjo Zyrë në ligj përkufizohet si një person juridik publik në varësi të Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe do të veprojë si një rregullatore, në rregullimin e marrëdhënieve, të cilat do të garantojnë një respektim të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të. Ligji nuk parashikon në mënyrë të detajuar organizimin dhe funksionimin e kësaj Zyre, por ai sanksionon klauzolen që “Statusi, objekti i veprimtarisë, organizimi i brendshëm..., si dhe çështje të tjera që lidhen me funksionimin e kësaj Zyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Një aspekt i ri dhe tepër i rëndësishëm i ligjit është pamja e gjerë e rregullimit të marrëdhënieve të pronësisë intelektuale.

Në kuadër të së drejtës së autorit, siç e citova edhe më sipër, ligji sjell një rregullim edhe të të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit.

Ligji rregullon të drejtat e artistëve interpretues dhe/ose ekzekutues. Në kuptim të këtij ligji, artistë interpretues dhe/ose ekzekutues¹⁰, janë aktorët, këngëtarët, muzikantët, valltarët dhe personat e tjerë që paraqesin, këndojnë, kërcëjnë, recitojnë, luajnë, interpretojnë në drama, filma, që drejtojnë një orkestër a shfaqin, në çdo lloj mënyrë, një krijim artistik ose letrar, një shfaqje të çdo lloji, përfshirë folklorin, varietenë, cirkun dhe shfaqjet me kukulla.

Të drejtat morale të artistëve interpretues dhe/ose ekzekutues, janë të lidhura ngushtë me prodhimin që realizohet prej tyre. Ligji sanksionon në mënyrë taksative, se çdo shfaqje në publik ose transmetim a fiksion i veprës

⁹ Po aty, neni 117

¹⁰ Po aty, pjesa II, kreu II

në ndonjë regjistrim fonografik, film, në një mbajtës tjetër veprash audiovizuale ose në çdo prodhim tjetër të ngjashëm me to, duhet të përmendë emrin e artistit interpretues dhe/ose ekzekutues.

E drejta e autorësisë mbi veprën e tij i jep artistit interpretues dhe/ose ekzekutues të drejtën që të kërkojë respektimin e cilësisë së shfaqjes dhe të kundërshtojë çdo ndryshim ose falsifikim të saj.

Çdo veprim, i cili mund t'i cenojë nderin ose emrin nëpërmjet shpërndarjes, transmetimit ose riprodhimit të veprës së tij, është i kundërshtueshëm dhe ai përbën një cenim të së drejtës morale të tij.

Duke iu përmbajtur parimit të përgjithshëm për rregullimin e të drejtave morale, ligji sanksionon edhe një herë rregullin, që edhe e drejta morale e artistëve interpretues dhe/ose ekzekutues është e trashëgueshme.

Në rregullimin që u bëhet të drejtave të kësaj kategorie artistësh, është edhe trajtimi i “të drejtave pasurore që lindin nga kontrata e punës”. Këto të drejta, sipas kontratës së punës, i takojnë shprehimisht punëdhënësit për një afat kohor të caktuar. Përjashtim nga ky rregull bëhet vetëm atëherë kur në kontratën e punës është parashikuar ndryshe. Ligji sanksionon një afat të përgjithshëm kohor që është afati 3-vjeçar. Me mbarimin e këtij afati, të drejtat pasurore i kthehen punëmarrësit, artistit interpretues dhe/ose ekzekutues.

Një çast me shumë rëndësi dhe që i pret rrugën shpërdorimeve, të cilat janë vënë re në këtë fushë, është “e drejta ekskluzive e shfrytëzimit të shfaqjes”, duke vendosur kriteret të sakta për zhvillimin e tregut të biznesit artistik. Artistët interpretues dhe/ose ekzekutues që marrin pjesë në prodhimin e një vepre audiovizuale ose në regjistrimin e fonogrameve të ndryshme, prezumohen se ia kalojnë prodhuesit të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit të shfaqjes me anë të fiksimit, riprodhimit, shpërndarjes dhe përcjelljes në publik. Me realizimin e kësaj klauzole ata kanë të drejtë të përfitojnë 50 për qind të shumës nga të ardhurat neto, të grumbulluara nga prodhuesi.

Një kategori tjetër subjektësh, që i nënshtrohen efekteve të këtij ligji janë

edhe “prodhuesit e regjistrimeve fonografike¹¹”. Këta persona kanë të drejtë që drejtpërdrejt nga një shfaqje artistike të realizojnë regjistrimin e veprës dhe fiksimin e saj në një mbajtës fonografik ose në një mjet të ngjashëm për riprodhimin e tingujve dhe të zërave.

Me autorizimin e autorit ose titullarit të së drejtës të autorit, ata kanë të drejtën ekskluzive të shpërndajnë dhe të riprodhojnë regjistrimet fonografike, si dhe t’i japin me qira ose huadhënie.

Këto të drejta ekskluzive, të njohura nga ligji, garantojnë në të njëjtën kohë edhe respektimin e tyre nga të tretët. Kështu, prodhuesit e regjistrimeve fonografike gëzojnë të drejtën që të kundërshtojnë çdo veprim të paautorizuar të regjistrimit fonografik ose përdorimin e çdo mjeti tjetër për të riprodhuar tinguj a zëra, nëse i cenohen interesat tregtarë për veprën.

Regjistrimet fonografike, që të jenë të vlefshme, duhet në të njëjtën kohë që të përmbushin disa kushte dhe kriteret të cilat janë të domosdoshme për t’u realizuar shpërndarja e tyre.

Ligji liston këto kushte:

- a. Titullin e veprës së riprodhuar;
- b. emrin e autorit;
- c. emrin e artistit interpretues dhe/ose ekzekutues. Grupet orkestrale ose korale identifikohen me emrin e tyre artistik;
- ç. datën e prodhimit;
- d. pullën artistike të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, të pakonsumuar;
- dh. shenjen “P” të prodhuesit, fiksuar pazgjidhshmërisht në mbajtës.

Ligji vepron edhe mbi “të drejtat e prodhuesve të veprave të kinematografisë ose të veprave të tjera audiovizuale¹²”, duke i dhënë fund debatit të stërzgatur mbi pronësinë e prodhimeve të caktuara

¹¹ Po aty, pjesa II, kreu III.

¹² Po aty, pjesa II, kreu IV.

kinematografike, të realizuara nga personat juridikë publikë.

Veprat kinematografike ose veprat e tjera audiovizuale bashkojnë në vetvete të drejtën e autorit të subjektit, të autorit të skenarit, të autorit të dialogut, si dhe të kompozitorit dhe regjisorit.

Në kontekst të kësaj bashkësie personash, përkatësisht me të drejtat e tyre, ushtrimi i të drejtës për një shfrytëzim pasuror të saj i përket personit, i cili ka realizuar prodhimin e saj, pa prekur të drejtën morale të autorit.

Midis prodhuesit dhe autorëve të veprave kinematografike ose audiovizuale, ekzistojnë të drejta dhe detyrime të ndërsjella.

Prodhuesi ka të drejtë që në veprën e përdorur në një vepër kinematografike ose audiovizuale të bëjë ndryshime, përshtatje, transformime ose përkthime, të cilat janë të domosdoshme për realizimin kinematografik ose audiovizual të veprës, por gjithmonë me marrëveshje dhe me lejen e autorëve të veprës.

Kur kjo marrëveshje nuk arrihet, atëherë prodhuesi ka të drejtë t'i drejtohet Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, e cila, pasi cakton një grup ekspertësh për të gjykuar në lidhje me kërkesën e prodhuesit, vendos nëse vepra ka nevojë për ndryshime, përshtatje, transformime ose përkthime. Vendimi i saj nuk është i formës së prerë, pasi personi i interesuar në çdo çast mund t'i drejtohet gjykatës, e cila në vendimin e saj vendos pranimin ose rrëzimin e kërkesës.

Ligji sanksionon disa afate kohore të caktuara, të cilat detyrojnë prodhuesin të realizojë ose të shpërndajë veprën brenda tyre. Sanksionimi i këtyre afateve, synon që t'i sigurojë një mbrojtje sa më të frytshme autorëve të veprave kinematografike dhe audiovizuale.

Si rregull, midis prodhuesit dhe autorëve të veprës lidhet një marrëveshje, që vepra të realizohet ose të shpërndahet brenda 3 vjetëve nga dorëzimi i pjesës muzikore ose letrare, ose nga përfundimi i saj. Në rast se ky afat nuk përmbushet nga prodhuesi, atëherë autorëve të veprës u takon e drejta që ta disponojnë vetë veprën, pavarësisht nga marrëveshja që ato kanë pasur me prodhuesin.

Autorët e veprës, me marrëveshje të posaçme, mund ta shtynë këtë afat

edhe 1 vit, sipas klauzolës së parashikuar nga ligji. Në rast se prodhuesi e realizon ose e shpërndan veprën brenda këtij afati, marrëveshja midis tyre është e vlefshme.

Një afat tjetër, që parashikon ligji është edhe ai 5-vjeçar pas përfundimit të kontratës, kur prodhuesi nuk e përfundon veprën ose afatit 1-vjeçar nga koha e përfundimit të saj. Kur prodhuesi nuk realizon shpërndarjen e saj, atëherë autorëve të veprës u lind e drejta që të kërkojnë anulimin e kontratës, si dhe shpërblimin e dëmit.

Anulimi i kontratës detyrimisht i kthen palët (autorë-prodhues) në gjendjen e mëparshme, ku autorët fitojnë të drejtat e pronësisë mbi pjesën e tyre.

Mbrojtja e të drejtave të tjera, lidhur mbi të drejtën e autorit, vepron edhe mbi programet kompjuterike¹³.

Një program kompjuteri mbrohet vetëm kur është origjinal, domethënë ai është rezultat i aftësisë krijuese intelektuale të autorit të tij. Autori i programit kompjuterik mund të jetë një individ ose grup individësh, pavarësisht nga mënyra e tyre e shoqërizimit.

Programi kompjuterik do të gëzojë mbrojtje vetëm kur ai është rezultat i ndihmesës dhe aftësive të një individi ose grup individësh, çka do ta bëjë atë autentik dhe ta pakontestueshëm.

Veprat e arteve të bukura, të arkitekturës dhe fotografisë,¹⁴ janë objekt i veprimit të këtij ligji. Këto të drejta janë të paprekshme, kur ato ekspozohen nga persona fizikë ose juridikë në një ekspozitë.

Në të njëjtën kohë, autori i tyre ka të drejtë që t'ua kalojë të tretëve të drejtën e tij për riprodhim. Këto të drejta mbrohen edhe në planin moral dhe atë ekonomik.

Në ligj përdoret gjerësisht termi “titullar i të drejtave të autorit”.

Në kontekstin që ligji i jep këtij instituti, mund të themi që bëhet fjalë “për

¹³ Po aty, pjesa III, kreu II.

¹⁴ Po aty, pjesa III, kreu III.

titullar të të drejtave të autorit në aspektin pasuror”, pasi e drejta morale është e lidhur ngushtë me vetë autorin e veprës.

Titullari mund të jetë një individ, por ai mund të shfaqet edhe në formën e një personi juridik, të njohur sipas ligjit me emrin agjenci.

Në dallim nga ligji i vitit 1992, ku : Agjencitë e autorëve krijohen sipas degëve të artit, por jo më shumë se një agjenci për çdo degë të artit, ligji i ri nuk e kufizim mbrojtjen e të drejtës së autorit sipas përcaktimit të mësipërm¹⁵, por ai lejon krijim e agjencive, të cilat do të sigurojnë mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të , në varësi të vullnetit lirë të vetë autorit.

Agjencitë, të quajtura sipas këtij ligji “agjenci të administrimit kolektiv”, do të jenë persona juridikë privatë jofitimprurës, ata do të licencohen në veprimtarinë e tyre nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Mbrojtia e së drejtës të autorit dhe e të drejtave të tjera të lidhura me të nënkupton në të njëjtën kohë, që çdo person i cili cenon ose pengon autorin e veprës në ushtrimin e së drejtës së tij, detyrimisht duhet t’i nënshtrohet sanksioneve përkatëse.

Cenimi ose pengimi i të drejtës së autorit nga persona të tretë, pa dyshim do të shkaktojë nga pikëpamja civile edhe një dëm material. Në dispozitat përkatëse të ligjit, dhe pikërisht në kreun III të pjesës IV, rregullohet edhe “shpërblimi i dëmit”.

Shpërblimi i dëmit, do të shtrihet kundrejt këtyre veprimeve:

- Kur autori pengohet në ushtrimin e së drejtës për të shfrytëzuar veprën e tij.
- Kur ndodhemi para një cenimi të ushtrimit të së drejtës për shfaqjen publike të veprës.
- Kur kemi të bëjmë me shkatërim ose asnjësim të specimentit dhe të

¹⁵ Me ligjin nr.8630, datë 3.7.2000 “Për një ndryshim në ligjin 7564, datë 19.5.1992 “ Për të drejtën e autorit, ndryshuar me ligjin nr. 7329, datë 19.4.1995 dhe ligjin nr. 8594, datë 6.4.2000: “Agjencitë e autorëve krijohen sipas degëve të artit, por jo më shumë se një agjenci për çdo degë të artit.”

kopjes së riprodhuar në kundërshtim me ligjin.

Krahas shpërblimit të dëmit ligji parashikon dhe rastet e kundërvajtjeve administrative. Do të jetë Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, që do të zbatojë dënimin me gjobë, kur do të ndodhemi para kundërvajtjeve administrative, të parashikura shprehimisht në seksionin III, kreu III të pjesës së tretë të këtij ligji.

Hapësira që paraqet ligji i ri “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të”, pa dyshim është tepër më e madhe se sa trajtimi në këtë artikull.

Në vija të përgjithshme, mendoj se kam prezantuar një rregullim të atyre institucioneve të së drejtës së autorit, të cilat në ligjin shqiptar të '92, nuk kishin gjetur rregullimin përkatës.

Ligji i ri krijoi një vizion të ri për rregullimin e marrëdhënieve juridikocivile në këtë fushë, duke i ndërprerë rrugën dukurive negative, të cilat kanë cenuar në mënyrë të hapët të drejtat e autorëve.

Duke dëshiruar të zhvillojnë dhe të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të autorëve në punën e tyre në një mënyrë sa më efektive dhe të barabartë që të jetë e mundur, duke njohur nevojën të prezantojnë rregulla të reja ndërkombëtare dhe të qartësojnë interpretimin e rregullave ekzistuese në mënyrë që të mundësojnë zgjidhje të përshtatshme ndaj çështjeve të ngritura nga zhvillimet ekonomike, sociale, kulturore dhe teknologjike, duke njohur përpjekjet e thella të zhvillimit dhe konvergencën e teknikave të informimit dhe të komunikimit mbi prodhimin dhe shfytëzimin e veprave artistike ose letrare etj., ai garanton ruajtjen së të drejtës së autorit si një nxitje për zhvillimin e saj.

Shqipëria dhe kushtëzimi demokratik i Bashkimit European: “Zgjedhja i përket Tiranës”*

Dasara Dizdari

HYRJE

Kur shqiptarët rrëzuan një prej regjimeve më të egra komuniste në Europë në dhjetor të vitit 1990, menduan se kurrë më parë Shqipëria nuk kishte qenë më afër integritimit europian. Edhe pse kjo përshtypje ishte e vërtetë, po të kemi parasysh epokën e izoluar komuniste ose prapambetjen e fillimit të shekullit të njëzetë, sot, 14 dhjetorë më vonë, anëtarësimi në Europë duket ende larg, dhe madje më larg nga ç’ menduan në mënyrë idealiste shqiptarët në fillim të viteve nëntëdhjetë.

Ky shkrim përpiqet të trajtojë modelin e kushtëzimit demokratik të Bashkimit European, konsolidimin e këtij modeli pas luftës së Dytë Botërore dhe veçanërisht pas rënies së komunizmit. Në të njëjtën kohë, rasti i Shqipërisë do të shihet si një vend që nuk pati mundësi ta përjetonte demokracinë moderne perëndimore më parë se dekada e fundit e shekullit të njëzetë, duke pasur një histori të brishtë konstitucionale. Së fundi, vala e demokratizimit të vendit do të trajtohet me një theks të veçantë te roli që BE-ja mund të luajë në konsolidimin e demokracisë shqiptare. Çështja e integritimit, siç do të

* Ky shkrim është pjesë e një studimi më të gjerë me të njëjtin titull, punuar nga autorja në përfundim të studimeve në Kolegjin e Europës për politikën dhe administrimin e Bashkimit European.

dëshmohet në këtë shkrim, është në thelb çështje e aftësisë së këtij vendi për të arritur standardet dhe ritmet e klubit evropian.

“Në rrugën e saj drejt integritimit evropian, Shqipëria ka humbur shumë kohë dhe arsyet për këtë janë të shumta: prapambetja dhe varfëria e trashëguar nga regjimi komunist, si dhe zhvillimet negative rajonale, konfliktet dhe krizat e vazhdueshme. Por faktori më kryesor, për këtë vonesë historike në procesin e integritimit evropian, është klasa politike shqiptare e viteve të fundit, e cila është përfshirë në një “betejë” të madhe për pushtet, pavarësisht nga rregullat dhe standardet demokratike evropiane të qeverisjes dhe sjellja politike që çuan në një mungesë të shpeshtë të stabilitetit politik të vendit.”¹

Ky paragraf përfaqëson thelbin e pse-së së madhe për prapambetjen e Shqipërisë lidhur me procesin e integritimit. Ashtu siç do të dëshmohej më poshtë, paaftësia e klasës politike në vend, për të respektuar rregullat e demokracisë dhe institucioneve demokratike, përbën edhe pengesën kryesore në përparimin e vendit në këtë drejtim.

Po cili është roli i BE-së në Shqipëri? A mos ky rol kufizohet vetëm në përfshirjen mekanike të kushteve të BE-së në planet dhe objektivat qeveritarë, që do të ishte në fakt një manipulim me normat dhe kërkesat e BE-së dhe një standard i dyfishtë lidhur me zbatimin real të reformave? Çfarë mund të bëjë BE-ja në mënyrë që të kontribuojë realisht në vend? Përgjigjja e këtyre pyetjeve shtjellohet në shkrimin e mëposhtëm.

1. AXHENDA E BE-SË LIDHUR ME DEMOKRATIZIMIN

Kërkesat e BE-së që kanë të bëjnë me standardet demokratike që duhet të plotësojnë shtetet e reja anëtare janë zhvilluar kryesisht gjatë viteve nëntëdhjetë si rezultat i rënies së regjimeve komuniste në Europën Juglindore,

¹ Paskal Milo, “Shqipëria në rrugën e saj të gjatë e të vështirë drejt integritimit evropian” te Friedrich-Ebert-Stiftung, zyra e Tiranës, grup autorësh, “Vëzhgim i rrugës së Shqipërisë drejt integritimit evropian”, Tiranë, 2003, fq.8.

si dhe për shkak të dëshirës së qartë të këtyre vendeve për t'u pranuar në BE. Sidoqoftë, këto kriterë, të njohura si kriteret e Kopenhagës², edhe pse mbeten shumë të përgjithshme dhe të vështira për t'u matur, nga një pikëpamje afatshkurtër mund të shërbejnë si një mjet i dobishëm në identifikimin e “rasteve të turbullta ose të komplikuar të demokratizimit”³ siç është rasti i Shqipërisë.

Për këtë shënim do të përdorim përkufizimin e demokratizimit, ashtu siç është formuluar ai prej Pridham-it dhe Vanhanen-it, d.m.th. si një proces i plotë i ndryshimit të regjimit nga fillimi deri në fund, përfshi tranzicionin drejt një demokracie liberale dhe konsolidimin e saj të mëpastajmë⁴. Në këtë kuptim, është e saktë të thuash se ndikimi afatgjatë i integritit evropian në vendet ish-komuniste të Europës Juglindore është demokratizimi i vendit. Nga ana tjetër, në një afat të shkurtër, ndikimi i zbatimit të demokratizimit nuk është domosdoshmërisht pozitiv, pasi ai përfshin jo vetëm vullnetin politik të vendit, për të zbatuar kushtëzimin politik, por edhe aftësinë e tij për t'i zbatuar këto standarde.

Mënyra se si Bashkimi Evropian e ndjek progresin e një vendi drejt përmbushjes së standardeve kryhet nëpërmjet raporteve të rregullta të Komisionit, të cilat që prej vitit 1998 kanë shërbyer edhe si dokumente, ku kriteret shpalosen më gjerësisht. Kështu, mënyra se si Komisioni i përpilon raportet e tij luan një rol të rëndësishëm në procesin e demokratizimit të një vendi kandidat. Raportet shërbejnë si mekanizma matës të progresit të një

² Dalë prej Këshillit Evropian të Kopenhagës të vitit 1993 dhe thonë: “Anëtarësimi e kërkon që vendi kandidat të ketë arritur stabilitet të institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin juridik, të drejtat e njeriut, si dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave.”

³ Geoffrey Pridham, “Uneasy Democratizations

– Pariah Regimes, Political Conditionality and Reborn Transitions in Central and Eastern Europe”, Democratization, Vol8, No.4, Dimër 2001, fq. 66.

⁴ Geoffrey Pridham dhe Vanhanen, Eds, “Democratization in Eastern Europe: Domestic and International Perspectives”, Routledge, 1994, fq.2.

vendi të dhënë, si dhe perceptohen prej tij si “detyra shtëpie” të cilat duhen kryer gjatë vitit në vijim. Nga ana tjetër, raportet tregojnë se Komisioni nuk është i prirur të ndërhyjë, pasi ai nuk rekomandon receta që duhen zbatuar, për të zgjidhur probleme të caktuara, porse mesazhi kryesor mbetet se reformat duhet të kenë vulë kombëtare. Po t’i referohemi njërit prej fjalimeve të Komisionerit të BE-së për Marrëdhëniet e Jashtme, Christopher Patten, ky mesazh mund të lexohet qartë: “...Viti i ardhshëm është vendimtar për Shqipërinë që ajo të na dëshmojë se e ka seriozisht politikën e vet europiane. Zgjedhja i përket Tiranës”⁵. Kjo linjë u kap shpejt nga opozita në vend, si dhe nga media kombëtare, për të nënvizuar rëndësinë e reformave të brendshme.

BE-ja e ushtron ndikimin e saj për demokratizim në tri faza të përgjithshme të procesit të integritit: paranegociatat, negociatat dhe mbikqyrja e pasanëtarësimit. Vendi mbikqyret në mënyrë më të vëmendshme gjatë dy fazave të para dhe Shqipëria është ende në fazën e parë, ku duhet thënë se presioni ka qenë mjaft konstruktiv. I tillë ishte rasti i arritjes së një stabiliteti politik afatshkurtër në vend pas presionit të BE-së, çka mundësoi nënshkrimin e fillimit të negociatave në janar 2003. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se sisteme të ndryshme i përshtasin kërkesat europiane në mënyra të ndryshme, të kushtëzuara nga trashëgimia historike dhe burimet e ndryshme që vendet kanë në dispozicion. Kështu, “sinjalet europiane interpretohen dhe modifikohen nëpërmjet traditave, institucioneve, identiteve dhe burimeve të brendshme, në mënyra të tilla që kufizojnë shkallën e konvergencës dhe homogjenizimit”, thotë studiuesi Olsen në studimin e tij mbi europianizimin⁶.

⁵ Christopher Patten. “Ballkani Perëndimor: Rruga drejt Europës”. Fjalim në Parlamentin gjerman, Komiteti për Çështje Europiane, Berlin, 28 prill 2004 – SPEECH/04/209.

⁶ Johan P.Olsen, “The Many Faces of Europeanization”, JCMS 2002, Vol.40, No.5, fq.936.

Procesi i stabilizim-asociimit nga ana tjetër e pasqyron qartë axhendën e demokratizimit. Qëndrimi i BE-së ndaj stabilizimit të Europës Juglindore nisi gjatë Procesit të Royamont-it, në dhjetor të vitit 1996, nën presidencën franceze të Këshillit European që synonte zbatimin e marrëveshjes së Paqes së Dejtonit pas luftrave në ish-Jugosllavi⁷. Shkaqet që përforcojnë vëmendjen e BE-së ndaj këtij rajoni janë natyrisht historike, politike dhe gjeografike dhe në këtë kuptim politika e BE-së ndaj rajonit mbështetet në vetë procesin e integritit të Europës Perëndimore pas Luftes së Dytë Botërore nga njëra anë dhe integrimin e vendeve ish-komuniste të Europës Qendrore e Lindore nga ana tjetër, të cilat u pranuan në BE në maj 2004. Qasja rajonale që BE-ja po përdor ndaj Ballkanit Perëndimor sigurisht që i ka rrënjët në të kaluarën e dhunshme të rajonit. Këtë “qasje rajonale” Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së e miratoi në prill të vitit 1997, “duke vendosur kushte politike dhe ekonomike për zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe me pesë vendet e rajonit: Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Serbi dhe Mal i Zi dhe Republikën Ish-jugosllave të Maqedonisë”⁸. Të pesë vendet u përfshinë më pas në procesin e stabilizim-asociimit, i krijuar me propozim të Komisionit European në maj të vitit 1999, proces i cili synon të ofrojë një kornizë të re për vendosjen dhe zhvillimin e një marrëdhënieje kontraktuale dhe institucionale mes këtyre vendeve dhe BE-së.

Çështja e demokratizimit përbën një kriter që vëzhgohet me kujdes gjatë gjithë negociatave dhe lidhet jo thjesht me tranzicionin demokratik, por edhe me konsolidimin demokratik. Lidhja më e qartë mes axhendës së BE-së për demokratizim dhe qëndrimin të saj dënues në rast moszbatimi është rasti i ish-Jugosllavisë, fillimisht pas Marrëveshjes së Dejtonit dhe anulimit të zgjedhjeve vendore të vitit 1996 nga Millosheviçi dhe, në mënyrë akoma më

⁷ Bashkimi European dhe Europa Juglindore, http://europa.eu.int/comm/external_relations/see/region/europe_-_integration.pdf

⁸ Po aty.

domethënëse, gjatë krizës së Kosovës më 1999⁹. Duhet thënë se këto masa të BE-së për të sjellë ndryshim demokratik në fakt kanë të bëjnë me raste të zgjidhjes së konflikteve ose situata të skajshme të kërcënimit të demokracisë ose të drejtave të njeriut. Situata bëhet më e mjegullt kur vjen puna për raste më pak dramatike. Këtu vërehet një mungesë e strukturave institucionale që do të trajtonin kushtet demokratike.

Një tjetër mekanizëm për stabilizimin e rajonit është edhe Pakti i Stabilitetit, i miratuar në qershor 1999, i cili funksionon nëpërmjet tryezave tematike rajonale në tri fusha kryesore: demokratizimi dhe të drejtat e njeriut, rindërtimi ekonomik, bashkëpunimi dhe zhvillimi, si dhe çështjet e sigurisë. E reja që solli Pakti ishte se për herë të parë ai bën fjalë për një marrëdhënie të re kontraktuale me vendet e Ballkanit Perëndimor, “me perspektivën e anëtarësimit në BE mbi bazën e Traktatit të Amsterdami, pasi të jenë përmbushur kriteret e Kopenhagës”¹⁰. Ky, sigurisht, përbën një moment ndryshimi politik nga ana e BE-së, e cila kuptoi se pas luftrave në Jugosllavi rajoni kishte nevojë për më shumë shtysa se sa thjesht ndihma ekonomike dhe rindërtimi. Në këtë mënyrë, me procesin e stabilizim-asociimit, BE-ja nisi të përdorë kushtëzimin demokratik në një formë të paprecedentë.

Rasti i Shqipërisë është në shumë kuptime mishërim i procesit të internalizimit të normave ndërkombëtare, me synimin për t’u bërë pjesë e sistemit perëndimor të demokracisë. Kështu, autorë të ndryshëm argumentojnë se efekti normativ i ndikimit ndërkombëtar mund të jetë formal, mund të pasqyrohet në mënyrën e sjelljes së elitës politike ose në diskursin e adoptuar në vend¹¹.

⁹ Richard Youngs, “Democracy Promotion: The Case of European Union Strategy”, CEPS Working Document No.167. October 2001, fq.24.

¹⁰ Faqja e Paktit të Stabilitetit në Internet. Shiko <http://www.stabilitypact.org>

¹¹ Hasenclever, Mayer dhe Rittberger, 1997, tek Arolda Elbasani, “Democratization in Albania: Manipulation or Appropriation of International Norms?”, Department of Social and Political Sciences, European University Institute, Firenze, 2004, fq.5.

Efekti formal shihet te përshtatja e normave ndërkombëtare në legjislacionin vendas. Kështu, mund të thuhet se Kushtetuta Shqiptare e vitit 1998 dhe reforma më e gjerë ligjore e zbatuar në vend kanë qenë hapa të rëndësishëm në transferimin e kritereve perëndimore të demokracisë, shtetit ligjor dhe ekonomisë së tregut në legjislacionin vendas.

“Efekti në mënyrën e sjelljes mbulon shkallën e ndryshimit të sjelljes së aktorëve socialë e politikë për t’i korresponduar asaj të vendosur me normë”¹². Ky është një domen ku, siç do ta themi edhe më poshtë, procesi i demokratizimit nuk ka ecur me shpejtësinë e dëshiruar. Në të vërtetë, elita e re politike e Shqipërisë e pas viteve nëntëdhjetë ishte e edukuar tërësisht në sistemin komunist dhe e brumosur me një kuadër vlerash, që papritur u bë i padobishëm.

Një tjetër element i internalizimit të kritereve të demokratizimit është mekanizmi që siguron zbatimin e kritereve të dhëna në skenën e brendshme. Shpesh për aktorët e brendshëm politikë e socialë nuk ka rrugë tjetër mbijetese politike përveç përmbushjes së këtyre kritereve. Porse të përdorësh fjalorin e duhur është një gjë dhe të zbatosh nga pikëpamja institucionale kriteret është diçka tjetër. Kështu që shumëçka në përmbushjen e kritereve përcaktohet jo thjesht nga e shkuara – në rastin e Shqipërisë, e shkuara komuniste – por edhe nga vullneti politik i aktorëve të brendshëm.

2. TRASHËGIMIA (JO)DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

Proceset e demokratizimit në Shqipëri nuk mund të kuptohen pa një analizë të thellë të së shkuarës së vendit që është mjaft domethënëse në kuptimin e traditës demokratike, ose për të qenë më të saktë, të mungesës së kësaj tradite. Sidoqoftë, “trashëgimia historike e Shqipërisë si një vend në dominim të vazhdueshëm dhe pavarësia e shkurtër janë jashtëzakonisht të rëndësishme

¹² Po aty, fq.6.

për të shpjeguar zhvillimet e mëvonshme të historisë së Shqipërisë”¹³. Kështu, hapat e parë drejt shtetformimit flasin për një instabilitet të qartë institucional.

Traktati i parë kushtetues i historisë moderne të Shqipërisë është “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet”, i filozofit shqiptar Sami Frashëri të shekullit të 19-të, kohë në të cilën Shqipëria ende nuk e kishte fituar pavarësinë nga Perandoria Otomane. Sidoqoftë, dokumenti mbetet një pikë referimi dhe është goditës fakti që Frashëri parashikonte një demokraci parlamentare, diçka të ngjashme me demokracinë perëndimore sot.

Ndërsa dokumenti i parë kushtetues i Shqipërisë si shtet i pavarur është “Statusi Organik i Shqipërisë”, i hartuar nga një Komision Mbikqyrës Ndërkombëtar më 1914, që e shpallte Shqipërinë një principatë sovraane, autonome dhe të trashëgueshme. Studiuesit janë të mendimit se sistemi politik i vendosur nga statuti kishte karakter gjysmëkolonial nën mbikqyrjen e Fuqive të Mëdha dhe se ai nuk përfaqësonte një shkëputje drastike nga stili otoman¹⁴. Momenti tjetër domethënës në historinë kushtetuese të Shqipërisë është miratimi i “Statutit të Kongresit të Lushnjës” më 1920, që në fakt përbën të parën nismë kushtetuese të drejtuar nga vetë shqiptarët. Më 1922 Statuti u zhvillua më tej në “Statuti i Shtetit Shqiptar”, i cili e shpallte Shqipërinë një monarki kushtetuese dhe ku afirmohej parimi i ndarjes së pushteteve¹⁵. 1925-a e gjen Shqipërinë republikë parlamentare – e para herë në histori – ku kreu i shtetit dhe ai i qeverisë ishin një dhe parlamenti ishte dydhomësh. Republika nuk jetoi gjatë dhe shpesh u vunë re shkelje të legjitimitetit të institucioneve prej presidentit dhe ku veprimtaria e partive politike nuk gjeti legjitimim.

¹³ James O’Donnell, “A Coming of Age: Albania under Enver Hoxha”, East European Monographs, Boulder, 1999, fq.13.

¹⁴ Aurela Anastasi, “E drejta kushtetuese”, Pegi, Tiranë 2003, fq.37.

¹⁵ “Statuti i Shtetit Shqiptar”, Tiranë, 1922.

Monarkia shqiptare e vitit 1928 na shfaqet si përpjekja e parë serioze për të ndërtuar një shtet të konsoliduar, edhe pse shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore dhe pushtimi italian e detyruan Mbretin Ahmet Zog të largohej nga vendi më 1939. Në verë të vitit 1928, “Statuti Themeltar i Mbretnis Shqiptare” e shpalli Shqipërinë “një monarki parlamentare demokratike” për të dytën herë në më pak se 20 vjet. Parlamenti përbëhej nga një dhomë dhe pushteti i Mbretit ishte i gjerë. E reja e kësaj kushtetute është se ajo riafirmonte ndarjen e pushteteve, duke pasur edhe predispozita më të plota për gjyqësorin, duke garantuar, të paktën formalisht, pavarësinë e tij.

Si përfundim, mund të thuhet se, pa një traditë të konsoliduar demokratike, një kuadër institucionesh të dobëta dhe në kushtet e mungesës së aftësisë njerëzore, Shqipëria dukej e papërgatitur për demokracinë. E thënë ndryshe, duke qenë një shtet kryesisht agrar i prapambetur, Shqipëria paraqitet si vendi më pak i përshtatshëm për komunizmin¹⁶.

Asambleja Kombëtare, e dalë nga zgjedhjet e dhjetorit 1945, ku komunistët ishin të vetmit kandidatë e rrjedhimisht fituan nëntëdhjetë përqind të votave, e shpalli Shqipërinë në janar të vitit 1946 Republikë Popullore, duke rrëzuar kështu monarkinë dhe duke ia ndaluar ish-mbretit kthimin në atdhe. Në ndryshim nga vende të tjera në rajon, si për shembull Rumania e Bullgaria, Shqipëria nuk zhvilloi ndonjë referendum për të përcaktuar formën e qeverisjes¹⁷. Asambleja e re u përfshi në hartimin e kushtetutës, një detyrë që në fakt u krye nga Qeveria. Kushtetuta, e bazuar në modelin jugosllav hyri në fuqi në mars të vitit 1946 dhe sanksionoi njërin prej parimeve më të rëndësishëm: atë të unitetit të pushtetit që do të thotë se nuk kishte ndarje të pushteteve. Gjyqësori, i cili formalisht shpallej i pavarur, ishte në fakt një

¹⁶ Elez Biberaj, “Albania” tek Zoltan Barany dhe Ivan Volgyes, Eds., “The Legacies of Communism in Eastern Europe”, The Johns Hopkins University Press, 1995.

¹⁷ Referendumi mbi mënyrën e qeverisjes u mbajt vetëm në vitin 1997, ku trashëgimtari Leka u mund. Ai pretendon se votimi ka qenë i manipuluar.

instrument në duart e Partisë Komuniste për të konsoliduar regjimin komunist. Është e rëndësishme të theksohet se Kushtetuta e vitit 1946, të paktën formalisht, i ruajti disa nga të drejtat themelore për qytetarët, të cilat do të zhdukeshin në Kushtetutën e vitit 1976. Ky është dokumenti që në fakt konsolidoi edhe më tej regjimin komunist në Shqipëri, dokument i cili bazohet në parimet e marksizëm-leninizmit dhe ku Partia e Punës së Shqipërisë shpallej e vetmja parti politike në vend¹⁸. Kushtetuta e re sanksiononte një centralizim ekonomik drastik, ndërsa të drejtat e njeriut edhe pse të pranuar formalisht ishin subjekt i kufizimeve absolute brenda të njëjtit dokument. Nga ana tjetër, vendimi i regjimit për të ndaluar fenë në vend në vitin 1967 u riafirmua në Kushtetutën e re, duke e bërë Shqipërinë të vetmin vend ateist në botë.

Për ta përmbledhur, kuadri institucional i ngritur nga komunistët pas Luftës së Dytë Botërore, në mënyrë të qartë, reflekton një sistem vlerash që është në mënyrë thelbësore në kundërshtim me atë të demokracive perëndimore, apo me atë që Shqipëria po përpiqet të ndërtojë e të konsolidojë sot. Siç thotë Biberaj, “ndryshe nga komunizmi në vende të tjera europianolindore, komunizmi në Shqipëri ishte “i rritur në shtëpi” dhe për këtë arsye zhdukja e pasojave të tij do të jetë shumë më e vështirë.”

Nëse ka një ndikim të drejtpërdrejtë dhe të qartë të së kaluarës të Shqipërisë në ritmin e saj të ngadaltë të demokratizimit, kjo mund të shihet më së miri në tranzicionin e saj të zgjatur drejt konsolidimit të demokracisë dhe institucioneve demokratike. Ndërkohë që rëndësia e reformës institucionale sot në vend kuptohet si një mekanizëm jetik, për të kryer procesin e transformimit dhe, është fjala kyç e diskutimit politik, kjo nuk do të thotë se ligjet e miratuara rishtazi zbatohen siç duhet. Një gjë e tillë pasqyrohet në standardet e ndryshme që ka arritur reforma ligjore në krahasim me atë institucionale: e para cilësohet si e suksesshme, ndërsa e dyta nuk i ka

¹⁸ “E Drejta Kushtetuese e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Grup autorësh, Tiranë 1983, cituar tek Aurela Anastasi, op.cit., fq.53.

përmbushur kriteret për një demokraci të qëndrueshme¹⁹. Kulminacioni i këtyre mungesave qenë trazirat e vitit 1997.

Është e natyrshme të shtrohet pyetja: çfarë nuk shkon me institucionet në Shqipëri dhe, më përgjithësisht, me funksionimin e demokracisë, e cila garantohej nga pikëpamja ligjore, por nuk gjen një zbatim të suksesshëm? Arsyet janë të shumta, më themelorja - ajo e mungesës së traditës demokratike që u provua më lart. Një arsye tjetër përcaktuese është stili i përgjithshëm qeverisës dhe fryma që vendosin partitë pas ardhjes në pushtet. Siç e përcakton një studiues shqiptar, “demokracia në Shqipëri kërcënohet seriozisht jo vetëm nga autoritarizmi politik – një dukuri e shfaqur në 1992-1997 – por, gjithashtu, edhe nga liberalizmi politik i shoqëruar me papërgjegjshmëri, abuzim dhe korrupsion – një dukuri e ndeshur nga 1997 e mbrapa”²⁰.

Në thelb, keqfunksionimi i institucioneve demokratike në Shqipëri, është ngushtësisht i lidhur me legjitimitetin e zgjedhjeve, lirinë e shtypit, të drejtat e njeriut dhe ato politike dhe pavarësinë e gjyqësorit.

Ruli na ndihmon të kuptojmë se si është e mundur që kriteret formale nuk janë gjithnjë domethënëse, kur ai shkruan se në Shqipëri kemi:

“Zgjedhje të lira – por jo të *ndershme*, sepse ato nuk krijojnë përfaqësim politik të votuesve;

Media të lira – por jo të *pavarura* dhe në disa raste të përdorura nga pushtete të dyshimta;

Të drejta të njeriut dhe të drejta politike të shpallura – por jo të *mbrojtura* dhe të respektuara;

¹⁸ “E drejta kushtetuese e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Grup autorësh, Tiranë 1983, cituar tek Aurela Anastasi, op.cit., fq.53.

¹⁹ Aleks Luarasi, “Legal and Institutional Reform in Albania after the Democratic Revolution 1991-1997”, University of Tirana, Albania, May 1997, fq.33. Shiko

<http://www.nato.int/acad/fellow/95-97/luarasi.pdf>

²⁰ Genc Ruli, “Albania: The Weakness of the State”, The EU Integration Net, fq.2. Shiko: http://www.euintegration.net/data/doc_publications/260/04_Ruli.pdf

Pavarësi të gjyqësorit – por në fakt liri të pakontrolluar të një organi të korruptuar”²¹.

3. PROCESI I INTEGRIMIT EUROPIAN TË SHQIPËRISË

“Objektivi teorik dhe praktik i politikës së Europës është integrimi gradual i Ballkanit në zonën europiane [...] Parimi udhëheqës është në të njëjtën kohë i thjeshtë dhe i fuqishëm. Integrimi european – me vendet e rajonit të pranuar në Bashkim – është një objektiv i përbashkët politik dhe Bashkimi merr përsipër të nxisë dhe mbështesë këtë proces duke nxitur reformën politike, sociale dhe ekonomike në këto vende.”

“*Fati european i Shqipërisë*”, fjala e Romano Prodit para Parlamentit shqiptar ditën e nënshkrimit zyrtar të fillimit të negociatave për një marrëveshje stabilizim-asociimi me Shqipërinë, Tiranë, 31 janar 2003.

Më në fund, procesi i integrimit european të Shqipërisë ka nisur. Kjo demonstron nga mesazhet e përsëritura të BE-së, ku deklarohet një integrim i ardhshëm i Ballkanit në Europë dhe me fillimin e negociatave për një marrëveshje stabilizim-asociimi për Shqipërinë. Nga ana tjetër, Qeveria Shqiptare e ka shndërruar procesin e integrimit në një element kyç të programit të saj, ka ngritur një ministri të integrimit european, si dhe ka hartuar një strategji e plan veprimi në këtë drejtim. Sidoqoftë, mesazhi i përsëritur i Komisionit në tri Raportet Vjetore të Stabilizim-Asociimit për Shqipërinë është se procesi i reformave është i kufizuar dhe ritmi i ngadaltë e, ç’është

²¹ Po aty.

më e rëndësishmja, progresi nga njëri raport në tjetrin duket se mungon. Këtu duhet theksuar se, ndërsa raportet shërbejnë si mekanizma orientues drejt reformave, ato e lënë në vullnetin e vendit që të marrë masat e nevojshme për të përparuar në drejtimin e duhur. Siç e thamë më lart, kjo mund të ketë pasojë të dyfishtë: më njërën anë i mundëson Qeverisë të punojë brenda një konteksti kombëtar dhe të identifikojë rrugët më të mira, ndërsa, më anë tjetër, mund t'i krijojë mundësi Qeverisë që të bëjë më shumë ndryshime kozmetike se sa reforma thelbësore, të cilat do të kërkonin një angazhim politik serioz dhe që mund të shoqërohen me koston e tyre sociale.

Nëse shqyrtojmë nga afër platformën politike të Qeverisë 2002-2005, vërejmë se objektivi kryesor politik i saj është “arritja e reformave të nisa, për të garantuar respektimin e vullnetit të zgjedhësve nëpërmjet zgjedhjeve të lira”²². Përparësitë e renditura në këtë program përfshijnë integrimin europian, konsolidimin e shtetit ligjor dhe të institucioneve demokratike, përmirësimin e sistemit zgjedhor dhe administrimin e procesit të zgjedhjeve, luftën kundër trafikimit të paligjshëm, krimin të organizuar dhe korrupsionit. Krahas këtyre reformave, konsolidimi i administratës publike dhe institucioneve kryesore shtetërore dhe reforma në gjyqësor mbeten përparësi të Qeverisë, e cila thotë: “[...]Këto] janë sfida që kërkojnë një angazhim progresiv të forcës në pushtet, për të garantuar qëndrueshmërinë e procesit dhe për të kryer transformimin, i cili përmirëson parametrat e zhvillimit dhe na integron me dinjitet në Europë si shtet dhe si komb.”²³

Siç shihet, ngjashmëria mes terminologjisë së dokumentit qeveritar dhe kërkesave ndërkombëtare, të cilave iu referuam më lart, është e qartë. Edhe pse ky është një hap i rëndësishëm, pasi tregon se Qeveria Shqiptare është në të njëjtën gjatësi vale me Brukselin sa i takon të kuptuarit të përgjithshëm

²² Këshilli i Ministrave, “Programi Politik i Qeverisë së Republikës të Shqipërisë 2002-2005”, Tiranë, 2001.

²³ Po aty.

të gjërave, ai nuk mjafton. Përndryshe, do të ishte e vështirë të kuptohej kritikizmi i vazhdueshëm i BE-së, i pasqyruar edhe në raportin vjetor lidhur me mangësitë në reforma, kritikizëm të cilin edhe vetë Qeveria e vlerëson si objektiv.

Sfondi i këtij progresi të ngadaltë drejt integritimit është një opinion i përgjithshëm publik në Shqipëri, thuajse 90 për qind në favor të integritimit në BE, sipas një sondazhi të opinionit publik më 2004²⁴. Por, cili mund të jetë kontributi real i BE-së në rastin e Shqipërisë?

Megjithëse marrëdhënia e parë institucionale e BE-së me Shqipërinë u vendos më 1992 nëpërmjet nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi, që në thelb ishte një marrëveshje tregtare, u desh të kalonin shumë vjet që BE-ja të bëhej një aktor vital në realitetin shqiptar të demokratizimit. Nëse gjatë fazës së parë të demokratizimit të Shqipërisë (1992-1997) roli i BE-së ka qënë më pak i dukshëm, pas 1997 e mbrapa duket se ky rol është bërë më aktiv. Është e qartë se axhenda e demokratizimit e drejtuar nga BE-ja u bë më e pranishme pas krizës së Kosovës. Shpjegimin më të mirë e jep Jacques Attali, i cili shkruan se “vendet e vogla duhet të bashkohen me fqinjët e tyre për të arritur masën kritike përballë një globalizimi që udhëhiqet nga kërkesat e tregut”²⁵. Me fjalë të tjera, ky është momenti kur axhenda e BE-së për demokratizimin në kuadër të marrëdhënieve të saj të jashtme bëhet një mekanizëm konstant presioni ndaj vendeve të rajonit në përgjithësi dhe Shqipërisë në veçanti.

Sigurisht, është e rëndësishme të theksojmë se programi CARDS i BE-së për Shqipërinë përfaqëson një mundësi të mirë financiare, për të trajtuar

²⁴ Albanian Institute of International Studies, “Rethinking EU Integration: Albanian Perceptions and Realities”, Tiranë 2004.

²⁵ Jacques Attali, “The Crash of Western Civilization: The Limits of the Market Democracy” tek Ailish M. Johnson, “Albania’s Relations with the EU: On the Way to Europe?”, Journal of Southern Europe and the Balkans, Vol3, No.2, 2001, fq.171-192.

ata sektorë që vendi po përpiqet të reformojë në përpjekjet e tij për integrim. Kështu që mund të thuhet se me ndihmën financiare nga një anë dhe nga ana tjetër me ndërmjetësimin e BE-së (i cili në shumë raste ka pasur një efekt pozitiv), në mënyrë që Shqipëria të intensivikojë reformat, një presion edhe më i madh është i nevojshëm të ushtrohet nga BE-ja. Për më tepër, siç vë në dukje Elbasani, “në politikën e polarizuar shqiptare, verdikti i komunitetit ndërkombëtar ka prirjen të konsiderohet si përfundimtar”²⁶. Në këtë logjikë, në gjendjen aktuale të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe BE-së, presioni i BE-së nëpërmjet politikës së saj të jashtme është vendimtar në rrënjosjen e një kulture demokratike që do të mundësonte funksionimin e institucioneve në vazhdimësi.

Si përfundim, mund të thuhet se BE-ja ka një rol vital për të luajtur në Shqipëri, ndërsa vendi përgjithësisht u bindet teorive konvencionale të demokratizimit. Fakti që BE-ja nuk kishte përgatitur një axhendë demokratizimi për vendet e Ballkanit Perëndimor në të njëjtën kohë me vendet e Europës Qendrore dhe Lindore e pengoi këtë rol. Kështu, për këto vende, rënia e komunizmit nuk përkoi me një strategji të përshtatshme integrimi të BE-së dhe, për pasojë, një rol më aktiv për të. Kjo mund të shpjegohet me faktin se këto vende, përfshi Shqipërinë, ishin në një fazë tjetër zhvillimi krahasur me vendet e tjera komuniste, por në të njëjtën kohë pasqyron paqartësinë e kushtëzimit demokratik të BE-së në fillim të viteve 90-të.

PËRFUNDIM

Përmushja e kushteve demokratike të BE-së duket se është e vetmja rrugë për një vend që të bëhet anëtar i BE-së. Numri në rritje i vendeve të tilla pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe shpërbërjes së bllokut komunist në përgjithësi, pati ndikimin e vet edhe në sistemin e kriterëve demokratike të BE-së për anëtarët e ardhshëm. Ndërkohë që

²⁶ Arolda Elbasani, op.cit., fq. 18

Komisioni e ka bërë të qartë se procesi i stabilizim-asociimit nuk mund të jetë një proces i zgjidhjeve të shpejta politike dhe se “nuk shtrohet çështja që këto vende të bëjnë sikur janë reformuar dhe ne të bëjmë sikur i besojmë”²⁷, vazhdon të mbetet e paqartë se si Komisioni në fakt e mat një gjë të tillë.

Sidoqoftë, si një vend në tranzicion, me strukturat qeveritare ende në kërkim të një forme stabël, është ende shpejt për të arritur në përfundime lidhur me procesin e europianizimit në Shqipëri. Por kjo nuk na pengon të arrijmë në përfundime për mënyrën se si axhenda e demokratizimit e BE-së ka ndikuar në axhendën kombëtare të demokratizimit. Një gjë është e dukshme: BE-ja e ka zëvendësuar politikën e saj reaktive ndaj Ballkanit me një strategji më proaktive. Kështu, BE-ja është shndërruar në një motor për ndryshime demokratike në këto vende anëtare të ardhshme, një model demokratik që duhet internalizuar, duke shërbyer në të njëjtën kohë si frymëzim për reforma dhe debat publik rreth çështjeve më të rëndësishme.

Ajo që është më e rëndësishmja të kuptohet tashmë është se shpejtësia e procesit të integritimit varet nga Shqipëria dhe jo nga BE-ja. Dhe, siç e tregon edhe raporti i stabilizim-asociimit, reformat e vendit kanë qenë të kufizuara. Që ritmet e procesit të intensifikohen, presioni i jashtëm duhet të intensifikohet. Do të ishte e rrezikshme për Shqipërinë që të përjetonte një vendnumëro të reformave ekonomike, politike e juridike, në një kohë kur qëndrimi proeuropian që Qeveria artikulon nuk mjafton që integritimi të ndodhë. Në këtë kuptim, zgjedhjet e vitit 2005 mbeten vendimtare për ecurinë e integritimit. Siç është shprehur edhe Komisioneri Patten, mëse një vit më parë, në procesin e integritimit europian të Shqipërisë zgjedhja i përket Tiranës. “Ajo mund të punojë me ne dhe të ecë përpara, ose mund t’i injorojë mesazhet tona të qarta, një gjasë kjo që nëse materializohet më bën të parashikoj vetëm stanjacion në procesin e integritimit europian.”²⁸

²⁷ Christophet Patten, op.cit.

²⁸ Po aty.

Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese

Sokol Sadushi
Anëtar i Gjykatës Kushtetuese

Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Ky është një parim thelbësor që është sanksionuar në nenin 4/3 të Kushtetutës së RSH-së. Interpretimi i dispozitave të Kushtetutës kryhet nga çdo organ që ka detyrimin të përmbush funksionet e tij kushtetuese. Ajo që Kushtetuta parashikon ndryshe, lidhet edhe me interpretimin përfundimtar të saj, që sipas nenit 124 kryhet nga Gjykata Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, duke vepruar si një trupë gjyqësore e ndarë dhe e pavarur nga autoritetet legjislativë. Në këndvështrimin e ndarjes së pushteteve, interpretimi nuk është dhe nuk mund të jetë krijim i normave ligjore ose kushtetuese. Gjykata Kushtetuese jep kuptimin e saktë e të rregullt të normave ligjore të shprehura në dispozitat përkatëse në pajtim me parimet kushtetuese. Ajo nuk shkon më tutje dhe nuk shton asgjë në sistemin e normave detyruese ligjore, por vetëm shpall dhe pohon përmbajtjen e këtyre normave. Interpretimi kushtetues ka karakter deklarativ dhe jo natyrë ligjvënëse. Pushtetet e ndara kushtetuese e përjashtojnë Gjykatën Kushtetuese nga roli i ligjvënësit.

Interpretimi i ndryshëm i dispozitave kushtetuese, që në ndonjë rast ka krijuar konfuzion dhe bllokim të procedurave parlamentare është bërë objekt i gjykimit kushtetues. Zgjidhja e situatave të tilla ka lindur nevojën e nxjerrjes

së vendimeve interpretuese përfundimtare. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese me vendimet e saj interpretuese, nuk mund të jetë në çdo kohë dhe për çdo rast, si zgjidhja më e favorshme e konflikteve të natyrës parlamentare. Gjithsecili organ, aq më tepër organet e larta të shtetit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, kanë të drejtë të interpretojnë ligjin dhe Kushtetutën.

Vendimet përfundimtare për interpretimin e Kushtetutës ndihmojnë organet shtetërore në kuptimin e saktë dhe në zgjidhjen sa më të drejtë të rasteve kushtetuese, si dhe në nxitjen e iniciativave për plotësimin e legjisllacionit. Kjo veçori e vendimeve kushtetuese e ka dhënë ndikimin e vet pozitiv në këtë drejtim. Kështu, p.sh, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 75 datë 19.4.2002 dhe nr. 76 datë 25.4.2002, në të cilat nxirren disa konkluzione përfundimtare të karakterit interpretativ të dispozitave kushtetuese që parashikojnë rastet e shkarkimit të Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, krahas problemeve dhe debateve të nxehta që shkaktuan në terrenin politik shqiptar, evidentuan njëkohësisht edhe zbrazëtitë ligjore në aktet bazë, mbi të cilat kryheshin procedurat parlamentare.

Këto vendime ndikuan, dy muaj më pas në ndërmarrjen e nismës legjislativë për ndryshime dhe përmirësime në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë. Me një vendim të veçantë, Kuvendi ngarkoi Komisionin e Përhershëm të Imunitetit, Mandateve dhe Rregullores si dhe Komisionin e Përhershëm të Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore për të përgatitur ndryshimet përkatëse në Rregulloren e tij në lidhje me përmirësimet e procedurave të emërimit dhe të shkarkimit të funksionarëve të lartë. Pikërisht, qëndrimet e mbajtura nga jurisprudenca kushtetuese për rastet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me procedurat parlamentare, duket se ka orientuar hartuesit e Rregullores së Kuvendit për t'i dhënë asaj një formë sa më të plotë.

Rregullorja e miratuar në muajin dhjetor të vitit të kaluar është një akt i rëndësishëm, por edhe shumë përcaktues për disiplinimin dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së organit ligjvënës. Roli i rëndësishëm që ka Kuvendi në

jetën politike të vendit dhe problematika e shumtë në të cilën ai përfshihet, nuk mund të realizohen pa ekzistencën e një rregulloreje që të parashikojë hollësisht shumë nga aspektet që koha dhe praktika parlamentare ka shtruar për zgjidhje gjatë këtyre viteve.

Qëllimi i këtij shkrimi nuk lidhet me ndonjë vështrim kritik mbi përmbajtjen dhe mbi teknikën legjislativë të përdorur gjatë hartimit të Rregullores, se sa mbi dimensionin që ajo duhet të shfaq dhe rrugëzgjdhjen që duhet të bëjë për ç'bllokimin e situatave në procedurat parlamentare, të cilat jo rrallë kanë sjellë ngërç politik dhe juridik.

Nga ky këndvështrim i problemit, pasqyrimi në Rregulloren e Kuvendit i të gjitha momenteve të aspektit material dhe procedural që lidhen me natyrën, rolin dhe funksionin e organit ligjvënës, shmang njëkohësisht edhe zbrazëtitë ligjore që janë vërejtur në procedurat parlamentare.

-Në këtë Rregullore trajtohen për herë të parë disa çështje, të cilat duhen analizuar dhe vlerësuar si në aspektin e rëndësisë që paraqesin, ashtu edhe të problematikës që ato mbartin.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese që kanë interpretuar dispozitat kushtetuese për procedurat e shkarkimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarëve të Gjykatës së lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm kanë dhënë ndikimin e tyre pozitiv në dispozitat e Rregullores. Shumë e detajuar është paraqitur në nenet e Rregullores procedura që duhet të ndiqet në rastet e shkarkimit të Presidentit të Republikës dhe të anëtarëve të organeve kushtetuese. Rregullat procedurale që janë parashikuar në nenet 112 dhe 114 të saj trajtohen për herë të parë me aq hollësi.

Vendimet e tjera interpretuese që ka dhënë kjo gjykatë dhe që lidhen me ngritjen e komisioneve hetimore, me miratimin e programit politik dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave, me procedurat për heqjen e imunitetit të deputetit dhe të anëtarëve të Këshillit të Ministrave etj, kanë gjetur reflektimin e tyre në disa dispozita të Rregullores.

Janë krijuar disa struktura të përhershme parlamentare, të cilat kryejnë funksione të vlerësimit dhe të dhënies së mendimit për çështje legislative a të procedurave dhe që lidhen me funksionin vendimmarrës të parlamentit. Këshilli Legjislativ është një nga këto struktura të reja, i cili ndërmjet shumë detyrave të tjera është ngarkuar dhe me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Ngritja e një hallke të tillë që të merret me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është e rëndësishme, sepse shërben si një strukturë efikase dhe operative për të qenë e orientuar në vazhdimësi mbi qëndrimet që mbahen në jurisprudencën kushtetuese në drejtim të përmirësimit legjislativ.

Sidoqoftë, është e rëndësishme të fokusohet vemendja edhe në disa çështje të tjera të Rregullores, për të cilat mendoj të shfaq disa objeksione që do t'i shërbejnë më shumë përsosjes së saj në të ardhmen.

-Ndërmjet titullit dhe përmbajtjes së nenit 87 të Rregullores vërehen mospërputhje konceptuale. Në përmbajtjen e dispozitës gjenden fraza ose terma, të cilat krijojnë keqkuptime dhe keqinterpretime për zbatuesit e saj. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, është titulli i dispozitës, që përbën dhe pjesën e vlefshme dhe të domosdoshme për t'u parashikuar në këtë Rregullore. “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren në shqyrtim nga Këshilli për Legjislacionin menjëherë pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare”,- thuhet në përmbajtjen e dispozitës konkrete. Terminologjia e përdorur në këtë dispozitë nuk i përshtatet kuptimit që paraqet në të vërtetë titulli i saj.

Marrja në shqyrtim e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është një formulim i padrejtë dhe i gabuar. Kjo frazë e përdorur në këtë dispozitë është e pavend dhe ndoshta e rrezikshme. Edhe në kuptimin gjuhësor, marrja në shqyrtim nënkupton kqyrjen e diçkaje me shumë kujdes dhe me hollësi nga të gjitha aspektet, me qëllim nxjerrjen e një përfundimi të caktuar dhe marrjen e një vendimi konkret.

Asnjë organ nuk ka të drejtë të vlerësojë dhe aq më tepër të marrë në shqyrtim vendimmarrjen kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ky është koncepti kushtetues mbi forcën detyruese dhe efektet e vendimeve të kësaj gjykate.

Në vazhdim të pikës 2 të nenit 87 të Rregullores së Kuvendit thuhet: “Këshilli *analizon dhe diskuton* sipas përcaktimeve të bëra në këtë Rregullore, *efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për legjislacionin*.” Të analizosh efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ndërkohë që dihet fuqia e tyre detyruese, do të thotë të shqyrtosh dhe të zbrërthesh atë në thellësi dhe në të gjithë elementet përbërës. Gjithashtu, diskutimi i diçkaje edhe në kuptimin gjuhësor, është të quash të diskutueshme atë që nuk është plotësisht e vërtetë, e sigurtë, e drejtë ose ta vësh atë në dyshim për vërtetësinë që mund të ketë.¹

Nga ky këndvështrim *marrja në shqyrtim, analiza* si dhe *diskutimi* që duhet t’i bëhet vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga Këshilli për Legjislacionin, krijon një situatë të ndërlikuar, në mënyrë të veçantë, për ata që nuk kanë vizionin e qartë për fuqinë detyruese, përfundimtare dhe të padiskutueshme të vendimmarrjes kushtetuese. Ky opinion i hedhur në këto rrjeshta, sigurisht që është rrjedhojë edhe e ndonjë qëndrimi të mëparshëm të mbajtur nga ana e Kuvendit mbi vënien në diskutim të fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

-Në nenin 25 të Rregullores së Kuvendit lidhur me komisionet hetimore, hartuesit e saj nuk kanë shkuar më tej se citimi korrekt i dispozitës kushtetuese.

Kjo është një mangësi e Rregullores. Mënyra e krijimit të komisioneve hetimore është një ndër çështjet problematike dhe më të debatueshme në

¹ Shih më gjerë Fjalorin e shqipes së sotme, shpjegimin e fjalëve analizë, diskutoj, diskutueshëm (i), shqyrtoj etj., faqe 40, 243, 1290, Botimet Toena, Tiranë 2002.

procedurat parlamentare, e cila është bërë disa herë shkak për keqkuptime dhe keqinterpretime të rolit dhe të funksionit të tyre. Pavarësisht se ka një ligj që rregullon organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore, mendimet e ndryshme, por edhe kontradiktore, që forcat politike shfaqën në parlament për dispozitën konkrete të Kushtetutës, bën të mundur fillimin e një gjykimi kushtetues mbi interpretimin përfundimtar të saj. Kështu në vendimin nr. 18, datë 14.5.2003, Gjykata Kushtetuese ka interpretuar nenin 77, pika 2 të Kushtetutës në shumë aspekte të tij. Sipas Gjykatës “neni 77, pika 2, parashikon ngritjen e komisioneve hetimore parlamentare me dy mënyra të ndryshme, në vartësi të subjekteve që ushtrojnë këtë të drejtë. Këto dy mënyra krijimi rezultojnë nga përdorimi në këtë dispozitë i shprehjeve “ka të drejtë” dhe “është i detyruar”.²

Sipas Kushtetutës, procedurat për ngritjen e komisioneve hetimore ndryshojnë në varësi të inicuesve të tyre dhe të vendimmarrjes. Pikërisht, ky interpretim i bërë nga Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur një zbërthim dhe një analizë të mëtëjshme në nenet e Rregullores së Kuvendit. Qoftë për rastin e ngritjes detyrimisht të komisionit hetimor, kur kërkohet nga një e katërta e deputetëve, ashtu edhe për rastin e të drejtës që ka vetë Kuvendi, ishte e nevojshme që në këtë Rregullore të parashikoheshin disa rregulla të hollësishme procedurale.

-Në nenin 112 të Rregullores është parashikuar shkarkimi dhe pamundësia në ushtrimin e detyrës të Presidentit të Republikës.

Nisur nga nenet 90 dhe 91 të Kushtetutës, që parashikojnë rastet e shkarkimit dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të detyrës të Presidentit të Republikës, dispozita konkrete e Rregullores jep në një mënyrë tepër të hollësishme procedurën që ndiqet nga Kuvendi.

Kushtetuta nuk parashikon për Presidentin e Republikës vetëm dy rastet

² Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, viti 2003, faqe 89.

e mësipërme kur ai mund të largohet nga ushtrimi i funksionit të tij. Në nenin 131, shkronja “e”, i është dhënë e drejta Gjykatës Kushtetuese të vendos edhe *për çështjen e papajtueshmërisë* në ushtrimin e funksionit të Presidentit të Republikës.

Për rastet e papajtueshmërisë, Kushtetuta shprehet në nenin 70, pika 2 vetëm për deputetët, duke ia lënë ligjit parashikimin e rasteve të tjera të papajtueshmërisë. Për sa i përket rasteve të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të Presidentit të Republikës, ajo nuk shprehet, por i njeh Gjykatës Kushtetuese të drejtën të vendos për të.

Kjo kompetencë e Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të realizohet e shkëputur nga trajtimi i kësaj çështjeje jashtë procedurave parlamentare. Përderisa Kuvendi është organi që zgjedh Presidentin, i cili ka të drejtë të vendos për shkarkimin dhe për vërtetimin e pamundësinë së tij për ushtrimin e detyrës, atëhere edhe për rastet e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit, mendoj se duhet të ekzistojë një procedurë konkrete parlamentare.

Sipas nenit 64 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, çështja e papajtueshmërisë së funksionit të Presidentit të Republikës inicohet me kërkesë të jo më pak se një të pestës së deputetëve, ose të partive politike. Në rastin e pranimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese vendos deklarimin e pajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës. Ky ligj nuk zgjidh se çfarë bëhet me vendimin e Gjykatës Kushtetuese që ka deklaruar papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës.

Parë nga ky këndvështrim, në Rregulloren e porsamiruar nuk gjendet asnjë dispozitë procedurale që të parashikojë mënyrën se si duhet të veprojë Kuvendi në raste të kësaj natyre. Sidoqoftë, kjo mbetet një çështje e hapur për diskutim, për të cilën është e nevojshme në të ardhmen dhënia e një zgjidhjeje ligjore.

-Çështja e respektimit të standarteve kushtetuese që lidhet kryesisht

me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, ka gjetur trajtim të gjerë në Rregullore.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka mbajtur një qëndrim konseguent për respektimin e kësaj të drejte edhe në procedurat parlamentare, duke konkluduar se “çdo organ i pushtetit publik gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor është i detyruar të respektojë standartet e gjithëpranuara demokratike...” Në vendimin interpretues nr.75, datë 19.04.2002, Gjykata Kushtetuese e ka konsoliduar qëndrimin e saj lidhur me kuptimin që duhet të ketë e drejta për një proces të rregullt ligjor edhe në procedurat parlamentare. Në këtë vendim theksohet se “*njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur, si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore, cënimin e së cilës, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e ka identifikuar në çdo rast, si shkelje të Kushtetutës.*”³

Këto standarte të pranuar nga jurisprudenca kushtetuese kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Rregulloren e Kuvendit. Kjo është e evidente në nenet që trajtojnë rastet e shkarkimit të funksionarëve të lartë të shtetit. Megjithatë, në këto dispozita vihet re edhe ndonjë pasaktësi në formulim.

Rregullorja e ka lënë në vlerësimin e personit konkret pjesmarrjen në procedurën përkatëse. Në nenin 112, pika 4 dhe 114, pika 3 të saj është përdorur shprehja “*në rast se kërkohet*” nga personi konkret për t’u dëgjuar në seancë plenare, Kuvendi është i detyruar ta dëgojë.

Standarti kushtetues nuk e le në vlerësimin e personave që kërkohet të shkarkohen pjesmarrjen në seancën dëgjimore. Kuvendi ka detyrimin kushtetues të thërras personin kur fillojnë procedurat e natyrës *impeach-*

³ Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, viti 2002, faqe 106.

ment me qëllim që të dëgjohet dhe të realizojë mbrojtjen mbi akuzat e ngritura. Kuptimi që paraqet standarti kushtetues nuk lidhet me kërkesën e personit për t'u dëgjuar, por me detyrimin e organit procedues për ta thirrur atë, qoftë edhe pa kërkesë. Midis kërkesës së personit për t'u dëgjuar dhe detyrimit të organit për ta thirrur ka dallim. Mospërmbushja e detyrimit kushtetues të Kuvendit për të thirrur në seancë dëgjimore ish-Prokurorin e Përgjithshëm ishte një shkak përcaktues për ta konsideruar procedurën për shkarkimin e tij si antikushtetuese. Prandaj, mbrojtja juridike kushtetuese e funksionarëve të lartë të shtetit, duhet garantuar detyrimisht, pavarësisht nga qëndrimi që ata dëshirojnë të mbajnë për mënyrën e realizimit të kësaj të drejte.

-Lidhur me zgjedhjen në organet kushtetuese, për të cilët mund të kërkohet dhënia e pëlqimit nga Kuvendi, Rregullorja, në nenin 111 ka parashikuar hollësisht rregulla procedurale që lidhen me afatet e paraqitjes së kërkesës, përzgjedhjen e kandidaturave dhe mënyrën e votimit të tyre. Sipas formulimit të pikës 6 të këtij neni procedura për zgjedhjen e një kandidature në organin kushtetues bazohet në një kërkesë të Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Përsa i përket procedurës që ndiqet për zgjedhjen e kandidaturave për në organet kushtetuese, për të cilat Kushtetuta përdor termin “*zgjidhen nga Kuvendi*”, formulimi në tërësi i nenit 111 është i saktë. Pasaktësia në këtë dispozitë qëndron në përdorimin e terminologjisë “*dhënia e pëlqimit*” nga Kuvendi.

Procedura që ndiqet nga Kuvendi për zgjedhjen në organet kushtetuese nuk është e njëjtë me dhënien e pëlqimit. Sipas Kushtetutës, konkretisht neneve 61, 154, 161, 162 etj, janë disa funksionarë të lartë të shtetit, si Avokati i Popullit, dy anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilët zgjidhen nga Kuvendi. Procedura që parashikohet në nenin 111 të Rregullores është e zbatueshme për ta.

Përsa i përket gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, Kushtetuta në nenet 125/1,4; 136/1,3 dhe 149/1, njeh procedurën e dhënies së pëlqimit për emërimin e tyre nga Presidenti i Republikës. Prandaj, dhënia e pëlqimit nga Kuvendi, sipas Kushtetutës, është parashikuar vetëm për këto funksionarë të lartë të shtetit. Si e tillë, procedura parlamentare që ndiqet për dhënien e pëlqimit është e ndryshme nga procedura që ndiqet për zgjedhjen në organet kushtetuese.

Dhënia e pëlqimit, në kuptim dhe të vendimit nr. 2, datë 18.1.2005 të Gjykatës Kushtetuese, inicohet nëpërmjet dekretit që nxjerr Presidenti i Republikës. Dekreti i tij nuk mund të ndjek fazat që kërkon pika 6 e nenit 111 të Rregullores së Kuvendit. Në këtë dispozitë thuhet: *“Në rastet kur në Kushtetutë parashikohet dhënia e pëlqimit nga Kuvendi, Kryetari i Kuvendit ia kalon kërkesën Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut, i cili brenda 7 ditësh shqyrton nëse kandidaturat i plotësojnë kriteret ligjore. Kuvendi shqyrton kërkesën për dhënien e pëlqimit në seancë plenare brenda dy javëve nga data e paraqitjes së raportit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe, nëse kërkohet nga të paktën një kryetar grupi parlamentar, zhvillohet debat për të.”*

Ky formulim nuk i përgjigjet procedurës që duhet të ndjek Kuvendi në rastet e dhënies ose jo të pëlqimit për dekretet e Presidentit të Republikës. Prandaj, Rregullorja e Kuvendit në çështjen e dhënies së pëlqimit për dekretet e Presidentit të Republikës ometon. Sidoqoftë, vendimi i Gjykatës Kushtetuese, nr. 2, datë 18.1.2005 me objekti interpretimin e neneve 125 dhe 136 të Kushtetutës mund të shërbejë që kjo çështje të mund të gjejë një zgjidhje të plotë në të ardhmen.

-Procedura që ndiqet nga Kuvendi në rastet e heqjes së imunitetit të deputetit dhe të anëtarit të këshillit të Ministrave (që nuk është deputet)

është një tjetër aspekt i reflektimit të jurisprudencës kushtetuese në dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 118 i Rregullores ka trajtuar fazat procedurale në të cilët kalon kërkesa dhe dokumentet shoqëruese për dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ose arrestimin e një deputeti. Pika 7 e këtij neni është formuluar sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 38, datë 23.6.2000 në të cilin konkludohet se *“në dhënia e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj anëtarit të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është zgjedhur deputet do të zbatohet e njëjta procedurë që parashikohet edhe për deputetin.”*⁴

Megjithatë vihet re një mangësi në hartimin e Rregullores për të parashikuar në dispozita të veçanta interpretimin që Gjykata Kushtetuese i ka bërë nenit 73 të Kushtetutës. Në vendimin nr.39, datë 23.6.2000 është konkluduar nga kjo gjykatë se *“për çështjet e parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, kërkesa për marrjen e autorizimit për ndjekjen penale të personave që gëzojnë imunitet, i drejtohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nga vetë gjykata, pranë së cilës është depozituar kërkesa e të dëmtuarit akuzues.”*⁵

Ky interpretim kushtetues ndryshon nga rasti kur kërkesa për dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit bëhet nga Prokurori i Përgjithshëm. Dallimi ndërmjet tyre lidhet me natyrën e veprave penale për të cilat mund të akuzohet deputeti. Për rrjedhojë, procedura që duhet zbatuar për heqjen e imunitetit të deputetit për veprat penale të cilat ndiqen me ankim është e domosdoshme të pasqyrohet në dispozitat e Rregullores së Kuvendit.⁶

⁴ Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, viti 2000-2001, faqe 93.

⁵ Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, viti 2000-2001, faqe 96.

⁶ Sqaroj se në këtë vendim interpretues, unë kam mbajtur një qëndrim të kundërt nga qëndrimi i shumicës, në të cilin kam arsyetuar, se një e drejtë e tillë nuk mund t'i përkas gjykatës, por vetëm prokurorit. Sidoqoftë, mendimi im është një qëndrim pakice dhe nuk është i detyrueshëm. Në këto kushte, qëndrimi që ka mbajtur shumica në këtë çështje është i detyrueshëm. Nga kjo pikëpamje, vlen të trajtohet idea që kam hedhur më lartë mbi mangësinë ligjore që vihet re në Rregulloren e Kuvendit

Një analizë e tillë e Rregullores së Kuvendit nuk mund të pasqyrojë në të gjitha aspektet problematikën që mund të nxjerrë në të ardhmen praktika parlamentare si dhe jurisprudenca kushtetuese. Mendimet e hedhura në këtë shkrim, pavarësisht se nuk mund të shmangin subjektivizmin e autorit të këtyre radhëve, sidoqoftë do t'i shërbejnë hapjes dhe vazhdimit të mëtejshëm të debatit mbi këtë çështje.

Raport nga monitorimi i veprimtarive së Komisioneve Parlamentare për muajin shkurt 2005

Qendra e Studimeve Parlamentare, në kuadrin e projektit “Rritja e Pjesëmarrjes së Publikut në Procesin Legjislativ” iniciuar nga Qendra e Studimeve Parlamentare dhe programi i Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (Soros) dhe me mbështetjen financiare të këtij të fundit, gjatë muajit shkurt, 2005, ka monitoruar veprimtarinë e dy komisioneve të përhershme parlamentare, lidhur me performancën legjislative dhe nivelin e konsultimit dhe pjesëmarrjes së grupeve të interesit dhe publikut në përgjithësi gjatë procesit legjislativ në Kuvend.

I. MONITORIMI I KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Seancat e zhvilluara / Kohëzgjatja e mbledhjeve

Gjatë muajit shkurt KÇLAPDNJ ka zhvilluar 12 mbledhje, të cilat kanë qenë të parashikuara në kalendarin e punimeve të Kuvendit. Mbledhjet kanë qenë të hapura dhe në të shumtën e rasteve ka qenë e pranishme dhe media. Kohëzgjatja mesatare për një mbledhje ka qenë rreth 50 minuta dhe me një kohëzgjatje totale mujore të veprimtarisë legjislative të Komisionit prej 9 orësh. Mesatarisht mbledhjet fillojnë me 10 minuta vonesë nga orari i parashikuar.

Çështjet e trajtuara në mbledhjet e komisionit

Në 12 mbledhjet e zhvilluara gjatë muajit shkurt janë shqyrtuar 15 projektligje: Nga këto:

- 8 janë ratifikime marrëveshjesh;
- 3 janë projektligje që bëjnë rregullime tërësore;
- dhe 4 janë projektligje që propozojnë ndryshime në ligjet ekzistuese.

Nga 15 projektligjet e shqyrtuara 4 janë me iniciativë të deputeteve të veçantë ose grup deputetësh: "Per një ndryshim në ligjin nr.9062 datë.08.05.2003 "Kodi i Familjes; "Për një ndryshim në ligjin nr.9049, datë 1.4.2003 "Për deklarin dhe kontrollin e pasurive dhe të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë"; "Për konfliktin e interesave" (nismë e nje grupi deputetesh); "Për kontrollin e figures së personit zyrtar të zgjedhur apo të emëruar në organe të rëndësishme të shtetit".

Në përgjithësi, një projektligj është trajtuar dhe përfunduar brenda një mbledhjeje komisioni.

Konsultimi, ekspertiza dhe burimet e informacionit

Në 12 mbledhjet e zhvilluara, për të mbrojtur propozimet ligjore dhe për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të deputetëve, kanë qënë të pranishëm përfaqësues të qeverisë. Në përgjithësi, qeveria është përfaqësuar me drejtuesit dhe specialistët e sektorëve përkatës të ministrisë që është marrë kryesisht me përgatitjen e projektligjit. Në mbledhje kanë qënë të pranishëm dhe këshilltarë të Kuvendit, që mbulojnë këtë Komision. Në shqyrtimin e projektligjeve në këto mbledhje nuk rezultojnë të jenë zhvilluar seanca dëgjimi me grupe interesi ose me përfaqësues të komunitetit akademik. Pra, burimi i informacionit dhe konsultimit, gjatë shqyrtimit të projektligjeve në Komision ka qënë ai i Qeverisë dhe i Kuvendit.

Diskutime/Amendamente të bëra nga deputetët

Nga 19 deputetë të Komisionit, vetem 11 anëtarë kanë propozuar

amendamente në projektligjet që kanë qenë në shqyrtim. Nga këta, 5 deputetë kanë propozuar më shumë se një amendament. Mbi 50 % e anëtarëve të Komisionit kanë marrë pjesë aktive gjatë shqyrtimit të projektligjeve. Duke vlerësuar pjesëmarrjen në diskutim dhe amendamentet e propozuar të krijohet perceptimi që më pak se 30 % e anëtarëve të Komisionit kanë një njohje paraprake të projektligjeve nëpërmjet konsultimeve që mund të kenë zhvilluar jashtë mbledhjes së komisionit.

Kontrolli parlamentar/ Çështje të tjera

Përsa i përket kontrollit parlamentar, një tjetër funksion thelbësor ky i një Komisioni në Kuvend, KÇLAPDNJ ka zhvilluar një seancë dëgjimore me Komisionin e Shërbimit Civil si dhe një seancë tjetër dëgjimore publike për informim nga Prokurori i Përgjithshëm.

KÇLAPDNJ, në mbledhjen e datës 3.02.2005, zhvilloi seancën dëgjimore publike "Për Veprimtarinë e Komisionit të Shërbimit Civil për vitin 2004". Në seancën dëgjimore morën pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit të Shërbimit Civil. Media, edhe pse ishte një seancë dëgjimore mbi veprimtarinë e një institucioni të rëndësishëm siç është KSHC, nuk ishte e pranishme. Komisioni dëgjoi raportimin e bërë nga kryetari i KSHC z.Roland Përmeti. i cili bëri një ekspozitë të zgjeruar të punës së këtij institucioni të pavarur në të gjitha aspektet e veprimtarisë së tij.

Pas raportimit, deputetët i drejtuan pyetje anëtarëve të KSHC dhe, më pas diskutuan rreth raportit vjetor për veprimtarinë e këtij institucioni. Në përfundim të diskutimeve të seancës dëgjimore, në përputhje me nenin 103, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni hartoi dhe miratoi një projektrezolutë për vlerësimin e punës së këtij institucioni, e cila më pas u depozitua sipas procedurës për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Në seancën dëgjimore me Prokurorin e Përgjithshëm, anëtarët e Komisionit u njohën me një raport të përgjithshëm të veprimtarisë së këtij institucioni. Deputetët i drejtuan pyetje që lidheshin kryesisht me luftën kundër

kriminalitetit dhe zbatimin e ligjit pa u futur në çështje konkrete.

Çështje të tjera që janë shqyrtuar në Komision gjatë muajit shkurt kanë qënë: propozimi i kandidaturave alternative për anëtar të Komisionit të Shërbimit Civil; shqyrtimi i kandidaturave për Avokatin e Popullit lidhur me plotësimin e kushteve ligjore; shqyrtimi i dekreteve të Presidentit nr. 4481 dhe nr.4482 datë 17.02.05 "Për emërimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë".

Në mbledhjen e datës 23.02.2005, u prezantuan letrat e popullit dhe Peticionet e ardhura në adresë të ish Komisionit të Drejtave të Njeriut i cili është bashkuar me Komisionin Ligjeve sipas rregullores së re të Kuvendit. Sipas relatorit z.Pjetër Arbnori këto letra kanë për objekt probleme të drejtave të njeriut lidhur me pretendime për dhunën policore, ndalimin e padrejtë të zhvillimit të manifestimit, mosdhënien e pensionit të parakohshëm si dhe për çështje të tjera. Subjekte të këtyre ankesave kanë qënë qytetarë të ndryshëm si dhe Sindikata e tregut valutor. Pas leximit të këtyre letrave dhe peticioneve, komisioni nuk vendosi për ndjekjen dhe hapat e mëtejshëm lidhur me verifikimin ose zgjidhjen e problemeve të ngritura. Gjithashtu, në relacionin e përgatitur për seancën plenare, nuk u evidentuan këto çështje.

Pjesëmarrja e deputetëve

Nga 12 mbledhje të Komisionit të zhvilluar gjatë muajit shkurt, 9 deputetë, nga 19 anëtarë që ka Komisioni, kanë marrë pjesë në më shumë se 8 mbledhje. 5 deputetë kanë marrë pjesë në jo më shumë se 7 mbledhje.

Nga seancat dëgjimore të zhvilluara në Kuvendin e Shqipërisë (janar – shkurt 2005)

RAPORT PËR VEPRIMTARINË E KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2004

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 3.02.2005, zhvilloi seancën dëgjimore publike “Për Veprimtarinë e Komisionit të Shërbimit Civil për vitin 2004”.

Në seancën dëgjimore morën pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit të Shërbimit Civil. Media, edhe pse ishte një seancë dëgjimore mbi veprimtarinë e një institucioni të rëndësishëm siç është KSHC, nuk ishte e pranishme.

Komisioni dëgjoi raportimin e bërë nga kryetari i KSHC z.Roland Përmeti, i cili bëri një ekspozë të zgjeruar të punës së këtij institucioni të pavarur në të gjitha aspektet e veprimtarisë së tij, ku, ndër të tjera përfshiheshin çështjet: shqyrtimi dhe zgjidhja e ankesave; rritja e nivelit të mbikqyrjes dhe menaxhimit të shërbimit civil; bashkërendimi i punës si dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera; ecuria e reformave në shërbimin civil në kuadër të procesit të integritetit në BE; bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare; si dhe prioritetet për vitin 2005.

Pas raportimit, deputetët i drejtuan pyetje anëtarëve të KSHC dhe, më pas diskutuan rreth raportit vjetor për veprimtarinë e këtij institucioni. Deputetët, në përgjithësi, vlerësuan punën e bërë nga ky institucion dhe arritjet e tij krahasuar me një vit më parë. Gjithashtu, ata mbështetën

shqetësimin kryesor të anëtarëve të KSHC lidhir me shkallën e zbatimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil” si dhe domosdoshmërinë e amendimit të këtij ligji me qëllim përmirësimin e punës në procesin e reformimit të administratës publike.

Në përfundim të diskutimeve të seancës dëgjimore, në përputhje me nenin 103, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni hartoi dhe miratoi një projektrezolutë për vlerësimin e punës së këtij institucioni, e cila më pas u depozitua sipas procedurës për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

DISA KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME NGA RAPORTI I KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

KSHC është strukturë e rëndësishme institucionale dhe ligjore, i cili plotëson skemën e zbatimit të ligjit. KSHC është një institucion i pavarur nga institucionet e tjera e në radhë të parë nga Këshilli i Ministrave. Anëtarët e KSHC-së janë të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

KSHC ka disatribute të rëndësishme ligjore e juridiksionale, të cilat e shndërrojnë atë në një arbitër administrativ për zgjidhjen e ankesave ndaj vendimeve në lidhje me nëpunësin civil dhe një mbikqyrës i zbatimit të ligjit në fushën e administrimit të shërbimit civil në të gjitha institucionet që hyjnë në sferën e veprimit të ligjit për statusin e nëpunësit civil.

Veprimtaria e e KSHC-së gjatë vitit 2004,- sipas raportit,- ka ndikuar në fuqizimin e qëndrueshmërisë së shërbimit civil, në rritjen e performancës së nëpunësve civilë dhe në thellimin e reformës në administratën publike shqiptare.

Gjatë vitit 2004 KSHC ka zhvilluar 69 mbledhje si institucion kolegjal, rreth 6 mbledhje në muaj, të cilat janë zhvilluar në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe “Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të KSHC-së” të miratuar me vendimin nr.47, datë 20.06.2002 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në këto mbledhje janë zhvilluar seanca dëgjimore për 287 ankesa dhe janë marrë vendime për 268 prej tyre. Krahasuar me vitin 2003 ka një rritje prej 56 ankesash paraqitur në KSHC për shqyrtim.

Nga 275 çështje të shqyrtuara, 39.4 % e numrit të përgjithshëm të ankesave, kanë përfunduar në favor të nëpunësit civil ankues, ndërsa 27 %, janë rrëzuar si të pabazuara në ligj dhe 31.3 % e çështjeve të shqyrtuara kanë përfunduar me pushim shqyrtimi.

Vendimet e KSHC-së kanë qenë të bazuara në ligj. Këtë fakt e tregon edhe lënia e në fuqi e 39 vendimeve nga 43 të ankimuara pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Niveli i zbatimit të vendimeve të KSHC-së nuk ka qenë i kënaqshëm. Nga 110 vendime të dhëna në favor të ankuesve janë zbatuar direkt nga organet administrative që u janë kundërtuar vetëm 39 prej tyre ose 28 % e tyre. Akoma më i pa pranueshëm është mosbatimi nga drejtues të ndryshëm i 38 vendimeve, të cilat janë shqyrtuar dhe janë lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, e për rrjedhojë janë kthyer në tituj ekzekutivë. Zyra e Përmbarrimit, si organ kompetent shtetëror duhet të luajë rolin e saj ligjor, për ekzekutimin e detyrueshëm të këtyre vendimeve.

Për një funksionim me efikasitet të KSHC-së si një institucion relativisht i ri, kërkohet mbështetje politike, institucionale, por edhe financiare.

Në njësitë e administratës publike vendore ka një shkallë relativisht të ulët njohje të ligjit për shërbimin civil. Shkeljet e ligjit për shërbimin civil konstatohen sidoms në pranimin e nëpunësve civilë, duke aplikuar emërimet nga titullarët e institucioneve, pa iu nënshtruar procedurave ligjore për rekrutimin, ç'ka është një shkelje e hapur e ligjit për pranimin në shërbimin civil. Shfaqje të moszbatimit të ligjit janë ndeshur edhe në lëvizjet paralele; në ngritjet në detyrë dhe në procesin e konfirmimit të nëpunësve civilë në fund të periudhës së provës.

Në praktikë janë evidentuar edhe vështirësi në zbatimin e skemës së shërbimit civil që kanë ardhur për shkaqe objektive si mungesa e buxhetit, largimi i specialistëve të arsimuar etj.

Në administratën qëndrore konstatohen përmirësime të dukshme në disa drejtime si: në procesin e emërimit janë përmirësuar procedurat e konkurimit;

është konsoliduar procesi i vlerësimit të arritjeve të punës vjetore të nëpunësve civilë me qëllim forcimin e performancës dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të tyre.

REKOMANDIME

1. Për të rritur shkallën e zbatimit të ligjit “Statusi i Nëpunësit Civil” është e nevojshme që KSHC në ushtrimin e funksionit të saj mbikqyrës për administrimin e shërbimit civil të institucioneve që hyjnë në fushën e veprimit të këtij ligji, të përdorë mjete juridike më efektive e detyruese ndaj institucionit ku konstaton parregullsi, pasi mjete ligjor i ‘paralajmërimit’ ka rezultuar pasiv dhe nuk i përgjegjet dinamikës së veprimtarisë së administratës publike. Për këtë qëllim duhet të bëhet rregullimi në nenin 8 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, ku të parashikohet e drejta e KSHC-së për të ndryshuar ose shfuqizuar aktet administrative të institucionit përkatës të administratës publike kur ato nuk janë në përputhje me kërkesat e ligjit.

2. Për zbatimin në kohë të vendimeve të KSHC-së në lidhje me ankesat e nëpunësve civilë është e nevojshme parashikimi shprehimisht në ligj që ekzekutimi i aktit administrativ duhet të pezullohet kur nëpunësi civil paraqet ankim ndaj këtij akti në KSHC dhe ky plotësim të bëhet në nenin 8, pika 2, të ligjit të lartpërmendur.

3. Nga praktika e deritanishme shtrohet si kërkesë vendosja e masave detyruese ndaj drejtuesve të institucioneve të cilët nuk zbatojnë vullnetarisht vendimet e KSHC-së.

Së pari, duhet të plotësohet në nenin 8, pika 3, e ligjit të lartpërmendur se vendimet e KSHC-së të cilat kanë marrë formë të prerë pa u ankimuar janë tituj ekzekutivë.

Së dyti, parashikimi i sanksioneve apo peanaliteteve për drejtuesit e administratës publike qëndrore dhe vendore të cilat nuk zbatojnë vendimet e KSHC-së.

4. Gjithashtu ulja e afateve të ankimit në KSHC dhe ndaj vendimeve të

KSHC-së duhet të jetë 15 ditë nga komunikimi i tyre dhe jo 30 ditë pune siç është aktualisht. Ky ndryshim i afateve do të rrisë shpejtësinë dhe efektivitetin e vetë vendimeve të KSHC-së në zbatimin e ligjit.

5. Një drejtim tjetër ku duhet të ndryshohet ligji është dhe zgjerimi i sferës së shërbimit civil dhe me institucione të tjera e konkretisht, në institucionet e administratës qendrore të përfshihen dhe institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave; në varësi të Ministrive; degët e ministrive në rrethe si dhe administratën e Prefektit, ndërsa në institucionet e administratës vendore të përfshihet edhe administrata e komunave.

6. Praktika e deritanishme flet se procesi pranimit në shërbimin civil duhet të përmirësohet.

Së pari, duke unifikuar konkurimet si kohë që mund të jetë 1 ose 2 herë në vit sipas nevojave që shtron plotësimi i vendeve të lira në shërbimin civil dhe jo një konkurim për një vend të lirë pune;

Së dyti, për të evituar problemet e shfaqura nga formalizmi dhe subjektivizmi në procesin e pranimit në shërbimin civil, me qëllim që të kryhet një përzgjedhje e kandidatëve bazuar në meritat reale, kemi mendimin,- sipas raportit,- se konkurimet nuk duhet të kryhen nga vetë institucionet por nga një agjenci e veçantë publike me detyrë konkrete zgjedhjen e më të mirëve në tregun e punës nëpërmjet testimave bazuar në metoda bashkëkohore. Fituesi i konkurimit do të jetë fituesi i vendit të punës i shpallur për konkurim, duke hequr procesin e përzgjedhjes me 3 kandidatët më të mirë.

Së treti, ngritja në detyrë e nëpunësve civilë si shprehje e zhvillimit të karrierës duhet të bëhet me konkurim të posaçëm vetëm me anë të dokumenteve. Gjithashtu ngritja në detyrë nuk mund të bëhet më tepër se një klasë, bazuar në përcaktimin e klasave që e jep neni 11 i ligjit dhe me kusht që nëpunësi civil të ketë punuar për një periudhë jo më pak se 3 vjet në pozicionin e mëparshëm.

RAPORT PËR VEPRIMTARINË E AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2004

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 7.03.2005, zhvilloi seancën dëgjimore publike “Për veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2004”. Në mbledhje mori pjesë Avokati i Popullit dhe përfaqësues të tjerë nga ky Institucion si dhe media të ndryshme.

Komisioni i Ligjeve dëgjoi raportimin e bërë nga Avokati i Popullit, zoti Ermir Dobjani, i cili bëri një ekspozitë të përmbledhur të punës së Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2004 në të gjitha aspektet e veprimtarisë së tij, pasi në mënyrë të zgjeruar ajo është paraqitur në Raportin Vjetor të depozituar në Kuvend.

Komisioni në përgjithësi vlerësoi punën e bërë nga ky institucion për zbatimin e objektivit kryesor për ti siguruar shtetasve shqiptare ndihmën dhe keshillat e nevojshme në kohën e duhur.

Pas raportimit, anetaret e Komisionit të Ligjeve diskutuan rreth raportit vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit. Shumica e deputetëve vlerësuan punën e bërë nga ky institucion dhe arritjet e tij krahasur me një vit më parë dhe mbështetën shqetësimin e këtij institucioni për të tërhequr vëmendjen e Administratës publike shqiptare, përfshirë gjyqësorin dhe prokurorinë që të vlerësojnë akoma më shumë kërkesat dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit gjatë veprimtarisë së tyre. Gjithashtu u vlerësua e domosdoshme ndryshimi i legjislationit për Avokatin e Popullit me qëllim rritjen e efektivitetit dhe forcimin e rolit të Avokatit të Popullit në të ardhmen.

Disa deputetë kujtuan edhe mbështetjen që i kanë dhënë Avokatit të Popullit në votim në Kuvend për rizgjedhjen e tij në këtë detyrë. Megjithatë ata kërkuan që Avokati i Popullit të vlerësojë dhe të rrisë përgjegjësinë e tij për vitin në vazhdim. Ata kërkuan që raporti i vitit 2005 të jetë më i plotë dhe më i hollësishëm duke synuar më shumë në problemet që shqetësojnë një masë të gjerë njerëzish.

Nga të gjithë deputetët u mbështet kërkesa e Avokatit të Popullit për ndryshimin e ligjit dhe për përmirësimin e tij. Nga ana e tij Avokatit i Popullit z.Ermir Dobjani u premtoi deputetëve se do të sillte në komision një draft të këtyre ndryshimeve brenda muajit duke kërkuar edhe një konsensus nga të gjithë deputetët për këto ndryshime dhe për rritjen e e bixhetit të Avokatit të Popullit.

Në përfundim të diskutimeve të seancës dëgjimore, Komisioni për Çështjet Ligjore hartoi dhe miratoi një projektrezolutë të vlerësimit të punës së këtij Institucioni dhe ia paraqiti atë për miratim seancës plenare.

Projekt-rezolutë për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2004

Kuvendi i Shqipërisë,

Njeh dhe mbështet veprimtarinë e Avokatit të Popullit për të rritur përgjegjshmërinë dhe transparencën e veprimtarisë së administratës publike shqiptare, përfshirë organet ekzekutive të gjyqësorit dhe të prokurorisë. Duke verifikuar ankesat dhe kërkesat e shtetasve shqiptarë, me zgjidhjet dhe rekomandimet e tij ka ndikuar që gjithë organet dhe autoritetet publike të punojnë më mirë në favor të qytetarëve për të realizuar një qeverisje më të mirë.

Dhënia e ndihmës ligjore nëpërmjet rekomandimeve dhe këshillave në rastet e konflikteve midis administratës dhe publikut, zbulimi i defekteve të administratës, denoncimi i sjelljeve të këqia të nëpunësve kundrejt qytetarëve, presioni për ndryshimin e procedurave të rënduara dhe të paqarta të Administratës Publike, krijimi i kushteve që qytetarët të gëzojnë të drejtat e tyre në marrjen e informacioneve të nevojshme nga Administrata Publike, nxitja e transparencës së kësaj të fundit në veprimtarinë e saj, angazhimi në rritjen e cilësisë së shërbimeve publike kanë qenë drejtimit kryesorë të veprimtarisë së Avokatit të Popullit në zbatim të legjislationit përkatës.

Kuvendi, pasi u njoh me Raportin për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2004, në bazë të nenit 26 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” dhe nenit 103, pika 2 të Rregullores së Kuvendit konstaton:

Avokati i Popullit tashmë është një institucion kushtetues i konsoliduar në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë që vepron i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidentalitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë. Veprimtaria e këtij institucioni është bërë gjithnjë e më publike. Kjo duket në besimin në rritje të publikut shqiptar tek ky institucion si dhe reagimin gjithmonë e më pozitiv të administratës publike shqiptare ndaj rekomandimeve të tij. Institucionet ndërkombëtare që merren me të drejtat e njeriut dhe ato homologë e kanë vlerësuar në vazhdimësi aktivitetin e këtij institucioni.

Kuvendi kërkon që për vitin 2005 t i kushtohet vëmendje e veçantë këtyre objektivave:

1-Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Kuvendin, jo vetëm për ta informuar më mirë për situatën e të drejtave të njeriut dhe shkeljet e administratës publike në Shqipëri, por edhe për të bërë ndryshimet e nevojshme ligjore, që do të sillnin një efektivitet më të madh të Zyrës së Avokatit të Popullit.

2-Forcimi i bashkëpunimit me të gjitha segmentet e Administratës publike shqiptare për rritjen e standarteve të qeverisjes ose thënë më thjeshtë, për mirëqeverisje si dhe forcimi i bashkëpunimit me organizma të shoqërisë civile si grupe “presioni” pozitiv mbi administratën. Ky bashkëpunim si dhe ai me median do të konsolidojë më tej arritjet e deritanishme, me synim rritjen e efektshmërisë së ndërhyrjeve të Avokatit të Popullit për ngulitjen e praktikave të mira administrative.

3-Vazhdimi i veprimtarisë ndërgjegjësuese të publikut dhe të administratës për vendin dhe rolin e Avokatit të Popullit. Organizimi i ditëve të hapura në mënyrë periodike në zona të ndryshme të vendit, duke zbatuar edhe forma të tjera për tju afruar sa më shumë publikut.

4-Publikimi më mirë dhe më shumë i problemeve kryesore të evidentuara nga shkeljet e Administratës Publike në fushën e të drejtave të njeriut duke kërkuar edhe masa ndaj personave përgjegjës sipas ligjit.

5-Hapja e zyrave rajonale dhe caktimi i përfaqësuesve vendorë të Avokatit të Popullit sa më shpejt të jetë e mundur si dhe mirëfunksionimi i nënseksionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve mbi bazen e një studimi paraprak të detajuar.

6-Angazhimi i mëtejshëm për rritjen cilësore dhe sasiore të nivelit të raportimeve pranë organizmave ndërkombëtare. Kjo duhet të bëhet si në raportet e paraqitura nga pala shtetërore, ashtu edhe të raporteve alternative, të përgatitura në bashkëpunim me shoqërinë civile.

7-Domosdoshmëria për të ndërmarre nismën ligjore për të realizuar ndryshimet e nevojshme në ligjin organik “Për Avokatin e Popullit” për të reflektuar përmirësimin dhe plotësimin e kompetencave ligjore të Avokatit të Popullit.

Me këtë rast Kuvendi tërheq vëmendjen e Administratës publike shqiptare, përfshirë gjyqësorin dhe prokurorinë që të vlerësojnë akoma më shumë kërkesat dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit gjatë veprimtarisë së tyre.

Konkluzione të raportit që dalin nga ankesat për punën e administratës publike shqiptare.

Pa pretenduar se konstatimet dhe konkluzionet që kemi nxjerrë gjatë raportit të punës për vitin 2004 për ankesat dhe kërkesat e shqyrtuara për çdo ministri më vete dhe këto që do të evidentojmë më poshtë janë përfundimtare dhe të pakritikueshme mendojmë të theksojmë se:

Në veprimtarinë e administratës publike shqiptare ka mjaft raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Këto shkelje paraqiten si shkelje të afateve të përcaktuara për zgjidhjen në rrugë administrative të çështjeve në fusha të caktuara. Ka mosvlerësim, mosshqyrtim dhe mospërgjigje ndaj ankesave të

qytetarëve, refuzim për pranimin e kërkesave, ankesave e aplikimeve të tyre, mohim të së drejtës për të marrë pjesë në procedurat administrative. Të gjitha këto janë mohim i së drejtës për t'u mbrojtur apo për të marrë informacion dhe për t'u njohur me dokumentat zyrtare.

Dihet se një pjesë e madhe e shërbimeve të administratës publike bëhet kundrejt pagesës së qytetarëve dhe shpesh këto tarifa janë jo të vogla në raport me pagat dhe nivelin e jetesës në Shqipëri. Ndonëse ka mjaft përmirësime në krahsim me dy apo më tepër vite më parë, akoma ka rradhë dhe humbje kohe për të kryer shërbimet për të cilat vetë administrata është e interesuar që klientët t'i kryejnë këto shërbime publike ose pagesa si p.sh në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pagesat për KESH, TELECOM etj. Evitimi i rradhëve të pritjeve apo çfilitjeve të qytetarëve ka bërë që këta të fundit ta ndejnë veten të respektuar, të kursejnë kohën e tyre të çmuar etj. Por mbi të gjitha do të evitonin edhe shfaqjet e korrupsionit “të vogël” që jo rrallë herë shoqëron këto situata. Duhet ta themi se shpesh kemi vënë re qëndrime të drejta dhe nivel të pranueshëm të vetëkorrigjimit të shkeljeve, sidomos nga administrata publike e nivelit të lartë në ministrinë, në drejtoritë qëndrore, apo prefektura. Por kjo nuk ka ndodhur gjithmonë me bashkitë dhe sidomos me komunat apo autoritetet publike të nivelit të ulët, sidomos me degët e policisë ndërtimore në rrethe.

Përballë sfidave që ka përpara vetes, përveç përmirësimit të efektivitetit dhe kompletimit të sistemit të ri ligjor e administrativ brenda procesit të integritetit me Europën e Bashkuar, mendojmë se detyrat kryesore për të gjithë administratën tonë publike janë:

1. Të rritet kontrolli në të gjitha fushat e veprimtarisë konkrete të hallkave të administratës. Të mos kontrollohet vetëm aspekti financiar, siç ndosh shpesh, por vetë veprimtaria dhe funksioni përshkruar i punës së çdo nëpunësi. Për këtë duhet forcuar si kontrolli i brendshëm, ashtu edhe ai i jashtëm mbi administratën. Mund të krijohen struktura të reja kontrolli dhe atje ku ekzistojnë, duhen forcuar hallkat kontrolluese. Roli i Kontrollit të Lartë të

Shtetit është i pazëvendësueshëm, veçse rekomandimet e tij duhen zbatuar pa hezitim.

2. Duhet të zbatohen pa hezitim dispozitat e ligjit “Për Kodin e Procedurave Administrative” dhe të ligjit “Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentat Zyrtare”, në të gjitha fushat dhe nivelet e administratës publike. Ndaj, çdo qytetari apo nëpunësi civil që me dashje apo pakujdesi shkel këto ligje, në të ardhmen duhen zbatuar masa disiplinore në varësi të shkallës së përgjegjësisë. Këto ligje kanë mbi 5 vjet që kanë hyrë në fuqi dhe askush nuk mund të shfajësohet me pakujdesi apo paditurinë e tyre.

3. Ligji “Për Statusin e Nëpunësit Civil” duhet të zbatohet për çdo vend pune të administratës publike. Kudo duhet të ketë një përshkrim të saktë të të drejtave dhe detyrave që ka personi në çdo vend pune (job description).

4. Të koordinohen më mirë punët brenda ministrive, midis ministrive me njëra-tjetrën e në veçanti marrëdhëniet e reja të decentralizimit dhe autonomisë së pushtetit vendor duhet të pranohen e saktësohen në praktika pozitivisht.

5. Forcimi i punës së drejtorive apo sektorëve juridikë në dikastere dhe respektimi i sugjerimeve të tyre nga titullarët, si dhe plotësimi me juristë i organeve më të ulta, veçanërisht në pushtetin vendor. Kjo ka ndikuar në nivelin e vendimeve të këtyre organeve, përfshirë këtu edhe rastin e marrjes së vendimeve të kundraligjshme apo të parregullta, sepse në mjaft komuna, por edhe nëpër bashki nuk ka juristë, apo janë juristë që kanë diploma, por janë të paaftë.

6. Administrata publike e të gjitha niveleve duhet të bëjë normë të punës që të njohë nivelin e saj qeverisës. Kjo realizohet duke krijuar herë pas here sondazhe në publik për punën dhe zyrtarët e saj, por duhet edhe të zhvillojë më tepër punë propagandistike për veprimtaritë e saj dhe për çfarë shërbimesh i ofron ajo publikut.

7. Njohja dhe zbatimi i Kodit Etik të Administratës Publike të miratuar me ligjin Nr.9131 datë 08.09.2003 nga të gjithë funksionarët dhe nëpunësit publikë gjatë kryerjes së detyrave të tyre, bashkë me ligjin “Për Konfliktin e

Interesave” që besojmë se do të miratohet këtë vit, do të luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e punës së administratës publike shqiptare.

Ne nuk mund të pretendojmë se kjo është një listë e plotë me rekomandime, të cilat do ta bëjnë punën e administratës shqiptare më të mirë ose do të përmirësojnë rrënjësisht menjëherë cilësinë e saj. Qëllimi ynë është modest: mbi bazën e trajtimit të ankesave të praqitura pranë nesh lidhur me punën e administratës, të japim shkurtimisht vëzhgimet dhe gjetjet tona, pra disa rekomandime që të vlejné.

Ne e dimë që Kuvendi është institucion politik, prandaj jemi modestë dhe për të qenë të ekuilibruar, duhet të themi se duke patur parasysh rastet e ankesave dhe kërkesave që kanë ardhur në Institucionin tonë dhe veprimtarinë e administratës publike shqiptare, nuk është e mundur që të japësh një gjykim të prerë pozitiv, pa patur kontestime të bazuara për të kundërtën e këtij gjykimi.

Ne kemi thënë dhe e përsëritim se puna jonë konkrete me organet e administratës publike ka si objektivat kryesor: të merremi me rastet, ku ka dhunim të të drejtave të njeriut ose parregullsi të tjera që çojnë në shkeljen e këtyre të drejtave dhe të ndihmojmë qytetarët.

Nga punimet e Kuvendit për periudhën Janar - Mars 2005

Alma Kondakçiu

Më datë 10 janar 2005 Kuvendi, me nismë të më shumë se 1/5 së deputetëve, u mbledh në një sesion të jashtëzakonshëm. Thirrja e Kuvendit në sesion të jashtëzakonshëm mori shkas nga Protokollin e nënshkrimit të datës 30 dhjetor 2004 midis dy forcave më të mëdha politike, PS PD dhe në prani të Kryetarit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Pavël Vacek. Protokollin parashikon që palët PS PD bien dakord të shfuqizojnë ligjin aktual mbi ndarjen e zonave zgjedhore dhe të përgatisin e të miratojnë një ligj të ri që do të përcaktojë 100 zona zgjedhore me një numër përafërsisht të barabartë zgjedhësish dhe me një shmangje prej jo më shumë se 10 për qind nga numri mesatar i zgjedhësve në një zonë zgjedhore. Në lidhje me këtë, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri do të ndihmojë në ngritjen e një grupi pune ekspertësh për ndarjen e zonave zgjedhore me përfaqësues të PS-së dhe PD-së, të cilët do të hartojnë një ligj të ri, në prani edhe të një eksperti ndërkombëtar në këtë fushë. Po sipas protokollit të nënshkruar, grupi i ekspertëve, në ndarjen e zonave zgjedhore, do të mbështetet tek një kombinim i përshtatshëm i kriterëve, ashtu si renditen në Kodin e Praktikave të Mira të Komisionit të Venecias të Këshillit të Europës, çka do të thotë tek: popullsia, numri i banorëve me shtetësi shqiptare, numri i zgjedhësve të regjistruar dhe mundësisht, numri i zgjedhësve që kanë votuar, me qëllim që të përcaktohen Shihrat më të përafërta të mundshme të numrit të vërtetë të zgjedhësve në zonat elektorale.

Në referim të këtij Protokollin, sesioni i jashtëzakonshëm parashikonte si rend

dite shqyrtimin e amendamenteve të Kodit Zgjedhor (mbetur pezull nga sesioni i mëparshëm për shkak të mosarritjes së kompromisit PS PD) si dhe ngritjen e grupit të punës së ekspertëve për projektligjin e ndarjes së zonave zgjedhore.

Për shqyrtimin e *projektligjit* “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” Kuvendi ngriti Komisionin e Posaçëm për Reformën Zgjedhore, i cili në punën e tij u mbështet në rekomandimet e OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias.

Projektligji ka për qëllim realizimin e zgjedhjeve të ndershme, të lira, të drejta dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të vitit 2005. Ai përpiket të eliminojë mangësitë e ligjit ekzistues, të konstatuara gjatë proceseve zgjedhore të vitit 2001 dhe 2003, duke përmirësuar përmbajtjen e shumë neneve të ligjit ekzistues.

Një ndër ndryshimet më të rëndësishme që propozohen ti bëhen ligjit ekzistues ka të bëjë me numërimin e përqëndruar të votave në vende publike, i cili ndikon në rritjen e transparencës gjatë procesit të numërimit të votave dhe rrit përgjegjësinë e anëtarëve të komisioneve zgjedhore dhe të anëtarëve të grupeve të numërimit në administrimin e këtij procesi. Projektligji synon të rrisë kompetencat e organeve të qeverisjes vendore në administrimin e procesit zgjedhor dhe të pakësojë rolin e partive politike në këtë proces.

Ndryshimet e tjera që propozohen ti bëhen ligjit ekzistues kanë të bëjnë me:

- krijimin, organizimin, funksionimin dhe kompetencat e dy niveleve më të ulëta të komisioneve të administratës zgjedhore;
- përmirësimin në organizimin dhe funksionimin e KQZ-së;
- përmirësimin e paketës për listën e zgjedhësve;
- ankimin administrativ dhe gjyqësor ndaj vendimeve të administratës zgjedhore; financimin e fushatës zgjedhore dhe detyrimin për deklaram të financimeve me burim jo-shtetëror;
- caktimin e vëzhguesve, të koalicioneve zgjedhore, zgjidhjen e çështjeve

për personat që nuk mund të votojnë vetë, për votimin në institucionet e posaçme etj.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komisionin e Posaçëm për Reformën Zgjedhore, në Komisionin për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore dhe në seancë plenare deputetët u ndalën veçanërisht në amendamentet e propozuara nga grupet parlamentare të LZHK-së dhe LSI-së.

Në këto amendamente synohet të sigurohet një përfaqësim i plotë i të gjitha forcave politike në procesin zgjedhor, duke e bërë këtë proces demokratik dhe të pranueshëm nga të gjitha palët. Amenduesit kundërshtuan formulën e krijimit të Komisioneve të Zonave Zgjedhore dhe të Komisioneve të Qendrave të Votimit dhe shprehën mendimin se përfaqësimi i forcave politike në këto komisione bipolarizohet nga dy partitë e mëdha, Partia Socialiste dhe Partia Demokratike, gjë që bie në kundërshtim me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it. Në këtë mënyrë, theksuan ata, shmanget përfaqësimi në këto komisione i forcave të tjera të rëndësishme politike. Propozimi i amenduesve ishte që të gjitha partitë që kanë grupe parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë të kenë përfaqësues në Komisionet e Zonave Zgjedhore dhe në grupet e numërimit. Gjithashtu, në amendamentet e tyre propozohet të rritet roli i anëtarëve të komisioneve zonale dhe të vëzhguesve të subjekteve të ndryshme politike në administrimin e procesit të votimit. Gjatë diskutimit përfaqësuesit e grupeve parlamentare të LZHK-së dhe LSI-së akuzuan dy forcat kryesore politike për kompromentim të zgjedhjeve të ardhshme parlamentare.

Në përfundim të diskutimit, projektligji u miratua me shumicë votash.

Më pas, punimet e Kuvendit u fokusuan në pikën e dytë të rendit të ditës, që ishte ngritja e grupit të punës së ekspertëve teknikë, i cili do të sigurojë dhe do të japë asistencën teknike për hartimin e projektligjit për ndarjen e zonave zgjedhore, sipas kriterëve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Përbërja e grupit të ekspertëve mbështetet në Protokollin e nënshkruar më datë 30 dhjetor 2004 midis dy forcave politike PS-PD.

Kuvendi ngarkoi grupin e ekspertëve që të përfundojë punën për hartimin e projektligjit për ndarjen e zonave zgjedhore, duke patur parasysh kriteret që duhen përdorur siç janë popullsia, numri i zgjedhësve të regjistruar dhe numri i zgjedhësve që kanë votuar në votimet e fundit.

I. PROJEKTLIGJE TË SHQYRTUARA NË KOMISIONET E PËRHERSHME TË KUVENDIT DHE NË SEANCE PLENARE

1. P/ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7973, datë 26.7.2005 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” (shqyrtuar në seancë plenare më datë 24 shkurt 2005)

Diskutimi i këtij projektligji në Komisionin për Ekonominë dhe Financat u zhvillua në prani të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ben Blushi, i cili informoi deputetët për mungesën e infrastrukturës në shërbimin e gjendjes civile dhe për domosdoshmërinë e përmirësimit të shërbimit prej saj. Në funksion të këtij qëllimi, projektligji i paraqitur nga Këshilli i Ministrave synon të realizojë informatizimin e shërbimit të gjendjes civile, nëpërmjet dhënies me koncesion të këtij shërbimi kompanive ndërkombëtare të njohura në këtë fushë.

Gjatë diskutimit deputetët e mbështetën nismën e Këshillit të Ministrave për kryerjen e informatizimit të gjendjes civile. Disa deputetë të opozitës shfaqën mendimin se shërbimi i gjendjes civile është një ndër shërbimet themelore të shtetit dhe nuk duhet të jepet me koncesion, siç mund të jepen disa lloj shërbimesh të tjera që kanë burime alternative si arsimi, shëndetësia etj. Ata theksuan se dhënia me koncesion e këtij shërbimi publik kompanive private do të dobësojë rolin mbikëqyrës të shtetit ndaj tij dhe shprehën mendimin se duhen gjetur mënyra të tjera për kryerjen e informatizimit të këtij shërbimi. Burimet për kryerjen e informatizimit të gjendjes civile, sipas tyre, duhen kërkuar në rezervat që mund të ketë Buxheti i Shtetit, duke shkurtuar shpenzimet e panevojshme dhe, nëse nuk ka të tilla, të gjendet një burim kreditimi, duke nënshkruar marrëveshjet përkatëse qeveritare dhe duke

zbatuar procedurat e parashikuara në ligjin “Për prokurimin publik”, nëpërmjet përzgjedhjes së kompanisë fituese në procesin e tenderimit.

Në përgjigje të shqetësimit të ngritur nga deputetët, Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit informoi deputetët se projektligji parashikon që të gjitha veprimet e gjendjes civile do të kryhen në bazë të ligjit “Për gjendjen civile”, ndërsa kompania private do të kryejë vetëm procesin e informatizimit, do të krijojë Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, i cili do të jetë i kompjuterizuar, si dhe do të prodhojë e shpërndajë dokumentet identifikuese.

Për të mos krijuar keqkuptim mbi përgjegjësinë e shtetit për shërbimet publike, Kuvendi vendosi që të riformulojë nenin 1 të projektligjit, duke përcaktuar si fushë tjetër të dhënies me koncesion ose të arritjes së marrëveshjeve a kontratave të tjera “shërbime të caktuara në administratën publike”.

Në përfundim, Kuvendi e miratoi projektligjin me shumicë votash.

2. Projektligji “Për kontrollin e figurës së personit zyrtar të zgjedhur apo të emëruar në organe të rëndësishme të shtetit” (shqyrtuar në seancë plenare më datë 24 shkurt 2005)

Ky projektligj është nismë e një grupi deputetësh dhe ka për qëllim të sigurojë kontrollin e pastërtisë së figurës të personave zyrtarë, për të rritur efektivitetin e punës së organeve shtetërore. Sipas projektligjit, personat që kanë shërbyer në Sigurimin e Shtetit në vitet 1946-1991 nuk duhet të përfshihen në radhët e personave zyrtarë, të zgjedhur ose të emëruar në funksione drejtuese të organeve të rëndësishme të veçantë. Në projektligj përcaktohen subjektet që do t i nënshtrohen kontrollit të pastërtisë së figurës, organet kontrolluese, kompetencat dhe struktura e tyre.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut relatorët e caktuar nga ky Komision dhanë argumentet e tyre pro dhe kundër tij. Shumica e deputetëve mbështetën argumentet që e kundërshtonin miratimin e këtij projektligji, e konkretisht:

- Projektligji bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila përcakton rastet se kur mund të bëhen kufizime të të drejtave dhe lirive të njeriut. Sipas Kushtetutës, kufizimet nuk duhet të çenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave të njeriut, si dhe nuk mund të bëhen për shkak të ushtrimit të një veprimtarie që nuk ka përbërë përgjegjësi penale apo administrative në kohën kur është ushtruar.

- Projektligji bie ndesh me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe me praktikën e veprimtarisë së institucioneve dhe të organizatave ndërkombëtare, të cilat e konsiderojnë shkelje të të drejtave të njeriut hetimin, gjykimin dhe sanksionet ndaj individëve dhe, aq më tepër, të grupimeve të caktuara shoqërore për veprime që në kohën e kryerjes nuk kanë përbërë ve për penale apo shkelje të ligjit të një natyre tjetër. Përjashtim bëhet vetëm për personat që individualisht kanë kryer ose janë pjesëmarrës në kryerjen e krimeve kundër njerëzimit.

- Për çështjen e verifikimit të figurave zyrtare të personave publikë dhe të individëve të tjerë ka patur një ligj me nr.8043, datë 30 nëntor 1995, i cili është ndryshuar më pas dhe shumica e dispozitave të tij janë shfuqizuar, për shkak të vërejtjeve të institucioneve ndërkombëtare se ligji shkel të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Miratimi i një ligji të ngjashëm në kohën e sotme nuk është i drejtë, pasi kanë kaluar 14 vjet nga rrëzimi i sistemit të mëparshëm dhe gjendja aktuale nuk e dikton një gjë të tillë. Ushtrimi i kontrollit mbi figurën e personave zyrtarë sot bëhet për një kategori të caktuar funksionarësh, është i mbështetur në ligj dhe ushtrohet për veprime ose mosveprime që përbëjnë ve për penale. Penalizimi i personave të parashikuar në projektligj nuk mund të bëhet, pasi nuk ka procese gjyqësore dhe prova konkrete të fajësisë penale dhe administrative për çështje të së kaluarës për çdo individ.

- Projektligji i le hapësirë çdo individ që të ketë të drejtën e informimit, gjë që bie ndesh me parimin kushtetues të mbrojtjes së të dhënave personale.

- Në të drejtën shqiptare dhe ndërkombëtare faji dhe përgjegjësia janë

individuale. Ekzistenca ose jo e tyre duhet të provohet rast pas rasti.

- Hetimi dhe gjykimi i çështjeve që kanë të bëjnë me veprime të së kaluarës bëhet në bazë të ligjit të kohës kur ato janë kryer.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit deputetët dëgjuan edhe opinionin e relatorit tjetër të caktuar për të, përfaqësues i Grupit Parlamentar të PD-së, i cili e mbështeti projektligjin, madje kërkoi zgjerimin e objektit të tij, duke përfshirë në të edhe dy kategori të tjera:

- Ideatorët e Sigurimit të Shtetit, mbështetur në vendimet e Byrosë Politike të KQPPSH-së;

- Drejtuesit kryesorë të Sigurimit të Shtetit.

Deputetët dëgjuan edhe opinionin e nismëtarëve të projektligjit, të cilët u shprehën se ai nuk bie ndesh me Kushtetutën, e cila parashikon se kufizimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në të mund të vendoset vetëm me ligj. Gjithashtu, ata theksuan se Kushtetuta i jep të drejtë çdo individit që, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi vendosi me shumicë votash që të mos e miratojë projektligjin.

II. RAPORTIME TË INSTITUCIONEVE TË PAVARURA

1. Raport i Komisionit të Shërbimit Civil (shqyrtuar në seancë plenare më datat 7 dhe 10 shkurt 2005)

Kryetari i Komisionit të Shërbimit Civil, Roland Përmeti, raportoi në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe në seancë plenare për punën e institucionit që ai drejton gjatë vitit 2004 në të gjitha aspektet e veprimtarisë së saj si, shqyrtimi dhe zgjidhja e ankesave, rritja e nivelit të mbikëqyrjes dhe menaxhimi i shërbimit civil, bashkërendimi i punës dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera, ecuria e reformave në shërbimin civil në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Europian, bashkëpunimi i vazhdueshëm me institucionet ndërkombëtare si dhe prioritetet për vitin 2005.

Gjatë diskutimit për këtë Raport deputetët vlerësuan punën dhe rezultatet e arritura nga Komisioni i Shërbimit Civil në krahasim me një vit më parë. Në mbështetje të shqetësimit të ngritur nga anëtarët e këtij Komisioni për shkallën e pamjaftueshme të zbatimit të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, ata kërkuan rritjen e shkallës së bashkëpunimit të këtij institucioni me institucionet e tjera të administratës publike, si dhe rritjen e përgjegjësisë së këtyre të fundit për të zbatuar kërkesat e këtij ligji.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi një Rezolutë për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit të Shërbimit Civil për vitin 2004.

2. Raportim i Këshillit Kombëtar të Radiotelevizionit (KKRT-së) (shqyrtuar në seancë plenare në datat 15 dhe 17 shkurt 2005)

Kryetari i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, Halil Lalaj, në Raportin e tij informoi Kuvendin për veprimtarinë e institucionit që ai drejton gjatë vitit 2004.

Gjatë diskutimit për këtë Raport në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe në seancë plenare deputetët vlerësuan punën e kryer prej KKRT-së gjatë vitit 2004. Ata u ndalën në disa probleme që kanë të bëjnë me veprimtarinë e KKRT-së, si administrimi i frekuencave, programet televizive, plotësimi i kushteve të licencës nga operatorët radiotelevizivë, precedenti “dixhital”, monitorimi i programeve informative, detyrimet financiare të operatorëve etj.

Në fund, Kuvendi e miratoi Raportin për veprimtarinë e KKRT-së për vitin 2004, duke hartuar Vendimin përkatës.

3. Informim i Prokurorit të Përgjithshëm (paraqitur në seancë plenare më datë 24 shkurt 2005)

Prokurori i Përgjithshëm, Theodhori Sollaku, informoi Kuvendin për rezultatet në treguesit kryesorë të gjëndjes së kriminalitetit në Shqipëri gjatë vitit 2004, drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër tij, shkallën e zbatimit të ligjit, përmirësimet e nevojshme ligjore për të rritur efektivitetin në luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe atij të organizuar e korrupsionit në

veçanti, efektivitetin në ndjekjen penale dhe në parandalimin e kriminalitetit.

Mbështetur në realizimin e treguesve të punës, arrihet në përfundimin se Prokuroria e Përgjithshme ka arritur rezultate pozitive në drejtimit më kryesore të ushtrimit të funksioneve nga prokurorët e të gjitha niveleve, duke rritur volumin e punës, efektivitetin dhe ligjshmërinë në ndjekjen penale, në ngritjen e akuzës së gjykatë në emër të shtetit, në ekzekutimin e vendimeve penale, në mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit, si dhe në ushtrimin e funksioneve të tjera të ngarkuara me ligj.

I- PROJEKTLIGJE TË SHQYRTUARA NË KOMISIONET E PËRHERSHME TË KUVENDIT DHE NË SEANCË PLENARE

1. P/ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8607, datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i ndryshuar”, shqyrtuar në seancë plenare më datë 3 mars 2005

Qëllimi i këtij projektligji është:

- trajtimi me “Statusin e Dëshmorit të Atdheut” të përfaqësuesve të forcave nacionaliste, pjesëmarrës në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare gjatë periudhës 7 prill 1939-28 nëntor 1944, të cilët me ligjin ekzistues nuk e përfitojnë këtë status, duke u quajtur “bashkëpunëtorë të fashizmit”;

- trajtimi me “Statusin e Dëshmorit të Atdheut” të forcave nacionaliste që luftuan jashtë vendit kundër jugosllavëve;

- heqja e “Statusit të Dëshmorit të Atdheut” të rënëve në luftën e Spanjës;

- trajtimi me “Statusin e Dëshmorit të Atdheut” të të gjithë shqiptarëve të rënë në luftë kundër regjimit komunist, apo të ekzekutuar për arsye politike me dhe pa gjyq në periudhën 29 nëntor 1944 - 22 mars 1991;

- ndryshimi i datës së përkujtimit të dëshmorëve;

- heqja e trajtimit financiar që jepet në ligjin ekzistues për “vëllezërit dhe motrat e dëshmorit të atdheut”.

Gjatë diskutimit rreth këtij projektligji në komisionet e përherëshme të Kuvendit dhe në seancë plenare, i cili u zhvillua në prani të deputetëve

nismëtarë të tij, u shpreh mendimi se përmbajtja e tij bie ndesh me nenin 82, pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, sipas së cilës asnjë projektligj joqeveritar që bën të nevojshme rritjen e shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit ose që pakëson të ardhurat nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave. Deputetët theksuan se projektligji nuk është i shoqëruar me raportin përkatës të Këshillit të Ministrave për mënyrën e mbulimit të shpenzimeve financiare që nevojiten për zbatimin e tij.

Për sa më sipër, Kuvendi vendosi me shumicë votash shtyrjen e miratimit të këtij projektligji në seancë plenare, deri në plotësimin e kriterëve kushtetuese për argumentimin nga Këshilli i Ministrave të mënyrës së mbulimit të efekteve financiare që rrjedhin prej tij.

2. P/ligji “Për caktimin e zonave zgjedhore”, miratuar në seancë plenare më datë 3 mars 2005, miratuar në seancë plenare më datë 3 mars 2005

Gjatë diskutimit për këtë projektligj deputetët shprehën mendimin se ai respekton kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Ndarja e zonave zgjedhore u realizua me konsensus midis forcave të ndryshme politike, duke zbatuar edhe rekomandimet e OSCE-së.

3. P/ligji “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, miratuar në seancë plenare më datë 10 mars 2005

Nëpërmjet këtij projektligji synohet të zëvendësohet dhe të reformohet skema e ofrimit të ndihmës ekonomike dhe përkujdesjes shoqërore ekzistuese, e përcaktuar në ligjin nr.7710, datë 18.5.1993. Projektligji ka për qëllim të përmirësojë përmbajtjen e dispozitave që bëjnë fjalë për ndihmën ekonomike për personat në nevojë, përkujdesjen shoqërore ndaj personave që janë në kushte të veçanta, pagesat për personat e kategorive të veçanta të trajtuara me këtë ligj ose me ligje të tjera.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë specialistët e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale paraqitën një sërë propozimesh për ndryshime e riformulime, të cilat u miratuan nga ky Komision. Një nga ndryshimet kryesore që u propozua synonte

decentralizimin e strukturës së ofrimit të ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore, duke i dhënë më shumë kompetenca organeve të qeverisjes vendore dhe kishte për qëllim rritjen e efikasitetit dhe të shkallës së kontrollit për zbatimin e dispozitave të këtij ligji në shërbim të subjekteve përfituese.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi e miratoi projektligjin me ndryshimet e propozuara nga Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

4. P/vendimi “Për miratimin e Raportit përfundimtar dhe konkluzioneve të Komisionit Hetimor Parlamentar për Hetimin e Prokurimeve Publike të Kryeministrit dhe Ministrive”, miratuar në seancë plenare më datë 23 mars 2005

Komisioni i Posaçëm Hetimor Parlamentar për Hetimin e Prokurimeve Publike të Kryeministrit dhe Ministrive, në përfundim të punës së tij, u paraqit në seancë plenare me dy raporte. Raporti i mbështetur nga shumica e anëtarëve të Komisionit vlerëson punën e Këshillit të Ministrave dhe të ministrive për zbatimin e procedurave të ligjit “Për prokurimin publik”, ndërsa Raporti i mbështetur nga pakica zbulon një sërë shkeljesh ligjore dhe i ngarkon me përgjegjësi këto institucione.

Gjatë diskutimit në seancë plenare deputetët e maxhorancës mbështetën Reportin e shumicës së anëtarëve të Komisionit të Posaçëm Hetimor, ndërsa deputetët e opozitës shprehën shqetësimin e tyre për shkeljet ligjore të paraqitura nga pakica e anëtarëve të këtij Komisioni.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi me shumicë votash Reportin e paraqitur nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Posaçëm Hetimor dhe hartoi projektvendimin përkatës, duke i bashkëngjitur atij Reportin e paraqitur nga pakica.

5. P/ligji “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, miratuar në seancë plenare më datë 24 mars 2005

Projektligji është nismë e Këshillit të Ministrave dhe synon korrigjimin e mangësive që janë vërejtur gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, si dhe përafrimin e tij me legjislacionin përkatës të vendeve të Bashkimit Europian. Ky projektligj

e bazon shërbimin e mbrojtjes së bimëve në përdorimin e metodave bashkëkohore. Numri i dispozitave që përmban projektligji në krahasim me ligjin ekzistues është pakësuar, pasi projektligji trajton çështjet kryesore, ndërsa çështjet e mirëfillta teknike do të trajtohen në aktet nënligjore. Projektligji e kalon kompetencën për zgjidhjen e mjaft çështjeve nga Kuvendi tek Këshilli i Ministrave apo Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për ta bërë më fleksibël ndryshimin dhe përmirësimin e procedurave që parashikohen në të, duke lehtësuar punën e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tij.

Gjatë diskutimit për këtë projektligj në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare deputetët shprehën nevojën e miratimit të tij dhe propozuan disa ndryshime në dispozitat që kanë të bëjnë me kompetencat për hartimin dhe zbatimin e politikës së mbrojtjes së bimëve, përcaktimin e strukturës së institucioneve përgjegjëse për zbatimin e ligjit dhe kompetencat e tyre, rishikimin e dispozitave që përcaktojnë të drejtat për importimin dhe tregtimin e pesticideve, duke e liberalizuar këtë veprimtari për PMB-të që nuk paraqesin rrezikshmëri të lartë.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi e miratoi projektligjin me unanimitet, së bashku me ndryshimet e propozuara nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

6. P/ligji “Për vendosjen dhe kalimin në territorin e Republikës së Shqipërisë të Forcave Ushtarake të huaja, si dhe për dërgimin jashtë vendit të forcave ushtarake shqiptare”, miratuar në seancë plenare me shumicë absolute votash më 24 mars 2005

Projektligji synon të rregullojë rastet, mënyrën dhe procedurat e pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunimin ushtarak ndërkombëtar brenda dhe jashtë vendit, duke respektuar dokumentet dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komisionin për Sigurinë Kombëtare dhe në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut u propozuan disa ndryshime e riformulime në përmbajtjen e

dispozitive të këtij projektligji, të cilat më pas u miratuan në seancë plenare.

II- RAPORTIME TË INSTITUCIONEVE TË PAVARURA

1. Raport i Avokatit të Popullit dhe votimi i projektrezolutës për vlerësimin e punës së këtij institucioni, miratuar në seancë plenare më datë 7 mars 2005

Avokati i Popullit, Ermir Dobjani, raportoi në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si dhe në seancë plenare për veprimtarinë e institucionit që ai drejton.

Gjatë diskutimit rreth raportit të paraqitur, shumica e deputetëve vlerësoi punën e këtij institucioni në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, duke theksuar se objektivi i tij kryesor për t' i siguruar shtetasve shqiptarë ndihmën dhe këshillat e nevojshme në kohën e duhur është realizuar. Pasi vlerësuan punën e administratës publike, përfshirë edhe organet gjyqësore e prokurorinë, për zbatimin e kërkesave dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit, deputetët theksuan se është e nevojshme që puna në këtë drejtim të përmirësohet, duke rritur bashkëpunimin midis këtyre institucioneve.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi një rezolutë, në të cilën ndër të tjera, paraqiti objektivat për vitin 2005.

2. Raport i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe votimi i projektrezolutës për vlerësimin e punës së këtij institucioni, shqyrtuar dhe miratuar në seancë plenare në datat 15 dhe 17 mars 2004

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Robert Çeku, informoi Komisionin për Ekonominë dhe Financat si dhe seancën plenare me veprimtarinë e këtij institucioni gjatë vitit 2004. Ai theksoi se nga kontrollet e ushtruara në përdorimin e fondeve të Buxhetit të Shtetit është zbuluar një dëm ekonomik total prej 3.8 miliardë lekësh, i konstatuar në 98 subjekte.

Sektorët në të cilët ka patur dëm ekonomik më të lartë kanë qenë sektori i tatimeve, doganave, i shitjes së pasurisë shtetërore, i prokurimeve publike, i pagave e shpërblimeve etj. Lidhur me këtë të fundit, zoti Çeku i sugjeroi

Komisionit për Ekonominë dhe Financat që të përshpejtojë punën për kryerjen e studimit për hierarkinë e pagave në administratën shtetërore, për të unifikuar dhe saktësuar kompetencat ligjore institucionale në caktimin e pagave të punës, pasi mbështetur në ligjet ekzistuese, institucione të ndryshme bëjnë interpretime të ndryshme për këtë çështje.

Më pas, zoti Çeku informoi deputetët për masat dhe rekomandimet e propozuara nga KLSH, si dhe për shkallën e zbatimit të tyre nga institucionet e administratës publike, e cila ka nevojë të rritet. Për shkeljet më të rënda Kontrolli i Lartë i Shtetit ka paraqitur pranë Prokurorisë së Përgjithshme kallëzime penale, por veprimi i kësaj të fundit nuk është në nivelin e duhur. Ai theksoi se Kontrolli i Lartë i Shtetit po bën përpjekje që shkeljet ligjore të zbuluara prej tij të jenë sa më profesionale dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Gjithashtu, ai përmendi punën përgatitore për hartimin e një marrëveshjeje për rritjen e bashkëpunimit me organin e Prokurorisë dhe kërkoi nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat, si dhe nga Kuvendi mbështetje për forcimin e këtij bashkëpunimi. Më pas, zoti Çeku informoi deputetët me ndryshimet strukturore të institucionit që ai drejton. Në fund, ai paraqiti objektivat për vitin 2005, ku një vend të rëndësishëm zenë përmirësimi i metodës kontrolluese dhe vlerësimi i objektit të kontrollit, përmirësimet e nevojshme ligjore në ligjin për prokurimet publike, në ligjin për qarkullimin e vlerave monetare e materiale etj.

Gjatë diskutimit deputetët mbështetën Raportin e paraqitur nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe veprimtarinë e këtij institucioni, e cila është në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”. Deputetët opozitarë shprehën shqetësimin e tyre për shkallën e pamjaftueshme të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit nga institucionet e administratës publike. Ata shprehën mendimin se Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të rrisë rolin e tij, krahas konstatimit të shkeljeve ligjore dhe dhënies së rekomandimeve përkatëse, ai duhet të realizojë kontrollin vlerësues të punës së administratës publike dhe të Qeverisë.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi hartoi Projektrezolutën për miratimin e Raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Çështjet kryesore që përmenden në këtë Projektrezolutë janë: nevoja për ndryshime të rëndësishme cilësore në punën e KLSH-së, ruajtja e pavarësisë politike të tij, që ndikon në rritjen e shkallës së besueshmërisë së tij, forcimi i bashkëpunimit midis Kuvendit, veçanërisht Komisionit për Ekonominë dhe Financat, me KLSH-në, ku një vend të veçantë ze kryerja e përmirësimeve të nevojshme ligjore, përmirësimi i vizionit të KLSH-së, jo vetëm si një institucion i kontrollit financiar e profesional, por edhe si institucion i vlerësimit të standardeve të qeverisjes.

3. Raport i Këshillit të Ministrave për gjendjen në Shërbimin Civil dhe miratimi i projektrezolutës, miratuar në seancë plenare më datë 21 mars 2005

Raport i për gjendjen në shërbimin civil për vitin 2004 u paraqit nga Ministri i Shtetit, Marko Bello, në mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut e më pas, në seancë plenare. Ai përmendi drejtimet kryesore të punës së strukturave qeveritare në zbatim të ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”, si informimi i publikut me procedurat e pranimit në shërbimin civil, rritja e konkurrencës në këto procedura, përmirësimi i procedurave të rekrutimit në shërbimin civil etj.

Gjatë diskutimit për këtë raport shumica e deputetëve vlerësuan punën e ministrive dhe të insitucioneve qëndrore në zbatim të ligjit, e cila ka pësuar rritje në krahasim me një vit më parë. Ata mbështetën shqetësimin e paraqitur nga Komisioni i Shërbimit Civil për nevojën e përmirësimit të ligjit “Statusi i nëpunësit civil”, me qëllim zgjerimin e fushës së veprimit të tij, përmirësimin e procedurave të konkurimit, duke kryer konkurimin e përgjithshëm dhe konkurimin e posaçëm.

Deputetët e opozitës shprehën shqetësimin e tyre për moszbatimin korrekt të ligjit nga strukturat qeveritare.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi me shumicë votash një rezolutë për gjendjen në shërbimin civil, në të cilën krahas vlerësimit të punës së strukturave qeveritare në zbatim të ligjit, paraqiti objektivat për vitin 2005.

Ligjvënësit Shqiptarë 1920 - 2005 *



**Në 85-vjetorin e themelimit të institucionit ligjvënës të Shqipërisë, lexuesit i jepet në dorë ky botim, ku janë mbledhur, sistemuar e renditur kronologjikisht të dhënat më të rëndësishme të jetës parlamentare të vendit: legjislaturat dhe kohëzgjatja e tyre; deputetët dhe grupimi i tyre në krahë e aleanca politike; pushteti ligjvënës me emrat dhe emërtimet që janë përdorur në një proces ndryshimi nga një kohë në tjetrën.

Historia është e prirur të mbajë shënimet e veta për gjithçka të rëndësishme që ndodh në jetën e një populli. Por ajo është po aq e vështirë për t'u vetëparaqitur, për të mos thënë se historia, në brendësinë e saj, ka edhe një prirje të çuditshme për ta fshehur vetveten.

Ky libër është një sprovë për të nxjerrë shënimet fillestare të një historie: galerinë e atyre protagonistëve që, jo në kuptimin idiomatik, por në kuptimin juridik, kanë bërë ligjin në këtë vend.

Sa shumë përcaktorë janë përdorur për deputetët! Në të gjitha kohërat, me shkas e pa shkas, nuk është kursyer edhe fjalori më i rezervuar i shqipes. Mund

*Ky botim është përgatitur nga Diana Estrefi, punonjëse e Bibliotekës së Kuvendit të Shqipërisë.

** Teksti në vazhdim është parathënia që shoqëron botimin "Ligjvënësit Shqiptarë 1920 - 1925"

të thuhet se rrallë ndonjëherë dikush ka menduar se këta të ngratë, po aq sa të nderuar, kanë pasur edhe trazimet e tyre.

Me këtë libër Kërkimi Parlamentar dhe Biblioteka e Kuvendit të Shqipërisë është përpjekur të ndërtojë në mënyrë prapavajtëse dhe me emra të përveçëm rrjedhën historike të legjislativave. Përveçse për të informuar, ky libër synon të shkojë te lexuesi edhe si një homazh për të gjithë ata që njerëzit shqiptarë i votuan, u dhanë zërin e vet, i bënë përfaqësues. Cilësia e përfaqësimit është një prej nderimeve më të mëdha të një qytetari.

Përmes këtij libri, ndonëse me informacion telegrafik, mund të shihen baticat dhe zbaticat parlamentare, uljet dhe ngritjet, rritjet dhe rëniet, apogjeu dhe kriza, vota dhe arma, fjala dhe konflikti. Në të dhënat e këtij libri gjendet historia e kalimeve të vështira të pushtetit nga një formë qeverisjeje në tjetrën, nga republika e pashpallur në republikën e ligjshme; nga republika në mbretëri, nga mbretëria në protektorat dhe nga protektorati në regjencë “me pavarësi relative”, nga kjo e fundit në republikën parlamentare, që u zgjodh prej shqiptarëve prej gati një dekade e gjysmë.

Të dhënat që përmban ky libër nuk janë përzgjedhur. Ato janë tërësore, të larmishme, ashtu siç kanë qenë në kohën kur kanë rezultuar. Këto të dhëna janë përshkruar në mënyrë fotografike dhe me baraslargësi politike ndaj të gjithë faktorëve që kanë qenë ndikues në jetën shqiptare. Kjo mënyrë paraqitjeje na bën të kuptojmë se nuk është aq e vështirë që të qëndrojmë përkrah njëri-tjetrit, ashtu sikurse qëndrojnë në këtë libër edhe ata që duken më të papajtueshmit. Në galerinë e ligjvënësve shqiptarë – dhe jo vetëm atyre shqiptarë – ka pasur raste kur ka ndodhur që kundërshtari të nxjerrë armën në vend të fjalës, pa u zgjatur me “atentatet” verbale, që vërtet janë të shumta. Por, në fund të fundit, historia, me mospërfilljen e saj, si e pafundme që është, të gjallëve, duke përfshirë edhe atyre që quhen të zgjedhur, ua ruan vendin pranë e pranë. Dhe këtë nuk mund ta ndryshojë njeri. Në këtë botim janë së bashku mbretërorë e republikanë, liberalë e konservatorë, “oksidentalistë” e “anadollakë”, rebelë e të bindur, komunistë e atdhetarë pa parti (dikur nuk njihej idioma “shoqëri civile”, për t’iu larguar antonimit “shoqëri militare”), socialistë e demokratë. Kështu është jeta

parlamentare, qëkurse revolucionarët francezë vendosën të ndahen edhe formalisht e fizikisht “pro” e “kundër”, në të majtë e në të djathtë. Por ja që historia nuk i ndan!

Ashtu si rrathët e një lisi, që dëshmojnë me heshtjen e tyre motet e mbrapshtë, sezonet normalë dhe sezonet e vështirë, ashtu edhe të dhënat e këtij libri dëshmojnë stinët politike me tërë ndryshueshmërinë e tyre në 85 vjet jetë parlamentare.

Të dhënat e këtij libri janë gjithashtu shprehje e evoluimit të zotësisë për të zgjedhur të shtetasve shqiptarë. Të dish të zgjedhësh është një prej zotësive më të mëdha. Të mos dish të zgjedhësh është një prej fataliteteve më të mëdha. Shpesh herë u bihet kot më qafë përfaqësuesve. Po ata që zgjedhin, a dinë të zgjedhin? Kjo është një prej pyetjeve themelore të funksionimit të një demokracie parlamentare.

Në Shqipëri historia është e ndarë me kohë e periudha. Deri në këtë vit apo pas këtij viti. Deri në fundin e luftës. Deri në fundin e komunizmit. Deri në rrëzimin e shoqërive financiare. Kanë ndryshuar emrat e partive dhe numrat e kongreseve. Kanë ndryshuar emra institucionesh dhe autoritetesh publike. Kurse legjislaturat e pushtetit ligjvënës asnjëherë nuk kanë filluar nga e para. Kjo është një prej shenjave të vetëdijes së shtetësisë të shqiptarëve dhe njëherësh një prej shprehjeve të trashëgimit të përgjegjësive shtetërore nga njëri kufi kohor në tjetrin. Me këtë pushteti ligjvënës ka shprehur seriozitetin e vet. Me këtë pushteti ligjvënës ka njohur një prej parimeve më të përgjithshme të demokracisë: një sistem politik rrëzohet edhe me lëvizje popullore; për të ndryshuar formën e regjimit duhet një regjim, por në veprimtarinë ligjvënëse nuk mund të ketë përmbysje: një ligj i vjetër mund të shembet vetëm kur të jetë miratuar i riu. Ideali i botës së sotme është shteti i së drejtës: barazi para ligjesh të drejta, barazi para konkurrencës për nisma e veprimtari, që, në shkallë të ndryshme talenti e zotësie, përthyhen edhe në shkallë të ndryshme frytshmërie.

Në këtë përvjetor të 85-të të themelimit të parlamentit shqiptar kjo pasqyrë të dhënash vjen në formën e një kujtese për të nderuar e reflektuar për të vështuar të ardhmen, atë të ardhme që bota e qytetëruar gjithnjë e më shpesh e quan “demokraci autentike”, “demokraci të drejtpërdrejtë”, demokraci të vetvendosjes.

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

*Filip Lako
Jurist*

Qendra e Studimeve Parlamentare

Ligji nr. 9050, datë 17.4.2003 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes për tregtinë e lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë. Objektivat e kësaj Marrëveshjeje janë nxitja nëpërmjet zgjerimit të tregtisë, të zhvillimit harmonik të marrëdhënieve midis palëve, vendosjes së kushteve të barabarta konkurrence për tregti midis tyre, duke kontribuar në këtë mënyrë në heqjen e barrierave ndaj tregtisë. Këto dispozita do të aplikohen mbi produktet industriale me origjinë nga shtetet palë në këtë Marrëveshje. Në Marrëveshje trajtohen probleme të tarifave doganore, të detyrimeve fiskale, të barrierave në tregti etj. Në kreun III, që përmban dispozita të përgjithshme, u jepet zgjidhje problemeve të bashkëpunimit në administratën doganore, taksimit të brendshëm, monopoleve shtetërore, rregullave të konsequencës, mbrojtjes së pronësisë intelektuale, antidumpingut, procedurës për aplikimin e masave mbrojtëse në tregti etj. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të themelohet një Komitet i Përbashkët me përfaqësues të secilës palë, si dhe do të këmbehet informacion e do të zhvillohen konsulta, duke mbajtur parasysh që të gjitha këto t’i shërbejnë heqjes së mëtejshme të të gjitha pengesave ndaj tregtisë mes palëve kontraktuese. Marrëveshja përmban një deklaratë të përbashkët dhe pjesë të saj janë edhe 5 anekse dhe 3 protokolle. Më kryesori është Protokoll 3, i cili ka 38 nene. Në këtë Protokoll

jepet përkufizimi i konceptit “Produkte origjinuese” e trajtohen zgjidhjet e kërkesave territoriale, të vërtetimit të origjinës së tyre etj. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.6.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 34 të vitit 2003 në faqen 1105. Ligji i bashkëlidhen anekset e protokollet duke u bërë pjesë integrale e Marrëveshjes, e cila është nënshkruar në Tiranë më 21.2.2003.

Ligji nr. 9051, datë 17.4.2003 “Për ratifikimin e “Konventës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës për shmangien e taksimit të dyfishtë, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal””. Qeveritë e dy vendeve të lartpërmendura, me qëllimin e mirë për zhvillimin e mëtejshëm dhe lehtësimin e marrëdhënieve të tyre ekonomike, me anë të kësaj Konvente marrin masa për eliminimin e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal. Konventa do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit ose e të dy shteteve kontraktuese. Në mënyrë taksative janë përcaktuar në nenin 2 tatimet që mbulon Konventa. Nenet e tjera përkufizojnë se çfarë nënkuptohet me termat “Rezidenti” dhe “Selia e Përhershme”. Shpjegime të hollësishme jepen lidhur me tatimet mbi të ardhurat nga pasuria e paluajtshme dhe nga biznesi, për të cilat jepen alternativa se kur duhet të paguhen në njërin shtet ose në shtetin tjetër, kurse për fitimet nga transporti ndërkombëtar me anije, avionë, mjete rrugore ose hekurudhore në trafikun ndërkombëtar, do të taten vetëm në shtetin kontraktues, ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes. Gjithashtu, Konventa trajton tatimet ndaj dividendëve, ndaj interesave, honorareve, ndaj të ardhurave prej shërbimeve vetjake të pavarura, shërbimeve vetjake të varura, shpërblimeve, të ardhurave të artistëve e sportistëve etj. Në nenet e fundit të Konventës tregohen rrugët dhe mënyrat e eliminimit të tatimit të dyfishtë, duke i trajtuar këto veçmas për Shqipërinë e veçmas për Belgjikën. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 7.6.2003.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 38 të vitit 2003 në faqen 1279. Ligjit i bashkëlidhet Konventa.

Ligji nr. 9052, datë 17.4.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Protokollin shtesë të “Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas””. Protokollin shtesë i Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave udhëhiqet ndërmjet të tjerash edhe nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e cila shpall se të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta, me dinjitet dhe të drejta dhe gjithsecili gëzon të drejtat dhe liritë e parashtruara aty, pa asnjë lloj dallimi, duke përfshirë edhe dallim në bazë seksi. Individët ose grupe të individëve, mund të paraqesin anekse në shtetin palë nën juridiksionin e të cilit janë, kur pretendojnë se janë viktimat të dhunimit të ndonjë prej të drejtave të vendosura në Konventë prej shtetit palë. Komunikimet (ankimet duhet të paraqiten me shkrim dhe nuk do të jenë anonime). Komiteti nuk do të pranojë asnjë ankesë në se bëhet ndaj një shteti palë të Konventës që nuk është palë në këtë Protokoll. Gjithashtu, Protokollin përmban urdhërimin sipas të cilit Komiteti nuk do të marrë në konsideratë asnjë ankesë po të mos vërtetohet se janë përdorur të gjitha masat e brendshme të mundshme, por zbatimi i këtyre masave është zgjatur pa arsye ose në rast se ato nuk sjellin një ndihmesë efektive. Nenet e fundit të Protokollit (nga neni 10 deri në nenin 21) trajtojnë probleme të ratifikimit të Protokollit, të njohjes e të publikimit të Konventës dhe të Protokollit, të hyrjes në fuqi të tij, të amendamenteve etj. Vlen të theksohet se në këtë Protokoll nuk lejohen rezervime. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 6.6.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 38 të vitit 2003 në faqen 1296. Ligjit i bashkëlidhet një Rezolutë e adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme, si dhe Protokollin Shtesë për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas.

Ligji nr. 9053, datë 17.4.2003 “Për disa shtesa në ligjin nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” (i ndryshuar). Në nenin 3 të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 përcaktohet fusha e zbatimit të këtij ligji, ku përcaktohen 6 fusha dhe konkretisht: furnizimi me ujë, transporti i të gjitha llojeve, prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, shërbimet e telekomunikacionit, administrimi, përpunimi dhe eliminimi i mbeturinave të ngurta e të dëmshme dhe zona lira, e zona industriale e parqe. Me dekretin nr. 1628, datë 17.10.1996, në nenin 3 të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 shtohet pika 7 (në fushën e zbatimit të ligjit) me këtë përmbajtje: “Furnizimi me gaz natyror, naftë e nënprodukte të saj, duke përfshirë transportin, shpërndarjen dhe stokimin e tyre”. Ligji nr. 8329, datë 16.4.1998, në ligjin bazë, në nenin 3 të tij (fusha e zbatimit të tij) shton pikën 8 (zonat që kanë përparësi turizmin) dhe pikën 9 (sektori minerar). Me ligjin nr. 9053, datë 17.4.2003 “Për disa shtesa në ligjin nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, përsëri bën shtesë në nenin 3 të ligjit bazë (ligji nr. 7973, datë 26.7.1995), duke shtuar në atë nen pikën “10. Mjediset sportive”. Pra, në nenin 3 bëhen tani 10 objekte që mund të jepen me koncesion, qira, kontratë administrimi, kontratë shërbimi dhe BOO, BOT, ROT, BLT dhe BOOT. Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 30.5.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 31 të vitit 2003, në faqen 1016.

Ligji nr. 9054 24.4.2003 “Për ratifikimin e “Konventës ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze për shmangien e taksimit të dyfishtë për tatimet mbi të ardhurat e mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal””. Konventa do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit ose e të dy shteteve kontraktuese. Në mënyrë të detajuar në nenin 2 jepen se cilat tatime mbulon Konventa, si dhe sqarohet problemi se si do të vepron për

çdo tatim të njëllajtë apo tepër të ngjashëm, fakt për të cilin autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese, do të njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim thelbësor që do të bëhet në ligjet e tyre përkatëse tatimore. Në nenin 4 jepet kuptimi i termit “Rezident i një shtetit kontraktues”, si dhe të drejtat e detyrimit e tij. Gjithashtu, shpjegohet edhe kuptimi i termit “Seli e përhershme”, si dhe detyrimet dhe kompetencat e saj. Më tej shpjegohet se cilat janë objekt i tatimit, duke përmendur këtu të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, fitimet nga biznesi, nga transporti detar dhe ajror, nga sipërmarrjet vetjake të pavarura dhe të varura, shpërblimet e artistëve dhe sportistëve etj. Lidhur me eliminimin e tatimit të dyfishtë jepen mënyrat se si do të shmangen ato në Francë dhe në Shqipëri. Pjesa e fundit e Konventës flet për mosdisiplinimin, procedurat e mirëkuptimit të ndërsjellë, shkëmbimin e informacionit etj. Në fund gjendet edhe një Protokoll, i cili me mirëkuptimin e palëve ky Protokoll do të jetë pjesë integrale e Konventës. Si Protokoll dhe Konventa janë bërë në Tiranë më 24 dhjetor 2002. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 8.6.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 39 të vitit 2003, në faqen 1307. Ligjit i bashkëlidhet Konventa dhe Protokollit.

Ligji nr. 9055, datë 24.4.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën mbi të drejtën e detit” të OKB-së”. Në tërësinë e saj Konventa nisët nga qëllimi për vendosjen e një rregulli ligjor për të gjithë detet dhe oqeanet, të cilat do të lehtësojnë komunikimin ndërkombëtar dhe do të nxisin përdorimin paqësor të deteve e oqeaneve, përdorimin e barabartë dhe efikas të burimeve të tyre, konservimin e burimeve të tyre gjalore dhe studimit, ruajtjes dhe rritjes së mjedisit detar, duke mbajtur parasysh sovranitetin e të gjithë shteteve. Në mënyrë të detajuar trajtohen problemet e ujërave territoriale, të kufijve të tyre, të kalimit paqësor në detin teritorial etj. Rregulla të posaçme përcaktohen për anijet tregtare dhe qeveritare që operojnë për qëllime tregtare dhe anijet e luftës dhe ato tregtare për qëllime jotregtare. Konventa përcakton se cilat janë ngushticat për lundrim

ndërkombëtar, si regullohet kalimi tranzit, si përcaktohet shelfi kontinental etj. Trajtimi i veçantë u bëhet detyrimeve lidhur me lundrimin në det të hapur dhe konservimit dhe menaxhimit të burimeve gjalore në detet e hapura, si dhe të drejtës së shteteve me kufij vetëm tokësorë (shtete që nuk kanë bregdet), nga e për në det dhe linjë e tranzitit. Pjesa e dytë e Konventës trajton kryesisht disa probleme lidhur me organet si Asambleja, Sekretariati, si dhe me procedurat e zgjedhjes dhe kompetencat e tyre, për mbrojtjen nga ndotjet, ushtrimin e forcës ndaj kundërvajtësve etj. Konventa ka 320 nene dhe është miratuar në Montego Bay më 10.12.1982. Pjesë e Konventës janë edhe 9 Aneksë e 6 Seksione, të cilat në pjesën më të madhe janë komente të zgjeruara deri në hollësi të shumë neneve dhe krerëve. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 11.6.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 40 të vitit 2003, në faqen 1351. Ligji i bashkëlidhet Konventa, Aneksët dhe Seksionet.

Ligji nr. 9056, datë 24.4.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën ndërkombëtare për kërkim – shpëtimin në det””. Kjo Konventë është bërë në Hamburg më 27.4.1979 nisur nga dëshira e vendeve anëtare për dhënien e ndihmës në det ndaj personave që janë në fatkeqësi, duke krijuar në çdo shtet bregdetar organizma përkatës dhe efektivë për vrojtimin dhe shërbimin e shpëtimit. Konventa ka 8 nene, ku trajtohen detyrimet e përgjithshme të vendeve anëtare, probleme të interpretimit të traktateve, bazën e amendamenteve, nënshkrimin, ratifikimin, pranimin, miratimin e njohjen e tyre, si dhe probleme në lidhje me denoncimin, depozitimin e regjistrimin, gjuhët që mund të përdoren etj. Pjesë e Konventës është edhe një Aneks me 6 Krerë që në përgjithësi kanë të bëjnë me masat për parashikimin dhe bashkërendimin e shërbimeve të kërkim-shërbimit, të bashkëpunimit ndërmjet shteteve, kërkesave për informacion, sistemet e raportimeve të anijeve, informacionit në lidhje me emergjencat etj. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 11.6.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.40 të vitit 2003, në faqen 1526. Ligji i bashkëlidhet Konventa dhe Aneksi.

Ligji nr.9057, datë 24.4.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për statusin e personave pa shtetësi.””. Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, miratuar më 10.12.1948 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, kanë pohuar parimin që qeniet njerëzore gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore pa diskriminim. Në këtë vështrim Kombet e Bashkuara kanë treguar shqetësimin e tyre për personat pa shtetësi e janë përpjekur t’u sigurojnë atyre ushtrimin më të gjerë të mundshëm të këtyre të drejtave dhe lirive themelore. Në Konventë jepet përkufizimi i termit “person pa shtetësi”, tregohen detyrimet e tyre ndaj vendit në të cilin gjenden, jepen rastet e përjashtimit nga reciprociteti dhe nga masat përjashtimore etj. Në kreun e dytë flitet për statusin juridik e trajtohen me hollësi se ç’farë është statusi vetjak, të drejtat artistike dhe pasuria industriale, e drejta e organizimit në shoqata etj. Një vend i veçantë i kushtohet rregullimit të punësimit të tyre, strehimit, mirëqenies dhe detyrimeve administrative e ligjore, transfertës të aseteve, dëbimit e natyralizimit etj. Klauzola e fundit ka të bëjë me informacionin për legjislacionin kombëtar, zgjidhjen e konflikteve, nënshkrimin dhe aderimin, zbatimin territorial e federal, rezervat në kohën e nënshkrimit, hyrjen në fuqi, denoncimi, rishikimin etj. Konventa ka të bashkëlidhur një Plan me 16 paragrafë që ka të bëjë me dokumentet e udhëtimit dhe këtij plani i lidhet modeli i dokumentit të udhëtimit. Në fund gjendet shtojca, e cila ka Aktin përfundimtar të Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi statusin e personave pa shtetësi. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 11.6.2003. Botuar në Fletoren zyrtare nr.41 të vitit 2003, në faqen 1547. Ligjit i bashkëlidhet Konventa, Plani, Shtojca dhe Modelet.

Ligj nr.9058, datë 20.3.2003 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjet nr.7932, date 17.5.1995, nr.8286, datë 16.2.1998, nr.8392, date 2.9.1998, nr.8575, datë 3.2.2000,

nr.8776, date 26.4.2001, nr.8852, datë 27.12.2001 dhe nr.8889, datë 25.4.2002. Me ligjin e lartpërmendur është bërë një plotësim i shpjegimit për pensionin e reduktuar. Ndryshimi bëhet në nenin 31/1 dhe përcakton se pensioni i reduktuar është pjesë e pensionit të plotë dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë shumë më del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit, para mbushjes së moshës të përcaktuar në nenin 92, me koeficientin mujor të reduktimit. Koncepti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë, personat që plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë nen (paragrafi i parë) është 0.6 për qind në muaj. Paragrafi i fundit i nenit 31/1 shfuqizohet. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 11.6.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.41 të vitit 2003.

Ligji nr.9059, atë 8.5.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për reduktimin e pashtetësisë””. Konventa është bërë në New York më 30 gusht 1961 dhe ka hyrë në fuqi më 13 dhjetor 1975. Qysh në nenin 1 Konventa detyron një shtet kontraktues për t’i dhënë shtetësinë e tij një personi të lindur në territorin e atij shteti, i cili ndryshe mund të jetë pa shtetësi. Mënyra, rastet, kushtet, kërkesat e detyrimet jepen në mënyrë taksative në këtë nen. Po ashtu, në Konventë gjen zgjidhje edhe dhënia e shtetësisë fëmijës së braktisur, për të cilin, kur nuk ka prova në të kundërt, konsiderohet se ka lindur brenda territorit të atij shteti. Kur për arsye të ndryshme ligji i një shteti kontraktues kërkon humbjen e shtetësisë, si pasojë e ndonjë ndryshimi në statusin vetjak të një personi të tillë, si martesë, mbarimi i martesës, legjitimimi, njohja ose adoptimi, një humbje e tillë kushtëzohet nga zotërimi ose fitimi i një shtetësie tjetër. Konventa përmban detyrimin, sipas të cilit, një shtet kontraktues nuk mund të privojë një person ose një grup personash prej shtetësisë së tyre për arsye sociale, etnike, fetare ose politike. Gjithashtu, Konventa nuk interpretohet se ndikon ndaj ndonjë dispozite më ndihmuese ndaj reduktimit të pashtetësisë, e cila

mund të përfshihet në të drejtën e brendshme të çdo shteti kontraktues. Nënshkrimi i Konventës mund të bëhej nga data 30 gusht 1961 deri më 31 maj 1962. Mbas kësaj date, çdo shtetas anëtar i Kombeve të Bashkuara mund të aderojë. Konventa ka edhe një shtojcë lidhur me Aktin Përfundimtar të Konferencës së Kombeve të Bashkuara për zhdukjen ose pakësimin e pashtetësisë në të ardhmen. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.6.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.47 të vitit 2003, në faqen 1785. Ligjit i bashkëlidhet Konventa dhe Shtojca.

Ligji nr. 9060, datë 8.5.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja””. Kjo Konventë zbatohet për dokumentet zyrtare që ekzekutohen në territorin e një shteti palë dhe lëshohen (prodhohen) në territorin e një shtetit tjetër palë. Në kuptimin e kësaj Konvente, konsiderohen zyrtare dokumentet e lëshuara nga një autoritet ose funksionar i lidhur me gjyqësorin e shtetit, përfshirë edhe dokumentet e lëshuara nga prokuroritë, sekretaritë e gjykatave dhe zyrat përmbartimore, dokumente administrative, aktet materiale, si dhe vërtetimet zyrtare. Kjo Konventë nuk zbatohet për dokumentet e ekzekutuara nga agjentë diplomatikë ose konsullorë, si dhe për dokumentet administrative që lidhen drejtpërdrejt me veprime tregtare ose doganore. Lidhur me këtë lind detyrimi i çdo shteti palë që të marrë masat e nevojshme, për të shmangur legalizimin e dokumenteve nga agjentët e tij diplomatikë dhe konsullorë në rastet kur kjo Konventë parashikon përjashtimin. Në mënyrë të detajuar trajtohen rastet e vërtetimit të autencitetit të firmës, të lëshimit të certifikatave dhe plotësimi i tyre, veprimet që duhet të kryejë autoriteti kompetent etj. Konventa është nënshkruar në Hagë më 5 tetor 1961 nga shtetet pjesëmarrëse, kurse për shtetet e tjera është mundësia e aderimit. Në fund gjendet edhe një Shtojcë ku jepet modeli i certifikatës, i plotësimit dhe i vërtetimit të saj. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 4.7.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 47 të

vitit 2003, në faqen 1794. Ligji i bashkëlidhet Konventa dhe Shtojca.

Ligj nr.9061, datë 8.5.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8097, date 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, ndryshuar me ligjin nr.8500, date 10.6.2000. Ndryshimet që i bëhen ligjit në fuqi kanë të bëjnë me disa probleme, siç është për shembull shtimi i rrethit të personave që përfitojnë këto lloj pensionesh dhe konkretisht shtohet Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe Kryetari i Arbitrazhit të Lartë Shtetëror. Në nenin 5 ndryshohen masat e kontributeve që duhet të paguajnë personat e punësuar në fondin e sigurimit shtetëror suplementar, dhe në fshat kjo masë kontributi rritet. Ndryshimet në nenin 7 kanë të bëjnë me pagën kalimtare të personave të të gjitha grupeve, duke hequr nga ligji në fuqi kushtin që këto paga të jenë të masës të muajit të fundit në funksionin që ka pasur. Në nenin 8 shtohet e drejta e personave për të marrë pension suplementar të reduktuar, në raport me periudhën e shërbimit në atë funksion ose detyrë, kur nuk plotëson periudhën e shërbimit të parashikuar për pension të plotë suplementar. Në nenin 15, me shtesën që bëhet, gjen rregullim problemi i periudhës së shërbimit. Kështu, periudhë shërbimi për efekt përfitimi nga ky ligj, pas 1 prillit 1996, do të njihet periudha gjatë së cilës është derdhur kontribut në fondin e sigurimit shtetëror suplementar. Përveç këtyre janë bërë edhe disa shtesa e ndryshime për rregullimet në tekst. Ligji ka 10 nene dhe ka hyrë në fuqi më 4.7.2003. Botuar në Fletoren Zyrtre nr.47 të vitit 2003, në faqen 1799.

Ligj nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”. Në këtë Kod trajtohen të gjitha problemet që kanë të bëjnë me familjen, siç janë martesë, marrëdhëniet martesore, përgjegjësia prindërore, administrimi i pasurisë bashkëshortore, detyrimi për ushqim, birësimi, kujdestaria, zotësia për të vepruar etj. Kështu janë parashikuar kushtet thelbësore për lidhjen e martesës,

forma e lidhjes së saj, pavlefshmëria e martesës dhe pasojat e pavlefshmërisë. Të drejtat dhe detyrimet të ndërsjella midis bashkëshortëve që lindin nga martesat trajtohen me hollësi në një kre të veçantë. Të rëndësishme janë edhe problemet që kanë të bëjnë me pasurinë që në Kod janë titulluar “Regjimet pasurore martesore” dhe që zenë një vend të konsiderueshëm. Janë parashikuar edhe rastet e mbarimit të martesës, si dhe pasojat e zgjidhjes së martesës për bashkëshortët. Në pjesën e tretë të Kodit flitet për fëmijët, për amësinë dhe atësinë e tyre, për detyrimin për ushqim ndaj tyre dhe kush janë personat e detyrar. Përgjegjësia prindërore dhe ushtrimi i kësaj përgjegjësie, si ndaj fëmijës ose edhe ndaj pasurisë të fëmijës, përmban detyrime dhe të drejta të prindërve, gjithnjë në dobi të fëmijëve të mitur. Problemet e birësimit janë të një rëndësie të veçantë, prandaj edhe në Kod thuhet që birësimi lejohet vetëm në rast se është në interesin e lartë të të miturit dhe garanton respektimin e të drejtave të tij themelore. Në Kodi janë parashikuar kushtet e birësimit, ndalimet e birësimit, efektet e birësimit etj. Në pjesën e fundit Kodi përmban një numër të madh nenesh që rregullojnë problemet e vënies në kujdestari të të miturve, procedurën e vënies në kujdestari, detyrat e funksionet e kujdestarit, mbarimin e kujdestarisë etj. Përveç kujdestarisë ndaj fëmijëve të mitur, Kodi trajton edhe kujdestarinë mbi personat që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar. Kodi ka 319 nene dhe hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare. Botimi është bërë më 20.6.2003, pra del të ketë hyrë në fuqi më 20.12.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.49 të vitit 2003.

Ligji nr. 9063, datë 8.5.2003 “Për statusin e trashëgimtarëve të ish-familjes mbretërore”. Sipas këtij ligji, me ish-Familje Mbretërore kuptohet familje e trashëgimtarëve të ish-Mbretit Zog I dhe ish-Mbretëreshës Geraldinë, duke përfshirë edhe pasardhësit e tyre. Këta trashëgimtarë kanë të drejtë të disponojnë dhe të përdorin pronat e tyre, sipas ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, si dhe të ligjeve të tjera në fuqi.

Ky ligj u jep të drejtën trashëgimtarëve të familjes së ish-Mbretit Zog I të mbajnë koleksione të ndryshme, të konsideruara pronë private, pasi ato të jenë regjistruar më parë në organet shtetërore përkatëse, në përputhje me rregullat ligjore në fuqi. Gjithashtu, sipas legjislacionit në fuqi, do të jetë edhe statusi dhe trajtimi protokollor i trashëgimtarëve të ish-Familjes Mbretërore. Për zbatimin e neneve 1, 3 dhe 4 është ngarkuar Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore. Ligji ka 6 nene dhe ka hyrë në fuqi më 4.7.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 47 të vitit 2003 në faqen 1802.

Ligj nr.9064, datë 8.5.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjet nr.8039, datë 23.11.1995, nr.8074, datë 22.2.1996, nr.8112, datë 23.3.1996 dhe nr.8767, datë 5.4.2001. Ligjit të lartpërmedur, siç shihet më lart i janë bërë 4 ndryshime. Me shtesat e ndryshimet që bëhen me ligjin e fundit, ndërmjet të tjerash saktësohet përcaktimi se Agjencia e Prokurimit Publik është organ qendror, person juridik, publik, buxhetor në varësi të Kryeministrit. Gjithashtu, përcaktohet se për nëpunësit, drejtues dhe specialistë të Agjencisë së Prokurimit Publik zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin “Statusi i nëpunësit civil”, ndërsa për punonjësit e tjerë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës. Shtesa e ndryshime ka edhe në nenet që trajtojnë problemet e dokumentacionit, të kushteve për përdorimin e “Prokurimit të drejtpërdrejtë”, të paraqitjes dhe pranimit të ofertave, të hapjes së ofertave, shqyrtimit dhe vlerësimit të tyre, të njoftimit të fituesit dhe nënshkrimit të kontratës, të procedurave për “tenderin e kufizuar” etj. Ligji ka 12 nene dhe ka hyrë në fuqi më 4.7.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.47 të vitit 2003, në faqen 1803.

Ligji nr. 9065, datë 8.5.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, ndryshuar me ligjin nr. 8935, datë 12.9.2002”. Në

ligjin e lartpërmendur bëhet një ndryshim dhe shtohet një nen. Konkretisht ndryshohet neni 5 që ka të bëjë me pagën. Kështu, Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë të Punës dhe të Çështjeve Sociale miraton pagën minimale mujore, në shkallë vendi, e cila është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person fizik e juridik, vendas ose i huaj, si dhe miraton masën e indeksimit të pagave, sipas ndryshimit të pritshëm të indeksit të çmimeve të konsumit, në fillim të çdo viti, dhe rregullat për zbatimin e saj. Pas nenit 5 shtohet neni 5/1, sipas të cilit Këshilli i Ministrave miraton pagat e drejtuesve të institucioneve qendrore, aktet nënligjore për funksionimin e strukturës së pagave dhe të shpërblimit për punonjësit e administratës publike, numrin e klasave, masën e pagës dhe të shtesave mbi pagë, sipas klasave dhe masën e shpërblimeve shtesë, për punën jashtë orarit zyrtar për punonjësit e administratës publike, si dhe përgjegjësinë e organeve të larta shtetërore, ministrive e institucioneve të tjera qendrore në fushën e pagave. Gjithçka trajtohet në nenin 5/1 materialet përgatiten nga Departamenti i Administratës Publike (DAP) i Këshillit të Ministrave në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave. Ligji ka tre nene dhe ka hyrë në fuqi më 4.7.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 47 të vitit 2003, në faqen 1805.

Ligji nr. 9066, datë 15.5.2002 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë për mbrojtjen shoqërore””. Kjo Marrëveshje do të zbatohet sipas legjislacionit të përcaktuar veçmas për Republikën e Turqisë dhe veçmas për Republikën e Shqipërisë, duke dhënë ligjet konkrete që do të jenë në fushën e zbatimit. Kjo do të jetë hapësira ligjore e Marrëveshjes, kurse për hapësirat vetjake përcaktohet se ajo do të zbatohet për personat, të cilët janë ose kanë qenë subjekt i legjislacionit të Republikës së Turqisë dhe të Republikës së Shqipërisë. Të gjithë këta persona do të kenë trajtim të barabartë përsa i përket të drejtave dhe detyrimeve sipas legjislacionit të secilës palë. Në Marrëveshje janë parashikuar edhe dispozita

lidhur me legjislacionin e aplikueshëm, bashkimin e periudhave të sigurimit, përfitimet për sëmundje dhe barrëindje, përfitimet mjekësore, përfitimet shëndetësore për pensionistët, për barrëindje dhe rimbursimi i kostos së përfitimeve shëndetësore. Gjithashtu, trajtohen probleme të përfitimit nga invaliditeti, të pensionit të pleqërisë, të pagesave në rast vdekjeje, të përfitimit në lidhje me aksidentet në punë etj. Në përfundim flitet për kontrollin administrativ dhe mjekësor, si dhe për detyrimet për shkëmbimin e informacionit dhe të asistencës së ndërsjellë, përjashtimin ose reduktimin nga taksat, tatimet dhe shpenzimet, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve e për hyrjen në fuqi dhe shtrirjen e kësaj Marrëveshje. Kjo Marrëveshje është bërë në Tiranë më 15 korrik 1998. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.7.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 51 të vitit 2003, në faqen 1995. Ligji i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligji nr. 9067, datë 15.5.2003 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës për transportin ajror””. Marrëveshja ka për qëllim vendosjen e shërbimeve ajrore ndërmjet dhe përtej sigurimin në shkallën më të lartë të sigurisë dhe të sigurimit në transportin ajror ndërmkombëtar. Në Marrëveshje parashikohen garantimi i të drejtave të palëve, përcaktimi i operimeve të shërbimeve, mënyra e autorizimit për të operuar shërbimet, revokimi ose pezullimi i autorizimit të operimit dhe mënyra e aplikimit të ligjeve dhe rregullave të palëve kontraktuese. Rregullimi parashikohet edhe për problemet e certifikatave të vlefshmërisë ajrore, çertifikatave të kompetencës dhe të licencave të lëshuara. Lidhur me sigurimin në aviacion, palët kontraktuese kanë riafirmuar se detyrimi i tyre për mbrojtje, në lidhjet e tyre të shumanshme, i sigurisë së aviacionit civil kundër ndërhyrjeve të akteve të paligjshme, formojnë një pjesë të pandarë të kësaj Marrëveshjeje. Sipas Marrëveshjes, shoqëritë ajrore të përcaktuara të një pale kontraktuese, do të lejohen në bazë reciprociteti, të mbajnë në territorin e palës tjetër

kontraktuese përfaqësuesit e tyre të stafit komercial, operacional dhe teknik. Detyrime të tjera të palëve janë edhe këmbimi i informacionit e konsultimet. Marrëveshja ka parashikuar, gjithashtu, edhe procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.7.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 51 të vitit 2003 në faqen 2006. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligji nr. 9068, datë 15.5.2003 “Për ratifikimin e “Konventës europiane për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykimeve penale”. Konventa shpreh vullnetin e shteteve anëtare të Këshillit të Europës, për të marrë në konsideratë faktin që lufta kundër kriminalitetit kërkon në planin ndërkombëtar përdorimin e mënyrave moderne dhe efikase, sepse ky kriminalitet po kapërcen gjithmonë e më tepër kufijtë administrativë të një shteti të vetëm. Përveç përkufizimeve të termave kryesorë të një vendimi penal, në kreun II të Konventës trajtohen probleme të ekzekutimit të vendimeve penale europiane, duke përcaktuar se ky ekzekutim do të bëhet vetëm ndaj atyre vendimeve penale që përmbajnë saksione që përfshijnë heqjen e lirisë, gjobat ose konfiskimet dhe heqjen ose kufizimin e një ose disa të drejtave. Kërkesa për ekzekutim të këtyre vendimeve ka një procedurë të veçantë, e cila trajtohet në Seksionin II të Konventës. Më tej janë parasikuar edhe masat e përkohshme të ekzekutimit, sipas të cilave shteti që ka marrë kërkesën për ekzekutimin e vendimit të një shteti tjetër, nëse e sheh të nevojshme për të siguruar ekzekutimin, ta aretojë atë me qëllim transferimin e tij në shtetin që e kërkon. Në fund Konventa trajton pasojat ndërkombëtare të gjykimeve penale europiane, sipas të cilave një person, ndaj të cilit është zhvilluar një gjykim penal europian, nuk mund të procedohet, gjykohet ose të bëhet objekt ekzekutimi i një sanksioni në një shtet tjetër palë për të njëjtin fakt kur personi ka marrë pafajësi, vendimi është ekzekutuar, dënimi është falur ose ekzekutimi është parashikuar. Sipas ligjit, Konventa është ratifikuar me rezerva për nenin 61 të saj. Ligji ka katër nene dhe ka

hyrë në fuqi më 10.7.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 5 të vitit 2003, në faqen 2017. Ligjit i bashkëlidhet Konventa dhe 3 Lidhje.

Ligj nr.9069, datë 15.5.2003 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Sipas këtij ligji, Policia Ushtarake është strukturë e specializuar në përbërje të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ajo është në varësi të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe ka për mision ruajtjen e rendit ushtarak, zbulimin, parandalimin dhe ndjekjen e veprimtarisë kriminale në Forcat e Armatosura, angazhimin në luftën kundër terrorizmit, marrjen pjesë në operacionet paqeruajtëse dhe humanitare, si dhe mbrojtjen e pronës shtetëror në administrim dhe përdorim të Forcave të Armatosura nga veprimtari të kundërligjshme. Policia Ushtarake bashkëvepron me komandot e reparteve dhe të njëjstive të Forcave të Armatosura, me strukturat informative ushtarake, Policinë e Shtetit, Shërbimin Informativ Shtetëror, policitë e tjera dhe me organet e pushtetit vendor. Për organizimin, sigurimin dhe kontrollin e trafikut ushtarak organizohet dega e qarkullimit rrugor, e cila e ushtron veprimtarinë në mbështetje të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Policia Ushtarake me attribute të Policisë Gjyqësore kryen hetime të plota për vepra penale që ndodhin në Forcat e Armatosura. Në strukturat e saj organizohen seksionet dhe shërbimet e Policisë Gjyqësore në prputhje me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. Në Kreun III në nenin 12 të ligjit jepen detyrat e Policisë Ushtarake të cilat janë 17, kurse nga neni 15 deri në neni n 24 të kreut IV jepen të drejtat e Policisë Ushtarake. Policia Ushtarake përbëhet nga efektivë oficerë, nënoficerë e ushtarë me pagesë. Në Kreun V jepen kriteret për pranimin, kualifikimin dhe shërbimin në Policinë Ushtarake. Ligji ka 32 nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.7.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.51 të vitit 2003, në faqen 2034.

Albania and the EU's democratic conditionality: "The choice is Tirana's"

(An extract)

Dasara Dizdari

How difficult is it to export democracy and, most importantly, why does it take so long to import it? This study tracks the development of the democratic criteria of the EU over the years, as the Union grew bigger, which has often been a very difficult process and at times rather vague, as the new Member States and the enlargement waves substantially differ. Issues such as the external dimension of democracy, its impact upon other countries that come from dictatorial pasts and the possibility of adapting new rules, as the EU changes itself and deepens its own integration, are vital in understanding the issue. Albania's process of democratization as an internal necessity, but also as an EU conditionality, started as such during the last decade of the last century. Thus, the Albanian democratization process represents an inner imperative and adheres to an external pre-condition for both national prosperity and European integration. The study is organized in one introduction, three main chapters, respectively covering the EU and democratic institutions, the Albanian legacy in terms of democratic tradition and the Albanian European integration process, and one conclusion. Democracy theorists such as Pridham, Whitehead, European affairs scholars such as Olsen, Verheijen, Pippin and others have been important reference points in this study. Similarly, Albanian scholars such as Ruli, Elbasani and others are also

referred to in the paper. The Albanian case represents a country that had never experienced modern Western democracy before the last decade of the twentieth century with its fragile constitutional history. The Albanian wave of democratization that started in the early nineties should be looked at with a special emphasis on the role the EU can play in the consolidation of the Albanian democracy. The Albanian case of democratization is that of a country with lower economic standards and lacking democratic tradition from the past, but it does not prevent us from using conventional theories of democratization while approaching it. The roots of Albania's belated integration in the EU go back to the country's autarkic existence during the communist times and its overdue modernization. Being one of the peripheral environs of the Ottoman Empire for more than five hundred years, Albania was among the last countries gaining independence. This belated awakening accompanies Albania's history of the 20th century as well: it was the last country to get rid of communism in the southeast Europe and it seems to be among the last ones joining the EU. The study concludes that the EU membership process is a process of standard harmonization, the latter representing a clear path for a future member to follow. In this sense, as Albania has been very vocal in its European aspiration, it follows that its government knows where it wants to arrive, and it also understands how crucial this goal is for the country and its people. The issue with Albania's integration though, as it will be demonstrated in this study, is the issue of its ability to catch up with the European club.

Report of Parliamentary committees monitoring process for month of February 2005

Center for Parliamentary Studies, in the frame of “Increase of Public Participation in Legislative Process” project initialized from Center for Parliamentary Studies and Law program, Open Society Foundation (Soros) with it’s financial support, during February 2005, monitored activity of two permanent parliamentary commissions, regarding to the legislative performance and consulting level and participation of interest groups and public opinion generally during legislative process in Assembly.

